Republika e Kosovës
Republika Kosova RepublicofKosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
OpštinaJuzna Mitrovica – Municipalityof Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0055100-1/26 dt. 24.09.2026
Mitrovicë

P R O C E S V E R B A L
Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës
Seanca e 11-të

Koha: 24.09.2026, ora 10:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Të pranishëm:

Anëtarët e Kuvendit: Shkëlqim Ibrahimi, Igballe Islami, Fisnik Suma, Ferdi Kadriu, Majlinda Kurti, Gëzim Stavileci, Artan Berisha, Egzon Sadiku, Valon Brahimi, Egzon Hamza, Liridona Muharremi, Lavdim Zeneli, Nazmije Sejdiu, Armend Begu, Kushtrim Zeneli, Erseka Barani, Sazan Ramaxhiku, Bairam Istrefi, Rinesa Preteni, Egzon Mehmeti, Visar Syla, Xhevdet Osmani, Elfate Ademi Bahtiri, Rozana Peci, Oltion Ahmeti, Xhyljeta Imeri, Arta Neziri, Gjergj Beka, Jeton Ujkani dhe Flamur Vojvoda

Kryetari i Komunës z. Faton Peci
Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani
Drejtor të drejtorive
Përfaqësues të Shoqërisë Civile
Përfaqësuesi i organizatës ARC
Banorët e Fshatit Kçiq
Mediat

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, z. Safet Kamberi, i cili fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës, anëtarët e Kuvendit, përfaqësuesit e organizatave joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare, përfaqësuesit e mediave, banorët e nderuar të fshatit Kçiq, si dhe të gjithë të pranishmit e tjerë.

Në vazhdim, Kryesuesi i Kuvendit në nderim të të ndjerit Murteza Berisha, njërit prej ish-drejtuesve dhe aktivistëve të palodhshëm të çështjes kombëtare, i cili kishte ndërruar jetë një ditë më parë dhe përvjetori i rënies së heroit Afrim Bunjaku, e ftojë kuvendin e komunës që ta nderonin kujtimin e tyre me një minutë heshtje.,

Lavdi

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë, nga 31 anëtarë të Kuvendit, janë të pranishëm 30, një anëtar do ta japë betimin sot. Konstatojmë se kemi kuorum. Mirëpo, para se të propozoj rendin e ditës, dua të theksoj se në bashkëpunim me Rrjetin e Organizatave për Monitorimin e Performancës së Anëtarëve të Kuvendit të Komunës, aktivitet i cili do të realizohet nga konsorciumi i përbërë nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale, Instituti GAP, ATRC dhe CBM, më është kërkuar, para dy muajsh, që të mbahet një ſjalë e shkurtër informuese për anëtarët e Kuvendit lidhur me punën që do të bëjnë gjatë monitorimit të punës së Kuvendit. Prandaj, e ftoj përfaqësuesin e organizatës ARC, z. Arsim Kosumi, që të japë një informatë të shkurtër rreth punës dhe qëllimit të këtij aktiviteti.

Arsim Kosumi: Përfaqësues i organizatës ARC: I nderuar Kryetar i Komunës, i nderuar Kryesues, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, të nderuar qytetarë të pranishëm. Siç jeni të njoftuar paraprakisht, konsorciumi i përbërë nga KLGI, Instituti GAP, ATRC dhe CBM, në kuadër të projektit "Monitorimi i Kuvendeve Komunale në Kosovë", ka filluar procesin e monitorimit të performancës së anëtarëve të Kuvendit

Komunal. Qëllimi i këtij projekti është vlerësimi dhe shpërblimi i anëtarëve më aktiv të kuvendeve komunale. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian, Qeveria e Zvicrës dhe Qeveria e Suedisë. Procesi i monitorimit do të zhvillohet deri në fund të muajit mars të vitit 2027. Për ju, anëtarë të Kuvendit, vlerësimi do të bëhet në tri kategori: në rolin legjislativ, në rolin përfaqësues dhe në rolin mbikëqyrës. Vlerësimi do të bazohet në dëshmi të verifikueshme. Për këtë qëllim, do të merren parasysh procesverbalet zyrtare, dokumentet zyrtare, incizimet, listat e pjesëmarrësve, fotografitë, iniciativat me shkrim, raportet nga terreni dhe forma të tjera të dokumentimit. Në fund të procesit do të ndahen tri çmime: për anëtarin më aktiv të Kuvendit Komunal, për anëtaren më aktive të Kuvendit Komunal dhe për anëtarin më aktiv në mandatin e parë. Nga procesi i vlerësimit përjashtohen Kryesuesi i Kuvendit Komunal dhe shefat e grupeve, për shkak të roleve dhe përgjegjësive shtesë në përfaqësim dhe koordinim, si dhe në mënyrë që të reflektohet angazhimi individual dhe procesi të jetë sa më objektiv. Besojmë se ky proces do të ndihmojë jo vetëm në promovimin e punës së anëtarëve aktivë të Kuvendit, por edhe në forcimin dhe përfaqësimin e qytetarëve, transparencës dhe llogaridhënies në nivelin lokal.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë vazhdojmë pa humbur kohë, në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës, në cilësinë e Kryesuesi i Kuvendit të Komunës kam thirrur mbledhjen e 11-të të rregullt të Kuvendit të Komunës, me rend dite siq është paraparë me thirrje (lexoi rendin e ditës), Me këtë, e shpall të hapur diskutimin rreth rendit të ditës.

Valon Brahimi: Përshëndetje i nderuar Kryesues, i nderuar Kryetar, i nderuar Nënkryetar, të nderuar anëtarë të Asamblesë, përfaqësues të Fshatit Kçiq i Madh, media të respektuara dhe të gjithë ju të pranishëm. Ndoshta nuk jeni mësuar të më shihni në këtë foltore, pasi zakonisht flas nga foltorja atje ku e kam vendin. Por, meqenëse sot kemi të bëjmë me një ngjarje jo të rëndomtë, është e arsyeshme që të dal këtu, përballë qytetarëve, juve, Asamblesë Komunale dhe Ekzekutivit, për të shprehur mesazhin tim dhe qëndrimin tim politik, si dhe qëndrimin e atyre që na kanë votuar për t'i mbrojtur interesat e tyre. Lidhur me rendin e ditës, Kryesues, propozoj që pika 11-të e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për 99 vjet, në vendin e quajtur "Të Pishat", të tërhiqet nga rendi i ditës, për arsyet si në vijim, E para, dua të theksoj se problematika e asaj parcele nuk është e ditës së sotme. Kemi të bëjmë me një parcelë në fshatin Kçiq i Madh, ku ka vepruar një gurthyes, i cili ka shkaktuar dëme të mëdha tash e një dekadë. Për rrjedhojë, ne kemi dëme të cilat nuk po mund të riparohen nga e kaluara. Banorët e fshatit Kçiq i Madh kanë përvojë të hidhur me veprimtarinë e një gurthyesi në atë lokalitet. Ne kemi sot, si pasojë e veprimtarisë së gurthyesit, rreth 3 km rrugë asfalt të dëmtuar, e ndërtuar me taksat e taksapaguesve të Kosovës. Kemi humbje të rrjedhjes së burimeve të ujit për më shumë se 200 familje. Kemi dëmtime dhe çarje të shtëpive të Lagjes së sipërme. Tash, ajo që është edhe më e keqja, është se derisa në atë kohë, gjatë shfrytëzimit nga një operator ekonomik kanë qenë në dispozicion rreth gjashtë hektarë, sot bëhet fjalë për një dëm që mund të jetë kolosal, në kuptimin e plotë të fjalës, dhe që mund t'i përcillet tri gjeneratave të Fshatit Kçiq i Madh. Për mua personalisht, dhe besoj se këtë e dëshmon edhe prania e banorëve të Kçiqit sot këtu, si dhe për secilin anëtar të Asamblesë që i thërret ndërgjegjes, por edhe për secilin drejtor e Kryetar, ky vendim është i papranueshëm, është i patolerueshëm dhe nuk duhet të jetësohet në praktikë. Edhe nëse, potencialisht, supozojmë se kalon në Kuvend, duhet ta ketë parasysh Qeveria Komunale dhe Asambleja se, në praktikë, ky vendim do të jetë i pazbatueshëm. Pasojat do të jenë të paparashikueshme. Janë vendime që nuk mund të shfuqizohen kurdo që neve na teket, sepse më pas prodhojnë pasoja juridike. Në këto raste, në një mënyrë ose në një tjetër, dëmtohet komuna ose dëmtohen qytetarët. Komuna dëmtohet nëse merr vendim sot dhe në të ardhmen e shfuqizon atë vendim, sepse pastaj do të përballet me procese gjyqësore. Ndërkaq, dëmtohen qytetarët nëse sot Kuvendi Komunal merr vendim dhe luan me fatin e tyre. Unë i bëj thirrje këtu çdo anëtari të Asamblesë Komunale, pa dallim, sepse kjo çështje është përtej çdo bindjeje politike. Ajo i prek të gjithë banorët: edhe ata që e kanë votuar Kryetarin aktual, edhe ata që nuk e kanë votuar Kryetarin aktual, edhe ata që më kanë votuar mua, edhe ata që nuk më kanë votuar mua. D.m.th. kjo çështje i tejkalon kornizat politike. Është çështje e mjedisit, është çështje e jetës dhe është çështje e fatit të banorëve. Po dua të cek një rast të ngjashëm që ka ndodhur në Komunën e Prizrenit. Ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese që është i ngjashëm me atë që sot po tentohet t'i paraqitet Kuvendit Komunal të Mitrovicës dhe të gjitha institucioneve publike. Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese i obligon institucionet që, sipas dispozitivit të tij, të zbatojnë Konventën e Aarhusit kur kemi të bëjmë me çështje mjedisore. Këtë vendim të Gjykatës, këtë aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese, do ta dorëzoj në sekretari dhe sekretaria është

mirë që ta marrë dhe t'ua përcjellë. Prandaj, kërkojmë që edhe çështja e dhënies së pronës në shfrytëzim të shqyrtohet me kujdes. Unë mendoj se ka defekte juridike. Në pikën e tretë të aktgjykimit thuhet se destinimi është kryesisht për çështje pyjore, për kullosa dhe për shfrytëzim sipërfaqësor minerar. Nuk është shfrytëzim sipërfaqësor minerar gërmimi i 99 hektarëve për qëllime dhe interesa të një individi, për të cilin nuk mund ta dimë se kush mund të jetë në të ardhmen, por për të cilin qytetarët e dinë se kush ka interes. Krejt qyteti e di se kush po lobon dhe kush ka interes për atë pjesë. Ne nuk jemi të interesuar, të paktën unë personalisht, si përfaqësues i banorëve, që të diskutojmë këtë çështje në këtë mënyrë. Kërkoj që me urgjencë ky propozimvendim të hiqet nga rendi i ditës. Po ashtu, kërkoj që të merren parasysh rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa. Për informacionin e anëtarëve të Kuvendit, ky propozim vendim nuk ka kaluar në Komitetin për Politikë dhe Financa. Nëse dikujt i duket i parëndësishëm Komiteti për Politikë dhe Financa, atëherë cila është rëndësia e atij institucioni? Pse duhet të ekzistojë nëse nuk e ka ndikimin e tij në qeverinë lokale dhe nuk mund t'i tregojë se një vendim i tillë nuk është në rregull dhe pse ka ardhur në Kuvend? Unë po i kërkoj, së pari, Kryetarit që ta heqë këtë pikë nga rendi i ditës. Qytetarët me të drejtë presin që një njeri të cilin e kanë votuar për të udhëhequr ta heqë këtë pikë nga rendi i ditës. Në të kundërtën, nëse Kryetari nuk e heq këtë pikë nga rendi i ditës, do të ishte një goditje e madhe për besimin që ka marrë. Kjo vlen edhe për secilin anëtar të Asamblesë Komunale. Nuk po i drejtohem askujt këtu në cilësinë e subjektit politik. Unë po kërkoj nga ju, nga të gjithë, ashtu siç jeni deklaruar javën e kaluar se jeni kundër gurthyesit. Po kërkoj nga Armendi, po kërkoj nga Oltioni, po kërkoj nga Xhyljeta, po kërkoj nga Gjergji dhe Flamuri, po supozojmë, po kërkoj nga të gjithë ju, ashtu siç jeni deklaruar javën e kaluar se jeni kundër dëmeve. Armend, Vetëvendosja ka dalë me komunikatë kundër gurthyesit. Nuk po them asgjë tjetër, nëse keni ndryshuar qëndrim, është çështje e juaja, por populli e di qëndrimin tuaj dhe nuk është mirë të ndryshohet qëndrimi brenda një jave. Unë po kërkoj që t'i kthehemi racionalitetit, votoni për popullin, jo për fjalët. Kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet me urgjencë dhe të merren për bazë rekomandimet e Konventës së Aarhusit, e cila i obligon organet komunale dhe qendrore që, para çdo vendimi dhe në fazën e hershme, të konsultohen me banorët. Hajdeni të konsultoheni me banorët, merrni pëlqimin e tyre dhe vazhdoni procedurat pasi të merret pëlqimi i banorëve. Kjo çështje nuk mund të kalojë, sepse vullneti i popullit nuk mposhtet as nga unë si asamblist, as nga asnjë qeveri lokale dhe as nga asnjë qeveri qendrore. Kërkoj nga propozuesi të dalë dhe të arsyetojë pikët që ka propozuar. Çfarë fiton Komuna dhe çfarë fitojnë qytetarët?

Kryesuesi i Kuvendit: Faleminderit z. Brahimi e ke përfunduar kohën e planifikuar sipas Rregullores së punës së Kuvendit.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: E dëgjova me shumë vëmendje dhe me kujdes z. Brahimi, i cili, mes të tjerash, në mënyrën se si i numëroi të gjitha dëmet që ky gurthyes i ka shkaktuar komunitetit dhe Fshatit Kçiq gjatë 20 viteve të kaluara. Dhe, për ironi të kohës, ai ka qenë jo më pak se drejtor i Inspeksionit për një mandat, ndërsa nuk e ka ngritur kurrë asnjë çështje. Në rast se ka konstatime për dëmet që janë shkaktuar në familje, dëmet që janë shkaktuar nga humbja e rrjedhjes së ujit dhe një mori dëmesh të tjera, pyetja e thjeshtë dhe logjike që duhet të shtrohet është: kush deri sot është vënë para përgjegjësisë ose kush është marrë në intervistë për të gjitha këto dëme kolosale që sipas jush, i janë shkaktuar Komunës së Mitrovicës? E para, e dimë ne se si funksionojnë edhe organet e tjera dhe e dimë kush ndikon dhe çfarë bën krejt Kosova. Por, sido që të jetë, mua po më pëlqen që në seancën e fundit të gjithë asamblistët kanë qenë bashkë dhe i kanë dhënë përkrahje procesit lidhur me dënimin e udhëheqësve të UÇK-së. Ti po e mban edhe maicën aty. "Liria ka emër?". Por megjithatë, unë kam një dokument këtu të hartuar në vitin 2023, në të cilin shkruan: "Projekt Harta Zonale e Komunës së Mitrovicës së Jugut 2023–2031". Ne e kemi edhe këtu Planin Zhvillimor të Komunës së Mitrovicës. Anëtarët që e kanë dedikuar atë hapësirë në Kçiq, a e din kush janë? Numër 1. z. Bedri Hamza, numër 2. z. Arjan Tahiri, këtu treshin e paskeni harruar, por numër 4. e keni vendosur z. Nexhmi Hasanin, numër 5. z. Edison Tërnavën, numër 6. z. Fahri Shabani, numër 7. znj. Drita Kadriu, numër 8. znj. Igballe Islamin, numër 9. z. Gëzim Stavileci, numër 10. z. Granit Tmava, numër 11. z. Ferdi Kadriun, numër 12, a e dini çfarë emri është? z. Valon Brahimi. Dokumenti zyrtar i administratës. Kështu që ti e ke nënshkruar atë. Liria ka emër, por edhe hipokrizia ka emër, dhe hipokrizia e ka emrin Valon Brahimi, që i manipulon qytetarët e Kçiqit. Kështu që ky është dokumenti, dokumenti zyrtar ata që e kanë bërë Hartën Zonale Hipokrizia është kështu: të dalësh dhe t'u thuash banorëve të Kçiqit se ajo zonë është e deklasifikuar, kur ajo ka qenë në komision dhe është përcaktuar.

Në mes shumë ndërhyrjeve dhe replikave nga anëtarët e kuvendit pa ju dhënë fjala prej kryesuesit Kryetari vazhdon me diskutimin.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Unë kam analizuar çështjen ekonomike dhe financiare në qytetin e Mitrovicës. Gjendja ekonomike dhe financiare në Mitrovicë është e keqe, faktori kryesor i kësaj gjendjeje ekonomike është mungesa e qarkullimit financiar të bizneseve. Po e ndaj këtë me ju dhe me opinionin, në vitin 2024, qarkullimi financiar i bizneseve të komunave ka qenë si vijon: Mitrovica ka pasur qarkullim financiar në sektorin e bizneseve prej 391,000,000 €. Gjakova ka pasur 47 milionë € qarkullim. Gjilani ka pasur fiks dyfishin e Mitrovicës, rreth 620,000,000 €. Ne i kemi rreth 300,000,000€. Prizreni i ka 1.390,000,000 € qarkullim financiar. Prishtina nuk hyn në analizën krahasimore, për shkak se ka rreth 8,800,000,000€ qarkullim financiar. Çfarë po dua të them me këtë çështje? Unë jam i dedikuar dhe i përcaktuar që gjendjen ekonomike dhe financiare në Mitrovicë ta ndryshoj dhe kush e ndryshon gjendjen ekonomike dhe financiare? Qarkullimi financiar i bizneseve. Tash, sot i kemi dy parcela. Të tjera parcela ndoshta nuk jam i sigurt nëse do të trajtohen në seancën e tetorit, por prej seancës së nëntorit dhe në çdo seancë tjetër kemi për të pasur me dhjetëra parcela të pronës komunale në tërë territorin e komunës, të cilat do t'i nxjerrim në shpallje për biznese. Këtu askund nuk do të shkelet ligji, ato do të jepen ashtu siç është e përcaktuar me Planin Zhvillimor të Komunës. Mirëpo, ato parcela që u janë dhënë individëve me joshje partiake dhe çështjet e tjera në Parkun Industrial, do të shkëputen një nga një. Do të ndërmerren masa për shkak se ju keni dhënë parcela nga prona komunale, nga një deri në dy hektarë, dhe askush nuk ka ushtruar asnjë veprimtari ekonomike. Pra, keni dhënë prona dhe kur vjen një afarist ose një investitor, i thoni: "Shko te filani, se ai e ka tokën", dhe jo te prona komunale. Janë hiç më pak se 27 raste që do të shqyrtohen dhe do të shkëputen një nga një. Sikurse ka pasur pretendim edhe iniciativën time për të shkëputur edhe pronën e këtij parkingu këtu përballë, por në një afat rekord janë plotësuar kriteret, janë inkasuar të hyrat dhe u bë park. Kështu, qytetarët mund ta shijojnë parkun e bukur në mes të qytetit, nga betoni në gjelbërim. Unë e kam analizuar këtë çështje pas sensibilizimit të një numri të konsiderueshëm të qytetarëve që më kanë shkruar dhe kam vlerësim maksimal për çdo qytetar të Mitrovicës, sikurse edhe për qytetarët e Kçiqit. Në asnjë mënyrë nuk lejoj as t'i dëmtoj, as t'i diskriminoj, përkundrazi, ajo parcelë është e dedikuar për dhënie në shfrytëzim. Unë nuk e di se sa individë do të paraqiten dhe sa projekte do të dorëzohen, për shkak se janë një mori veprimesh. Nuk duhet ta harroni se veprimi i parë është dhënia në shfrytëzim e pronës komunale. Veprimi i dytë është themelimi i komisionit nga Asambleja dhe Ekzekutivi. Në rast se ka ndonjë projekt për veprimtari pyjore, bujqësore, për përpunimin e gurit ose për çështje të tjera, atëherë ato do t'u nënshtrohen filtrave për pajisjen me leje dhe licenca nga institucionet përkatëse. Duhet të ketë leje nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, si dhe një mori lejesh dhe licencash nga Ministria e Mjedisit. Dhe po mendoj se ju të gjithë jeni kuriozë dhe e dini, për shembull, se sa strikte është Ministria e Mjedisit, e udhëhequr nga Fitore Pacolli, e cila nuk e lë asnjë veprimtari biznesore dhe asnjë veprimtari të gurthyesve jashtë standardeve. Flini të qetë. Asnjë veprim nuk do të ndërmerret jashtë standardit ligjor, në rast se ka propozime të tilla. Nuk ka nevojë për asnjë shqetësim, nuk ka. Edhe çështjet e tjera, unë i kam analizuar dhe kam diskutuar. Dikush e përmend edhe Kushtrimin. Madje, unë e kam shikuar edhe procesverbalin tek diskutimi i Kushtrimit edhe e kam procesverbalin e Kushtrimit, çka ka diskutuar Kushtrim Zeneli. Kushtrimi, diskutimin edhe kundërshtimet e mëhershme i ka pasur shumë parimore, i ka numëruar krejt ato defekte të qeverisjes qendrore, kur në qeverisje qendrore ka qenë PANI, kur në qeverisje komunale ka qenë PDK-ja, edhe krejt ato malverzime edhe dëme që ju janë shkaktuar banorëve të Kçiq it. Nuk vjen në shprehje me Vetëvendosjen e qeverisë qendrore. Me Vetëvendosjen e qeverisë, edhe në nivel qendror dhe lokal, me ushtruar veprimtari jashtë çdo kriteri, sikurse ka qenë përpara në Kçiq, harrojeni atë temë. Këtë e keni veç për konsum ditor, se nuk ka shans qeverisja e Vetëvendosjes në nivel qendror dhe qeverisja e Vetëvendosjes e Guxos, në nivel lokal edhe qendror, me thyer rregulla, ligje dhe me shkaktuar dëme, të cilat ti ia numërove partisë tënde në foltoren e Kuvendit. Kështu që, kush janë ata katër-pesë ministra, hiç nuk ka shans ajo veprimtari me shku. Kjo pikë e rendit të ditës le të diskutohet kur t'i vijë radha. Unë mendoj që, kur të vijë pika e rendit të ditës, besoj që do të thotë janë këtu dhe banorët, me kënaqësinë më të madhe, kam me i dëgjuar. Jo vetëm që kam me dëgjuar, por kam me shkuar edhe në Kçiq me bashkëbisedua me secilin qytetar. Se unë as nuk fshihna, as nuk manipuloj, as nuk e dëmtoj askënd. Unë shkoj ballëhapur dhe diskutoj, se e kam besimin e tyre edhe në secilin lokalitet, në secilën shtëpi kam me shkuar, kushdo që shpreh interesim. Edhe kur të vijë pika e rendit të ditës e caktuar, kena me i dëgjuar qytetarët e Kçiqit, në rast se ata kanë ndonjë çështje që mundet me u adresu para se me u hedhë në votim. Kur vjen pika e 11, do të thotë, unë kam me vendosë mbasi të përfundojmë pikën e 10-të se çka kemi me vepruar në pikën e 11-të.

Kryesuesi i Kuvendit: Faleminderit, Kryetar. Duke pasur parasysh kohën dhe faktin se jemi pranë mbajtjes së mbledhjes komemorative, pas konsultimeve me shefat e grupeve parlamentare, jemi dakorduar që seanca e

Kuvendit të ndërpritet përkohësisht dhe të vazhdojë në orën 14:00, pas ceremonisë së varrimit të të ndjerit Murteza Berisha.

10:50 Pauzë

14:23 Mbledhja vazhdon punimet.

Kryesuesi i Kuvendit: i ftoi shefat e grupeve parlamentare për një konsultim të shkurtër. Pas konsultimit, ai theksoi se në sallë janë të pranishëm 31 anëtarë të Kuvendit, ndërsa Egzon Mehmeti ende nuk e ka dhënë betimin. Në vijim, Kryesuesi njoftoi se seanca do të vazhdonte me procedurat e parapara.

Valon Brahimi: Meqë Kryetari ma ka përmendur emrin dy-tri herë, unë tash kam një sqarim edhe një pyetje për Kryetarin. Te çështja e dëmeve, kur janë shkaktuar te gurthyesi në Kçiq Madh, rruga është dëmtuar në kohën kur drejtor ka qenë i nderuari Naser Muja. Kur ka ardhur partia në pushtet, PDK-ja, mbasi i dhe ngjyrë politike, pas peticioneve, pas ankesave të qytetarëve, për arsye ligjore, për shkak se kemi konstatuar që ka mungesë të kontratës valide për me shfrytëzuar pronën shoqërore, gurthyesi i ka ndalë punimet dhe s'ka punuar kurrë, deri sot nuk ka punuar hala. Kjo është informata e parë. D.m.th. e ka ndalë ligji, e dyta, ai dokument, Kryetar, që prezantove, që është emri Valon Brahim, kam qejf me e publikuar, me qitë të skanuar, me pa qytetarët çfarë natyre është dhe cili është roli im në atë dokument. Sqaroju qytetarëve këtë, qite të shohin, ose bëni kopje fizike, shpërndaje te të gjithë asamblistët. Nuk mundesh veç me fol aty diçka. Ka qenë Valon Brahimi këtu, se Valon Brahima ka 100 emra nëpër komunë. Cili ka qenë roli im në këtë punë? Sqaroj qytetarëve, sqaroj decidivisht edhe mediat, të jenë më të qarta. Dëgjoni çfarë po flet. Është pyetje decidive: cili ka qenë roli i drejtorit të Inspeksionit në hartimin e hartave zonale? Çfarë funksioni ka pasur? Përgjigjet Kryetar, kam qef me qenë koncize e jo politike. Edhe e treta, kjo nuk duhet me të pengu shumë, ndoshta, se besoj që të pengon puna "Liria ka emër", kena prit me qenë bashkë me neve? Kcq është që ke mungua kur e kemi bërë deklaratën për vlerat e luftës.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Edhe njëherë, dokumenti zyrtar është i aprovuar edhe i draftuar nga ekzekutivi paraprak, në krye me Kryetarin e Komunës, z. Bedri Hamza, ku i ka përfshirë shumicën e ekzekutivit edhe palët e tjera. Në ndërkohë, në këtë dokument, dëgjoni mirë, meqenëse po don me dhënë shpjegime shtesë mediave, le t'i dëgjojnë mediat. Thotë: autoriteti komunal përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor në Mitrovicën e Jugut, gjatë hartimit të Hartës Zonale Komunale, është kujdesur që të sigurojë pjesëmarrje publike, të ketë një proces transparent dhe pa diskriminim, të ofrojë qasje publike në të gjitha të dhënat, të ndërmarrë fushatë për informimin dhe sigurimin e pjesëmarrjes publike gjatë hartimit të këtij dokumenti, të organizojë diskutime publike dhe forma të tjera të pjesëmarrjes publike. Mes të tjerash, meqenëse po do me vazhdu debatin, roli yt që këtu ku është, do të thotë, e shkruar e zeza në të bardhë, thotë: ekipet e përfshirjes në përgatitjen e Hartës Zonale të Komunës. Ky është dokumenti në komunë që e kemi gjetur ne. Në rast se ju keni falsifikuar dokumente, atëherë kjo hap një temë tjetër për diskutim dhe ka vend tani edhe për instancat e drejtësisë. Unë ju referohem dokumenteve zyrtare të komunës. Tjetra, mes të tjerash, mediave, tu dalë në korridor, ju ke thënë disa prej tyre që unë nuk kam qenë në dijeni që emri im ka qenë pjesë e hartimit edhe përcaktimit të asaj zone. Mes të tjerash, aty ka zonë pyjore, zonë bujqësore, ka edhe pjesë të veprimtarisë, sipërfaqe, qysh quhet, minerare. Tash, në diskutimet publike, ti ke pasur mandat edhe ke qenë anëtar i këtij komisioni, këtij grupi, grupeve punuese. Po ti s'je shkuar te banorët e Kçiqit me ju kallëzua atëherë, kur e ke futur atë zonë për dokument. Kështu që dokumenti është valid. Ju ke thënë: "Unë s'e kam ditur" E ke ditur, e ke ditur, po të ka pëlqye edhe s'ke bërë zë, se ke qenë në pushtet. Ke qenë në pushtet dhe e ke ditur, e ke ditur. Edhe tjetra, unë e kam edhe një fjalë tjetër me ju thënë. Kështu, mes të tjerash, PZHK-në, Planin Zhvillimor Komunal, edhe Hartën Zonale, atë e kam gjetur në mesin tuaj, nuk ua solla unë. Do të thotë, unë për herë të parë jam në ekzekutiv të komunës së Mitrovicës. Unë nuk jap asnjë përgjigje as përgjegjësi për asnjë qeverisje të pasluftës në ekzekutivin e komunës së Mitrovicës. Unë jam prej 12 dhjetorit të vitit të kaluar në ekzekutiv. Po në asamble kam qenë dhe kam qenë asamblist kritik, shumë aktiv edhe konstruktiv edhe me propozime dhe ide konkrete, nuk jam zhurmagji po jam zë i arsyes. Unë ju thashë edhe në fillim dhe po e përsëris, ambicia ime është Mitrovicës me i dhënë tjetër nivel të zhvillimit ekonomik. besoj që ju e dini, që i kena eliminuar këto uzurpimet edhe i kemi futur në inkasim dhe tash e kemi edhe një Rregullore që kena me i rritë hyrat. Dhe kurrkund nuk me pas ndërtime pa leje, as nuk kam me pas tejkalim të koeficientit, meqenëse po flasim për pronën komunale edhe për mënyrën e menaxhimit, ta zë 5.000 m^2 tejkalim nënkupton minimalisht në vlerë monetare 5 milionë, vetëm në një objekt. Këto janë praktika që njëherë e përgjithmonë qytetari i Mitrovicës i ka ndëshkuar me votë edhe nuk lejon në asnjë variant me u rikthyer. Kështu, Plani

Zhvillimor Komunal, Harta Zonale baza ditore ku me u angazhuar, dhe thashë që sot i kemi dy ose tri pika të rendit të ditës për dhënie në shfrytëzim, prej muajit tjetër, me dhjetëra parcela komunale kanë me u dhënë. Ka me pas shpallje: a vijnë, a s'vijnë; a kemi interesim, a s'kemi interesim; a kemi pasur projekt konkret apo s'kemi pasur projekt konkret ka me u varë tani nga muaji pasues.

Në rast se qytetarët afaristë, shpirti ndërmarrës i këtij qyteti, jo vetëm i këtij qyteti, se nuk është vetëm për qytetarët e këtij qyteti, por edhe për mërgatën edhe për çdo qytetar të Kosovës, unë kam me mirëprit edhe kam me i ftu me ardhë në Mitrovicë për me investu. Ku është përpunim i gurit do ket përpunim i gurit, ku është tokë bujqësore ndonjë veprimtari bujqësore. Ku është tokë pyjore tokë pyjore, nuk ndryshon destinacioni. Në rastin e në ecje e sipër mundet me ndryshua destinacioni. Nuk është komuna ajo që e përcakton, po janë instanca të tjera të institucioneve qendrore që kanë me përcaktuar. Kështu që, më falni, PZHK-në edhe atë kodrën atje që ne i thërrasim Cërnushës, edhe pjesës andej Kçiq, nuk e bëra unë, nuk ju solla unë atë e gjeta në mesin tuaj. Unë jam përgjegjës veç për veten, unë e kam emrin Faton Peci. Vetëvendosje, unë jam, po me Vetëvendosjen bashkë e kena fituar dhe bashkë kena me qenë, edhe jo veç këtë mandat, por edhe shumë të tjera.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë, faleminderit Kryetar, e di që ju z. Brahimi e ke konsumuar të drejtën e diskutimit në bazë të Rregullores, mirëpo, nëse ke diçka me diskutu, një minutë e ke në dispozicion.

Valon Brahimi: Jo, unë veç po i kërkoj Kryetarit me i kërkua, jo vetëm mua por Kuvendit falje për gjuhën e tij. S'na ka hije, Mitrovicë, ne jemi kështu. Duhet me kërkua falje për gjuhën e tij.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: E para, unë asnjë gjuhë të papranueshme nuk e kam përdorur dhe as nuk e përdor kurrë. E dyta, po donë qëllimisht me i dhënë kahe tjetër për shkak se e ke humbur argumentin, se s'ke argument mbi bazën e të cilit ke dashur me ngrit një temë pa pasur asnjë argument. E treta, në jetën time nuk e kam kërcënua askënd. Edhe kjo është tipike tendencë e jotja. Kurrë në jetën time, unë kurrë një njeri të gjallë, as personalisht, as familjarisht, megjithëse po hy edhe nga familjet, nuk e kam kërcënuar, as nuk jam marrë me belaxhi, as rrahës, as hiç kurrgjë. Përkundrazi.

Igballe Islami: I nderuar Kryesues, Kryetar, Nënkryetar, ekzekutiv, kolegë të asamblesë dhe të gjithë ju të pranishëm. Sa i përket rendit të ditës, kam pasur shqetësim që nga momenti i pranimit të materialit, për vetë faktin që kjo pikë e rendit të ditës është aprovuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e korrikut, atëherë kur iniciues ka qenë drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër. Është aprovuar në Komitet, mirëpo nuk është proceduar tutje në mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal. Është iniciuar si pikë shtesë e rendit të ditës, pa pasur materialin ne para vetes si anëtarë të Komitetit. Kësaj radhe iniciohet nga një tjetër drejtor, tash nga drejtori i Pronës, kushtimisht, do të thotë, këtu vijmë në pikën që kjo pikë është aprovuar, nuk është sjellë tash, nuk është aprovuar në Komitet dhe prapë vjen në seancën e Kuvendit Komunal. Unë e kuptoj që edhe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale rendi i ditës propozohet në koordinim mes Kryesuesit dhe Kryetarit të Komunës, mirëpo, vlerësoj që për një pikë kaq të ndjeshme, siç është dhënia në shfrytëzim e pronës komunale për 99 vjet, aq më tepër kur ne kemi qytetarë, shumë banorë të fshatit Kçiq, të cilët sot kanë protestuar dhe kanë shfaqur pakënaqësitë e tyre sa i përket kësaj. Me marrjen e mandatit, Kryetari disa herë sot e përmendi që është i zgjedhur me votë. Kryetar, të gjithë këtu jemi me votë, përveç ekzekutivit tuaj. Jemi me votë edhe ne, asamblistët. Jemi të votuar për me i përfaqësuar interesat e qytetarëve. Ju jeni votuar si Kryetar, kështu që të gjithë kemi të drejtën e përfaqësimit dhe të jemi zë i qytetarëve dhe të mbrojmë interesat e tyre. Me marrjen e mandatit, edhe Kryetari edhe ne, asamblistët, jemi betuar që do ta mbrojmë interesin e qytetarëve. Para së gjithash, do të jemi në shërbim të tyre. Kryetari, besoj që nuk iu është përgjigjur pyetjeve tona konkrete që Valoni ka folur në emër të grupit tonë, e çfarë ka pasur të bëjë pikërisht me atë se çka përfiton Kçiqi. Nëse kthehemi në Hartën Zonale dhe mundohemi me shpërqendruar vëmendjen nga inicimi i këtij propozim vendimi për dhënien e kësaj parcele, unë e vlerësoj që këtu jeni duke bërë një shkëputje. Kryetar, Harta Zonale nuk ka dalë nga askund edhe ne e kemi gjetur në mesin e dokumenteve këtu kur kemi ardhur. Plani Zhvillimor Komunal është aprovuar në vitin 2020 nga qeverisja e Agim Bahtirit, mbi atë bazë, Plani Zhvillimor Komunal është për vitet 2020-2028 mbi bazën e Planit Zhvillimor Komunal është hartuar Harta Zonale Komunale. Qytetarët duhet të dinë saktësisht çka është Harta Zonale Komunale, ajo nuk e përcakton nëse do ta marrë X apo Y operatori atje, apo nëse do të hapet gurthyesi, harta Zonale përcakton saktë gjendjen faktike të tokës. Nëse në këtë rast kemi të bëjmë me zonë pyjore, kemi të bëjmë me zonë minerale sipërfaqësore, Harta Zonale nuk ka mundur me paraqitur auto rrugë, nuk ka mundur me paraqitur fushë rekreative sepse nuk është. Është duke e treguar gjendjen faktike të parcelës në të cilën ndodhet kjo, për më

tepër Harta Zonale është punuar nga një ekip profesional i jashtëm. Ndryshe, kjo është aprovuar në Asamblenë Komunale. Mirëpo, Kryetar, ju e dini që kjo i është nënshtruar edhe ligjshmërisë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, që po i bie, nëse ka qenë në kundërshtim me rregullat e planifikimit hapësinor, pa dyshim që kjo do të ishte kthyer, qysh janë kthyer për ligjshmëri gjashtë vendime në seancën e fundit. D.m.th. kemi pasur edhe vendime shumë më të thjeshta. Ministria ka vlerësuar që nuk është respektuar legjislacioni në fuqi. Në këtë rast, vlerësoj që ne duhet të qëndrojmë te pika këtu ku jemi dhe jo të kthehemi te Harta Zonale. Harta Zonale nuk është obligative dhe nuk e obligon askënd që të marrë vendim. Harta Zonale është edhe hapja e Rrugës "Ali Zenelì", është edhe hapja e Rrugës "Lah Nimani", është edhe fusha rekreative, ka edhe parqe gjithandej qytetit. Mirëpo, të lutem, duhet edhe qytetarët, sepse unë vlerësoj që intelekti i këtij qyteti është mjaftueshëm i qartë për me kuptuar çfarë është destinimi i pronës. Kështu që nuk kemi nevojë me i ndryshu termet, kemi nevojë me fol gjuhën e popullit. Jemi edhe ne këtu përfaqësues të popullit, njësoj siç jeni edhe ju i zgjedhur për me mbrojtur interesin e tyre. Kështu që, unë po pranoj që ju keni pasur të drejtë me inicuar edhe me futur në rend të ditës. Mirëpo, vlerësoj që, kur kemi të bëjmë me një pikë që, së pari, përderisa banorët i kemi jashtë dhe jemi me një presion, po vlerësoj, përderisa jemi ne të gjithë, unë nuk e vlerësoj që jemi kompetentë të marrim vendim për banorët e fshatit Kçiq, përderisa këta shprehin vullnetin e vet këtu brenda. Kështu që, në këtë pikë me u thirr në Hartën Zonale, se Harta Zonale ka përcaktuar, ajo nuk ka mundur me përcaktuar ndryshe përveç zonë pyjore dhe zonë minerale sipërfaqësore, se gjendja është e tillë. Mos e merr vendimin, Kryetar. Harta Zonale nuk të obligon.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Unë këtu nuk jam për me folë në emër të qeverisjes së z. Agim Bahtirit, as s'kam qenë në atë qeverisje, as nuk e di, as nuk më takon. Për shkak se ndoshta, nëse kam dashur me e dhënë njëfarë mbrojtjeje, mundem mos me ditë me e mbrojtur në mënyrën më të mirë për krejt temat që i keni për qeverisjen e z. Agim Bahtiri. Ai është figurë politike publike? Deputet. Drejtohuni ju atij në intervistë ose në debat, kaq. E dyta, nuk mundesh me thënë që ne e kemi gjetur prej z. Bahtiri dhe e kemi vazhduar ne kështu, ju keni qenë katër vjet në qeverisje, po gjendja e pronës nuk ka ndryshuar. Do të thotë, veç kjo është një kundër argument ndaj asaj që ju po proklamoni. Përderisa gjendja e pronës nuk ka ndryshuar, përderisa destinimi është me PZHK dhe me Hartë Zonale, unë nuk po di çka po doni ju me bë. Do të thotë, nuk e keni asnjë kontestim legal, ligjor, formal, përmbajtësor që mundeni me bërë, përveç argumentit që ju po thoni se, në rast se prej atyre hektarëve që janë të përcaktuar, mundet me ardhë një interesim, mundem me i pasur dhjetë interesime. Ndoshta mundem me i pasur dhjetë interesime të fushave të veprimtarive të tjera. Ku po i dini ju kush ka me ardhë? Unë s'po e di. Edhe kushdo që vjen, ka një komision që ka me përcaktuar në rast se është veprimtaria për të cilën është e dedikuar. Edhe e keni votuar Hartën Zonale, Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale. Atëherë kemi me qenë këtu me e kqyr krejt aspektin e arsyeshmërisë, ligjshmërisë, dobisë së përgjithshme për Kçiqin, për Mitrovicën edhe për krejt komunën. Kështu që, unë nuk dua me predikuar. Unë jam këtu, në radhë të parë, me i ofruar shërbim qytetarit dhe me pasur angazhim maksimal me nxjerrë Mitrovicën prej gjendjes ekonomike dhe financiare në të cilën është. Në rast se ju ka tërhequr, do të thotë, çështja e gurthyesve, njëra prej vërejtjeve që opozita në nivel qendror i ka për qeverisjen e Albin Kurtit thotë që, si rezultat i pamundësisë së veprimtarisë së shumë operatorëve që merren me trajtimin e gurëve, është rritur importi prej Serbisë. Tash, a po përcaktoheni çfarë po kërkoni ju? A po doni me ndalë importin e gurit të thatë prej Serbisë, apo doni me vazhdu edhe më tutje, prej nivelit të asamblesë, me ndalë gurët e Kosovës me ndej nën dhe, e operatorët ekonomikë me pru import prej Serbisë? Përcaktoni tash kah e keni ju drejtimin, se, për besë, nuk po di cili është. Përveç asaj që po doni me shfrytëzua pakënaqësinë e qytetarëve, që me të drejtë munden me pasur dilema, se i keni numëruar shumë mirë. Unë s'i kisha ditur as gjysmën, unë ju falënderoj. As gjysmën e atij zullumi që e ka pasur Kçiqi nuk kisha ditur, derisa i numëruat një nga një. Ajo çka unë marr zotim është se asnjë veprimtari nuk mundet, me u ushtrua në atë formë qysh paska qenë të kaluarën, që e ka dëmtuar, do të thotë, banorët e Kçiqit. Unë e marr zotim dhe jam i bindur që edhe qeveria në nivel qendror ka me pasur të njëjtin angazhim edhe përkushtim. Kështu që, me ardh dhe me konstatuar retroaktivisht që gjithë këto dëme i ka pësuar lokaliteti Kçiq dhe ju jeni kanë herë në qeverisje komunale, herë në nivel qendror dhe e keni lejuar ato. Tash, falemiderit që jeni ardhur dhe i keni numëruar këtu. Unë i kam ditur disa gjëra, por shumë kam mësuar sot prej krejt kësaj veprimtarie. Jo, nuk tërhiqem anash. E kam ambicie zhvillimore dhe nuk kam ambicie tjetër.

Kryeuesi i Kuvendit: Kam një propozim konkret. Meqenëse kërkesa e Valonit është që kjo pikë të largohet prej rendit të ditës, unë e kam një sugjerim që të aprovohet rendi i ditës dhe, kur të vijë çështja e pikës, duhet me ju dhënë rast edhe banorëve, përfaqësuesve të fshatit, me diskutuar, me marrë opinionin e tyre. E në atë

pikë, unë kam me diskutu edhe unë. Edhe unë i kam do muhabet në raport me këtë çështje. Në fund të fundit, publikisht dihet qëndrimi im, Kryetar, në raport me çështjen. Mirëpo, përderisa i kemi banorët këtu dhe nuk po ka mundësi që ata me diskutu për këtë çështje, të aprovohet rendi i ditës, të kalojnë pikat dhe le të vijë çështja e Kçiqit. Atëherë ne, sepse realisht e kemi shterur diskutimin në raport me pikën për të cilën realisht ne s'e kemi aprovuar. Prandaj, le të aprovohet rendi i ditës, të kalojmë te pikat me radhë ku janë, e diskutojmë, e qesim në votim dhe këtu jemi me ia pa fytyrën secilit, edhe mos tentohet me u fsheh kurrkush. Mos kërkoni që këto më shumë po e kanë hallin e disa banorëve që i kanë këto, sesa hallin e vërtetë të tyre. Prandaj, sugjerimi im është, Valon, me u tërheq prej kësaj. Unë me e qit në votim rendin e ditës. Kur të vijë çështja, diskutojmë bashkë dhe e ke rastin prapë me diskutuar, sepse e ke mundësinë në pikën e veçantë. E dëgjojmë përfaqësuesin e fshatit. Secili ka me fol këtu derisa të shtirret diskutimi, deri në pikën e fundit. Edhe në fund dihet cili vjen procesi i votimit. Ndoshta, pa dashur me paragjykuar, kur t'i dëgjojmë hallet edhe të banorëve edhe të neve, ndoshta edhe Kryetari mundet me reflektuar në raport me këtë çështje, nëse ka bazë për të reflektuar. Z. Brahimi a e kam këtë te drejtë.

Valon Brahimi: Kryesues, qysh në fillim thashë: e juaja është me e procedu e imja është kundër sot, nesër, pasnesër.

Kryesuesi i Kuvendit z. Faton Peci: Atëherë, a ka dikush me diskutuar rreth rendit të ditës? Nëse s'ka diskutim. Jo, replikën e lë më vonë, ne e diskutojmë.

Shkëlqim Ibrahimi Në raport me propozimin te çështja, se ju po lypni kompromis ne po kërkojmë të tërhiqet pika, dilni, diskutoni me banorët, shpjegoni.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë dëshiroj që pika e rendit të ditës të trajtohet dhe të votohet, e jo të shmangemi vazhdimisht nga rendi i ditës. Nuk dëshiroj që t'i kushtojmë kaq shumë kohë kësaj çështjeje dhe t'i japim asaj një kahje që na detyron të merremi çdo ditë me të njëjtën temë. Në këtë mënyrë, po u shkaktojmë vështirësi si ekzekutivit, ashtu edhe Kuvendit. Njëkohësisht, po i vendosim edhe anëtarët, përkatësisht banorët e fshatit, në një pozitë të cilën, në të vërtetë, nuk e meritojnë.

Shkëlqim Ibrahimi: Shumë shkurt, sepse dëshiroj t'ju kursej kohën, duke pasur parasysh se kemi shumë pika të rendit të ditës. Megjithatë, në shenjë të bashkëpunimit që kemi pasur në seancën e kaluar, po tregojmë mirëkuptim maksimal. Tërhiqeni pikën, biscdoni me banorët dhe shpjegojuni interesin qytetar, si dhe arsyet pse prona me numër 35 është përcaktuar në atë mënyrë.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë jam i interesuar t'i dëgjoj banorët këtu, para kamerave dhe gjatë transmetimit publik, në mënyrë që secili qytetar, si nga fshati ashtu edhe nga Mitrovica, të ketë mundësi t'i dëgjojë dhe të krijojë përshtypjen e tij për sjelljen e tyre.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim rendin e ditës si në vijim:

1. Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit z. Egzon Mehmeti
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Draft Rregullore Nr. _/2026 Për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 08/2023 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve
4. Draft buxheti për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029

   4.1 Qarkorja Buxhetore 2027/02 për komuna
5. Propozim vendim për caktimin e pronës komunale për ndërtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit
6. Propozim vendim për formimin e Jurisë Profesionale për ndarjen e çmimit "Kadri Kadriu"
7. Propozim vendim për formimin e Komisionit për ndarjen e çmimit "Lah Nimani"
8. Propozim vendim për mbështetje financiare për katër familje të rrezikuara nga rrëshqitja e dheut në Lagjen Bair
9. Propozim vendim për miratim paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik\juridik të Parcelës Nr. P-71208072-01870-5
10. Propozim vendim për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik\juridik të Parcelës Nr. P-71208072-01870-5

11. Propozim vendim për miratim paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik\juridik të Parcelës Nr. P-71202012-00009-1
12. Propozim vendim për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik\juridik të Parcelës Nr. P-71202012-00009-1
13. Propozim vendim për formimin e Komisionit të Ankesave për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës
14. Kërkesë për transfer të mjeteve financiare në investime kapitale
15. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.02-060/01-0042000-17.1/26 dt. 29.07.2026
16. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.2/26 dt. 29.07.2026
17. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.3/26 dt. 29.07.2026
18. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.4/26 dt. 29.07.2026
19. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.5/26 dt. 29.07.2026
20. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.6/26 dt. 29.07.2026
21. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0035074-15/26 dt. 29.06.2026
22. Pyetje dhe përgjigje.

Rezultati i votimit (të pranishëm 30 anëtarë) 16 për, 14 kundër dhe 0 abstenime.

Rendi i ditës u miratua.

Pika 1

Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës z. Egzon Mehmeti

Kryesuesi ftoi subjektet më të mëdha politike të përfaqësuara në Kuvend që të propozojnë nga një anëtar për Formimin e Komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit.

Z. Shkëlqim Ibrahimi nga radhët e PDK-së e propozoi znj. Liridona Muharremi.

Z. Kushtrim Zeneli nga radhët e VV-së e propozoi znj. Sazan Ramaxhiku.

Z. Visar Syla nga radhët e Guxo e propozoi znj. Rozana Peci.

Kuvendi me shumicë votash (30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime). miratoi përbërjen e Komisionit.

Pas verifikimit të mandateve nga ana e Komisionit, Kryesuesi ftoi z. Egzon Mehmeti ta jap Betimin.

Egzon Mehmeti: *Unë, Egzon Mehmeti, betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.*

(Duartrokitje)

Pika 2

Kryesuesi i Kuvendit Hapi diskutimin.

Meqenëse nuk ka të lajmëruar për diskutim e kryesuesi i kuvendit hedh në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

Rezultati i votimit: (të pranishëm 30, 18 për, 0 kundër dhe 0 abstenime).

Kryesuesi konstatoi se procesverbali nga mbledhjet e kaluar u miratua.

Pika 3

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket Draft-Rregullore Nr.-/2026 Për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 08/2023 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve. Besoj që këndën e keni secili anëtar i Kuvendit përpara. Unë e hap diskutimin rreth kësaj çështjeje.

Igablle Islami: Sa i përket plotësim-ndryshimit të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe granteve, fillimisht, ndryshimi i parë që është vënë re është përkufizimi i fjalës „grant". Në Rregulloren ekzistuese, pra të vitit 2023, granti përkufizohet si transferim i mjeteve financiare, të njëjtën kohë edhe pajisje dhe makineri. Ndërsa, në këtë draft-Rregullore të cilën ju e keni proceduar, granti tash specifikohet vetëm si transferim i mjeteve financiare. Kështu që, përderisa kemi të bëjmë me subvencione,

transferim të mjeteve financiare, edhe granti tash përkufizohet vetëm si transferim i mjeteve financiare, pa marrë parasysh faktin që atëherë atje ndoshta edhe kanë me u ble pajisjet ose makineritë, mirëpo për momentin kemi të bëjmë me transferim. Unë dua të di ku është menduar të jetë dallimi praktik dhe juridik mes subvencionit dhe grantit, përderisa të dyja momentalisht janë vetëm transferim i mjeteve financiare. Është diçka pozitive që unë e kam parë që ju e keni ndërmarrë, është përfshirja e përkrahjes për familjet e riatdhesuara në kuadër të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim. Sa i përket arsimit, është paraparë subvencionimi i nxënësve si pasojë e mbylljes së shkollave në zonat e thella malore. Unë nuk po dua me i ndërlidhur dy tema të kundërta, se po dua me qëndruar pikërisht te draft-rregullorja, mirëpo ndoshta më lejohet që nga këtu të bëj kërkesë drejtorit të Arsimit që të na sjellë raportin edhe të shohim saktësisht cilat shkolla janë mbyllur, sepse këtu thuhet që do të subvencionohen nxënësit si pasojë e mbylljes së shkollave në zonat e thella malore. Kryetar, unë nuk e di nëse është menduar edhe Drejtoria e Arsimit në këtë rast, a ka planifikuar se a do të munden familjet e këtyre fëmijëve të sigurojnë transportin e këtyre nxënësve. Kemi të bëjmë me nxënësit të cilët do të transferohen, do të barten, d.m.th. nga Kaçandolli në Bajgorë, mandej nga Melenica në Trepçë. Ndoshta nuk do të kryejmë punë thjesht me subvencionim. Pse mos t'ju krijohet linja e rregullt e transportit edhe mos të jetë barrë financiare? Në këtë rast ndoshta nuk do të jetë se do të subvencionohen, mirëpo a do të kenë mundësinë praktike të sigurojnë transport në kohë të ndryshme, kur nxënësit kanë vajtje-ardhje në shkollë? Diçka tjetër që unë e kam parë te tabela numër një, ku për herë të parë shoh që është bërë një poentim sa i përket përfitimit në sektorin, në Drejtorinë e Bujqësisë. Shoh aty, në pikën e nëntë, e fundit, është dy pikë janë për personat me nevoja të veçanta. Nëse kjo kategori është vendosur si kriter, unë vlerësoj që duhet të ketë përparësi reale, jo të vlerësohet vetëm me dy pikë. Dy pikë nuk do të mund të ndikojnë, absolutisht, vlerësoj unë, në aplikacionet. Kështu që, pse mos të vlerësohen me pikë më shumë si kriter i veçantë edhe t'ju mundësohet personave me aftësi të veçanta ose status të veçantë të përfitojnë nga thirrjet e bujqësisë? E ndërsa, si diçka që e kam parë shumë shqetësuese, është pjesa e shëndetësisë. Janë larguar sëmundjet kronike të subvencionimit edhe, në kushtet e vështira financiare, ndërsa është përkufizuar që duhet të ketë gjendje të rëndë akute për me përfituar subvencione nga Komuna. Eliminimi i subvencionimit të familjeve të pacientëve të cilët kanë sëmundje kronike nuk është që do të mirëpritet në qytetin e Mitrovicës, ku ne e prijmë skemën e asistencës sociale. Kryetar, unë nuk e di, drejtoresha është e fushës së mjekësisë, mirëpo precizimi i sëmundjeve malinje, thënë me termat popullorë, kancerit, ku do të subvencionohen vetëm vitin e parë dhe të dytë, me të vërtetë është shumë shqetësues. Sëmundja e kancerit nuk ka fazë të kalimit. Nuk kemi të bëjmë me grip të zakonshëm, kështuqë, nëse thuhet që do të subvencionojmë sëmundjet malinje vetëm vitin e parë, eventualisht vitin e dytë, vlerësoj që është një diskriminim. Sëmundjet e kancerit, drejtoreshë, në shumicën e rasteve pas vitit të tretë krijohen ato metastazat, që po vlerësoj që po e dimë për çfarë po flasim. Kështu që, vlerësoj, Kryetar, që kjo absolutisht duhet me u larguar. Le të subvencionohen sëmundjet kronike, le të subvencionohen sëmundjet malinje, nuk mundemi me thënë që një sëmundje me kancer shërohet pas dy viteve. Edhe kam një pjesë tjetër, nuk e di me çfarë vlerësimi ka ardh në përfundim që duhet me u largu certifikata e gjendjes ekonomike dhe si kriter, me u marrë numri i anëtarëve të familjes. Nuk do të thotë domosdoshmërisht që, sa më shumë anëtarë të ketë një familje, aq më e rëndë është gjendja financiare. Certifikata e gjendjes ekonomike është ajo që me të vërtetë e tregon gjendjen financiare. Kështu që, nuk do të thotë që, nëse janë pesë anëtarë gjendja është më e rëndë sesa këta ndoshta që janë vetëm, të braktisur atje, të vetëm, edhe nuk munden me përfitua. Te Drejtoria e Mirëqenies sociale është përcaktuar tash edhe një nen i ri atje, që kemi të drejtë, si Asamble Komunale, të marrim vendim për subvencionim të njëhershëm të rasteve individuale. Mirëpo, sa i përket subvencionimit të OJQ-ve, ka mbetur prapë me u respektuar Rregullorja për Ndarjen e Subvencioneve, që është rregullorja e vitit 2017. Kështu që, edhe nga kjo Rregullore, po kërkoj shumë nga drejtori i Mirëqenies Sociale që të respektojë edhe Rregulloren komunale, edhe Rregulloren në nivel qendror, edhe gjatë vitit të ardhshëm fiskal të mos kemi subvencionim të OJQ-ve sipas kritereve të cilat nuk e di si po përcaktohen.

Erseka Barani: Gjatë shqyrtimit të kësaj Rregulloreje, e cila gjatë mbledhjes së Komitetit na ka ardhur pak me vonesë dhe nuk kemi pasur mundësi t'i japim të gjitha kërkesat tona gjatë mbledhjes së Komitetit, e kemi shqyrtuar dhe pajtohem me një pikë të parafolësit, znj.Islami, për sa i përket Drejtorisë së Shëndetësisë. Dua të filloj me një propozim konkret lidhur me këtë Draft-Rregullore për subvencione. Konkretisht, kemi nenin 19, paragrafi 2, për subvencionet dhe transferet në fushën e arsimit. Propozimi im është që në këtë dispozitë të përfshihet edhe mundësia e mbështetjes për transportin e nxënësve të shkollave të mesme, të cilët jetojnë në zona malore më shumë se 10 km larg shkollës dhe vijnë nga familje me asistencë sociale. Arsyetimi im është shumë i thjeshtë, asnjë fëmijë nuk duhet të ketë më pak mundësi për të vazhduar shkollimin vetëm për shkak

se jeton larg qendrës së qytetit dhe familja e tij nuk ka mundësi ekonomike për me përballuar transportin, kemi njohuri që sipas udhëzimeve administrative përkatëse, Komuna mund të mos ketë një obligim të drejtpërdrejtë për mbulimin e transportit të nxënësve të shkollave të mesme në këto rrethana, mirëpo, pikërisht këtu qëndron edhe rëndësia e këtij propozimi, për shkak se ne nuk po propozojmë që të krijojmë një obligim përtej kompetencave tona, mirëpo kërkojmë që, brenda mundësive dhe procedurave të subvencioneve komunale, të krijohet një mekanizëm për t'i ndihmuar fëmijët që ndodhen në një situatë të veçantë sociale dhe territoriale. Bëhet fjalë për nxënësit që jetojnë në zona malore, larg institucioneve arsimore, mbi 10 km larg shkollave, dhe njëkohësisht familjet e tyre janë përfitues të asistencës sociale. Janë dy faktorë me rëndësi: largësia dhe pamundësia ekonomike. Prandaj, mendoj se si komunë duhet të shkojmë përtej kësaj pyetjeje, se a jemi të obliguar me ligj ta bëjmë këtë. Mirëpo, çfarë mund të bëjmë ne, brenda kompetencave dhe mundësive tona, që një fëmijë në kushte të mira të ketë mundësi për të vazhduar shkollimin? Ky propozim do të jetë një investim në arsim, në barazi të mundësive dhe në mirëqenien sociale të familjeve tona. Kam qenë edhe vetë dëshmitare e disa familjeve në zonat e thella të Shalës së Bajgorës, të cilët për shkak të kushteve ekonomike e kanë pasur të vështirë shkollimin e fëmijëve, do të thotë, shkollimin e mesëm. Mendoj se kjo është shumë e targetuar dhe do të jetë e bazuar në kritere shumë të qarta: distanca mbi 10 km, vendbanim në zona malore, statusi i familjes në asistencë sociale dhe të ketë dokumentacion përkatës. Mendoj që Mitrovica do të jetë ndër komunat e para që ndërmerr një hap të tillë. Ndonjëherë, një masë që në buxhet nuk është një shumë e madhe, për një familje mund të ketë rëndësi shumë të madhe. Ne e dimë se sa pak kanë mbetur familje të cilat jetojnë në zonën e Shalës së Bajgorës dhe mendoj që është një numër tej mase i vogël i përkrahjes së atyre familjeve dhe t'u mundësojmë fëmijëve të kryejnë shkollimin e tyre të mesëm. Gjithashtu, duhet të shqyrtohen edhe ndryshimet në këtë Rregullore për subvencionet në fushën e shëndetësisë, ku në nenin 38, paragrafi 3, pika 3.1, thuhet se sëmundjet malinje të sapodiagnostikuara me kancer, trajtimi i tyre është një deri në dy vitet e para të trajtimit. Mendoj se duhet të jetë tre deri në pesë vitet e para, minimumi, për shkak se jo rastësisht edhe pensionet, invalidore kur jepen, minimumi e kanë pesë vite, për pacientët të cilët kanë kancer apo kanë sëmundje malinje. Gjithashtu, mendoj se në vijim të shtohet edhe paragrafi 3.4, ku përfshihen sëmundjet e rënda kronike të shoqëruara me çrregullime të tjera, terapia e të cilave nuk është e përfshirë në listën esenciale. Mendoj se subvencionet në shëndetësi ndahen me qëllim të lehtësimit të jetesës dhe shpenzimeve të familjeve që kanë vështirësi ekonomike. Gjithashtu, një përkrahje nga Komuna që tregon që mjetet e taksapaguesve tanë ndahen në mënyrë proporcionale dhe sipas nevojave konkrete të qytetarëve.

Shkëlqim Ibrahimi: Parimisht, plotësim-ndryshimi i Rregullores po duket që dukshëm e zgjeron sistemin e subvencioneve, veçanërisht mbështetjen, transportin e nxënësve, komunitetet, kthimin dhe shëndetësinë e mirëqenien sociale. Plotësim-ndryshimi i Rregullores po duket që e rrit, d.m.th. sistemin e subvencionimit për disa kategori që s'kanë qenë të prekura. Unë s'po përsërit në atë çështje që i gjetën vërejtjet kolegët asambleistë. D.m.th. rritet transporti, përkrahja për transportin e nxënësve, komuniteti dhe kthimi, bujqësia, shëndetësia dhe mirëqenia sociale. Mirëpo, unë i kam evidentuar disa gabime logjike. Për shembull, te faqja shtatë, te pjesa „Madhësia dhe struktura e fermës", 1.5, për pemishte, shkruhet se për çdo pemishte më të madhe se 0.5 hektar, d.m.th më të madhe se gjysmë hektari, pocntohet me 55 pikë. Ndërsa, te rreshti tjetër thotë çdo pemishte më e vogël se 50 hektar me 50 pikë. Kjo nuk ka logjikë, d.m.th. se mbivendoset kështu që i vjen një farë kufiri në mes të saj, d.m.th. më i vogël se, më i madh ose barazi me gjysmë hektari, 55 pikë, ndërsa më i vogël se 50 hektar, 50 pikë. Kështu që po mendoj që duhet me u përmirësu, sepse ndikon në vlerësim në të ardhmen edhe të poentimit total. Edhe transporti i nxënësve, besoj që duhet me u plotësuar me disa kritere më të caktuara, për shembull distanca, me u caktuar shuma dhe mos me lënë hapësirë që për raste të njëjta tani me u diferencuar ose me pasur pagesa të ndryshme. Kisha pasur qejf me i marrë parasysh këto të dyja, sidomos te pjesa e poentimit, sepse në të ardhmen, nëse lihet që kjo formë e poentimit dhe ky gabim logjik i ndërmjetëm të vazhdojë, mundet me rezultuar që dikush me u poentuar më shumë, edhe pse ka pronë më të vogël ose pemishte më të vogël. Kështu që, merreni parasysh.

Remzije Tmava Tupella: Përshëndetje për të gjithë. Faleminderit për pyetjen, znj. Islami. Në plotësim-ndryshimin e kësaj Rregulloreje, Drejtoria e Bujqësisë ka pasur arsye që ka kërkuar ndryshimin e kësaj Rregulloreje, d.m.th ndryshimin apo riformulimin e fjalës „grant". Ne, si Drejtori e Bujqësisë, duke i zhvilluar të gjitha procedurat legjislative që na i përcakton Rregullorja e Drejtorisë së Bujqësisë, kemi filluar në fillim ndarjen e subvencioneve dhe granteve, duke përfshirë dhe pa u kufizuar në grante, si për shembull ngritje serash, furnizim, mekanizëm bujqësor e projekte të ndryshme të fushës. Drejtoria e Bujqësisë është obliguar që, pas lejimit nga Kryetari i Komunës për inicimin e thirrjes publike, të iniciojë procedurat e prokurimit që ne

të zhvillojmë tutje. Por ne kemi ngecur në inicimin e procedurave të prokurimit, në përputhje me projektin apo vlerën që është, që do të realizohet për blerjen e atyre pajisjeve. Ky përcaktim procedural që ne të vazhdojmë tutje ka ardhur ndesh me kornizën ligjore të nivelit qendror, konkretisht Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Subvencionet dhe transferet karakterizohen si kode të veçanta ekonomike dhe nuk përbëjnë blerje të mallrave apo shërbimeve për nevojat e autoritetit kontraktues, sipas Ligjit për Prokurimin Publik. Fondet e ndara për subvencione dhe grante nuk i nënshtrohen rregullave dhe procedurave të prokurimit, si dhe Rregullores Financiare Nr. 01/2013 për Shpenzimet e Parasë Publike. Neni 21, pika 2, specifikon qartë që subvencionet dhe transferet nuk i nënshtrohen procesit të prokurimit. Andaj, ne e kemi bërë një kërkesë, duke qenë se aktet nënligjore komunale duhet të jenë në harmoni të plotë me ligjet prioritare të Republikës së Kosovës. D.m.th. ne kemi kërkuar që të amandamentohet neni përkatës i Rregullores Komunale për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe granteve, e cila na detyron kalimin e subvencioneve përmes prokurimit publik. Andaj, kërkesa ka qenë që të riformulohet procedura, duke specifikuar që ndarja e subvencioneve dhe granteve nuk i nënshtrohet rregullave të prokurimit, por realizohet përmes thirrjes publike për subvencionim, sipas legjislacionit financiar. Dhe, për përgjigjen tjetër për z.Ibrahimi, ishte vlera e pocntimit te pemishtet. Ma merr mendja, ne e kemi lëshuar atë gabim, po ajo është gabim teknik. Logjikisht, kush e sheh, shihet që është gabim teknik.

Igablle Islami: Po, drejtoresha u përgjigj kështu. Faleminderit shumë. Unë e kuptoj saktësisht arsyen pse ka ndodhur dhe pse është ndryshuar ky termi „grant". E di pikërisht që, për mos me shkuar përmes procedurave të prokurimit, kjo ka ardh si rrjedhojë e ndryshimeve atje në zotimin e mjeteve, para inicimit të procedurave të prokurimit. Drejtoreshë, unë atë pjesë po e kuptoj krejt shumë mirë që e keni ndryshuar. Po ne tash, meqenëse tash të dyja janë transferim i mjeteve financiare, cili është dallimi juridik edhe praktik që e keni menduar mes transferit, subvencioneve dhe granteve? Se unë po e kuptoj plotësisht, keni të drejtë kur e keni inicuar dhe unë e kam mbështetur edhe në KPF, prapë e mbështes, veç unë, më fal, nuk po shoh dallim tjetër praktik. Të dyja janë transferim i mjeteve financiare.

Remzije Tmava Tupella: Jo, është një dallim i vogël. Vetëm një fjalë e ndryshon. D.m.th. në ish-Rregulloren ka qenë: konsiderohet ndihma e dhënë nga Komuna në formën e transferimit të mjeteve financiare apo pajisjeve, mekanizmit, tek personat fizikë ose juridikë, e cila kushtëzohet me qëllim të plotësimit në të ardhmen të kushteve të përcaktuara në kontratë dhe si kusht, këto mjete ose pajisje do të përdoren për veprimtarinë që është përzgjedhur. Ndërsa tani, granti konsiderohet ndihma e dhënë nga Komuna në formën e transferimit të mjeteve financiare për realizimin e projektit tek personat fizikë apo juridikë, e cila kushtëzohet me qëllim të plotësimit në të ardhmen të kushteve të përcaktuara në kontratë dhe si kusht që këto mjete t'i përdorin për atë që është përzgjedhur. D.m.th. veç një ndryshim i vogël.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: E para, unë i mirëpres çdoherë vërejtjet dhe sugjerimet që i keni dhe, prej ditës së parë, ju kam thënë që unë do të thotë, udhëheqi institucionin me logjikën: folim, kush fol, që arsyeton, argumenton. Kam pirje të gjithë me i përfshi vërejtjet, sugjerimet, krejt ka. E dyta, znj. Islami, në momentin kur ne kemi dashur me bërë shpallje publike për përkrahjen e sektorit të bujqësisë, përgjigjja e Zyrës Ligjore ka qenë: në pesë vitet e fundit, mënyra e përkrahjes në sektorin e bujqësisë ka qenë e kundërligjshme. S'po them unë, ka qenë interpretimi i Zyrës Ligjore, të cilën ne e kemi ndalë shpalljen dhe jemi detyruar me u fut në plotësim-ndryshim të Rregullores, për shkak se Zyra Ligjore ka dhënë vlerësimin se pesë vitet e fundit, mënyra qysh janë dhënë subvencionet e grantet ka qenë e kundërligjshme dhe jo në harmoni me legjislacionin në fuqi edhe rregullativën e brendshme. Kështu që, kur dikush thotë që kjo është e kundërligjshme, unë ndalem. Do të thotë, munda me ecë ndonjë gjysmë hapi, veç kur s'e di. Do të thotë, kurrë s'e di, edhe munda ndoshta diku me bë ndonjë veprim, po me vetëdije unë kurrë nuk bëj veprim që është i kundërligjshëm. E tash, kjo puna e të mirës s'ka skaj. Tash po na thua: pse i kemi qit dy pikë për personat me nevoja të veçanta? Po ne e kena qit këta dy pikë. Pse s'i qitshe ti para neve dy? Ne me qit katër. Do të thotë, ne e kena qit këta dy. Ti s'ke qit asnjë. Po s'kemi çare pa e bërë një farë analogjie. A kupton, jo. O po thoni: pse i keni qitur dy pikë? Po ne i kena qitur dy pikë me diskriminu pozitivisht në një kategori të caktuar shoqërore. Ju s'ia keni vërejt hiç. Do të thotë, pse po na thoni pak? Po ne çka e kemi qikë dy? Po jemi me ia qit një kategorie, për me mund me i dhënë një farë avantazhi. Në proces të vlerësimit për subvencione e grante në bujqësi, dy pikë nuk janë pak. Do të thotë, kur të vjen ajo lista e përfituesve edhe në fund, kur bëhet ajo prerja, dy pikë munden me pasur një rol tepër pozitiv. Por, sido që të jetë, unë mendoj që diskutimin në përgjithësi e keni pas të argumentuar dhe i kontribuon ky nivel i debatit. Mendoj që drejtoresha e Shëndetësisë e ka borxh me dhënë shpjegimin te çështjet, se është çështje shumë sensitive kjo që ngriti edhe Erseka, do të thotë, çështja e furnizimit të barnave malinje,

apo qysh quhet, sëmundjeve malinje. Do të thotë, drejtoreshë, jepja shpjegimet. A ka të bëjë kjo me mënyrën e subvencionimit prej institucioneve qendrore apo pse e kemi të precizuar në dy vite?

Albina Kastrati Rama: Patjetër, Kryetar. Fillimisht, ta jap një sqarim se kemi ardhur deri te ndryshimi i Rregullores dhe i disa pikave të kësaj Rregulloreje, duke u bazuar në numrin e madh të kërkesave të qytetarëve dhe, konkretisht, prioritet dhe kërkesat më të mëdha kanë qenë të personave me kancer. Në anën tjetër, subvencionet, d.m.th buxheti që është ndarë ndër vite për subvencione, kanë krijuar kërkesa shumë të mëdha, ndërsa ndarja për këta dhe mbështetja për këta nuk ka qenë e mjaftueshme, ose, më mirë të them ka qenë simbolike. E pash, që pati reagime të ndryshimi i Rregullores, te pjesa e sëmundjeve kronike, duhet me sqaruar që kategoria e sëmundjeve kronike nuk është pa mbështetje. Këtë e them me përgjegjësi të plotë, për shkak se prej Ministrisë së Shëndetësisë, nga Lista esenciale e barnave, furnizohemi shumë mirë. Në anën tjetër, Komuna përkatësisht Drejtoria e Shëndetësisë, lidh kontratë për furnizime mjekësore. Në kuadër të saj ka edhe barna që janë për kategoritë e sëmundjeve kronike. D.m.th. personat, kategoritë që kanë sëmundje kronike, nuk janë pa mbështetje. Në secilën qendër të mjekësisë familjare, duke filluar prej QKMF-së, janë të furnizuar shumë mirë dhe qytetarët që vuajnë prej sëmundjeve kronike mund me i marrë ato çdo ditë. Tjetra, pse është kufizuar numri te sëmundjet malinje ose kanceret malinje? E kuptojmë shumë mirë që sëmundjet malinje e kanë fazën aktive, ose kur janë aktive ose agresive. Më falni ndoshta për termat mjekësorë që mund me gabu. Ne i kemi deri në dy vitet e para, ndërsa trajtimi, d.m.th faza më agresive, është dy vitet e para. Pastaj vjen ajo pjesa ku qetësohet dhe s'do të thotë që s'ka me pas rikthim të rasteve. Mirëpo, prapë kanë me u trajtu ato raste nëse ka rikthim pas dy ose tre viteve, ose pesë viteve, ose 10 viteve, për shkak se prapë ato llogariten që janë raste aktive. E bëra dallimin te një rast që është në vitin e parë apo në vitin e dytë dhe trajtohet me radiologji ose kimioterapi, edhe një rast që është pesë vite e ka suplemente ose terapi shumë më të lehtë. Cila duhet me pas prioritet? Sigurisht, këtu, për shkak që nëse do me dhënë mbështetje, le të jetë mbështetja konkrete, mos të jetë vetëm simbolikë me 70€, ose 50€, ose 100€, po le të jetë një mbështetje më konkrete. Edhe pse në qytetin tonë, fatkeqësisht, e kemi një numër shumë të madh edhe të rasteve të reja, që janë shqetësuese për secilin prej neve, edhe sidomos për Drejtorinë e Shëndetësisë. Të jemi real, çdo njeri prej neve, së paku nëse në familjen tonë e kemi një të afërm, ose prej shoqërisë, prej rrethit ku ne punojmë e jetojmë, kemi dikë që vuan me një kancer, atëherë prioritet i kësaj Rregulloreje kemi dashur që me qenë kanceret, edhe shuma e mbështetjes dhe subvencionet me qenë konkrete dhe shumë mbështetëse me të vërtetë, edhe jo vetëm simbolike. Problemi që ka qenë, edhe shqetësimi më i madh që ka qenë këtë vit te ndarja e subvencioneve dhe transfereve në Drejtorinë e Shëndetësisë, ka qenë 80.000 €, prej kësaj vlere kanë shkuar për një rast, për një problem, për një fatkeqësi që ka pasur mos t'ia përmendni rastin që kemi subvencionuar, ka shkuar shuma 6.000€. Në Drejtorinë e Shëndetësisë ka mbetur diku rreth 74.000 €. E për këto 74.000€ kemi pasur mbi 1.300 kërkesa. Llogaritni sa është shuma që mundet me u nda për 1.300 kërkesa, kjo shumë. Atëherë, nëse duam me i mbështet qytetarët dhe sidomos rastet e rënda, qoftë sëmundje akute, qoftë me të meta psikike edhe ngecje fizike, qoftë sëmundjet malinje, atëherë le të jetë mbështetja më e madhe. Mbështetje që atyre personave ua heq barrën së paku një herë në vit. Sa i përket pjesës së sëmundjeve kronike, çka mund me i subvencionuar ka qenë subvencionimi 50€. A mjafton për personat që kanë sëmundje kronike me u subvencionuar një herë në vit me 50€? Ata, unë vetë i kam parë pacientët, qytetarë që janë maltretuar dhe janë ardhë fillimisht me i pru dokumentet, pastaj me pyet kur po mbyllet, kur po hapet aplikacioni, kur përfitojmë. Krejt këto shpenzime, ka qenë 50€.

Ndërsa, në kuadër të kujdesit parësor shëndetësor, ne furnizohemi shumë mirë nga Ministria e Shëndetësisë, e thashë edhe më herët. Ndërkohë, si Komunë, lidhim kontratë për furnizime mjekësore, që shumicën, po them të gjitha, i marrin në Qendrat e mjekësisë familjare. Kështu që, edhe më lejoni të bëj thirrje qytetarëve që të afrohen në qendrat e mjekësisë familjare dhe, për çdo medikament që ata kanë nevojë në kuadër të kategorisë së sëmundjeve kronike, le të furnizohen. Mjafton me qenë qytetar i Mitrovicës.

Ferdi Kadriu: I nderuar Kryetar, NënKryetar, kryesues, ekzekutiv dhe kolegë asambleistë, i përgëzoj për iniciativën për plotësim-ndryshimin e kësaj Rregulloreje. Nuk është që nuk është e qëlluar, mirëpo gjatë procesit unë desha me i dhënë disa rekomandime. Po, meqenëse Kryetari tregoi çka ka konstatuar Zyra Ligjore, është ajo Zyrë Ligjore që ka konfirmuar ligjshmërinë e inicimit të procedurave, po ajo Zyre e Prokurimit, po ajo Zyre e Financave. Kështu që, në këtë formë, mirë që ju ka kujtuar, e respektojmë edhe vazhdojmë tutje. Cilat janë rekomandimet e mia? Është që Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, neni 11, paragrafi 1, parasheh që pagesat direkte janë e drejtë ekskluzive në nivel kombëtar, dhe në paragrafë të tjerë e përcakton se qysh duhet me u rregullu në nivel komunash. Andaj, ajo çfarë tha edhe drejtoresha, që të jemi në përputhje me

normat dhe aktet më të larta ligjore, këtë Rregullore konsideroj që duhet me bë një rivlerësim, për shkak që mund të ketë mospërputhje. Faktikisht, ka mospërputhje sa i përket pagesave direkte. Po ashtu, edhe Udhëzimi Administrativ i vitit 2026 për pagesa direkte që e vë Komunën në obligueshmëri të zbatimit të saj. sa i përket rastit të atyre dy pikëve, në tabelarin që është përcjellë me këtë Draft-Rregullore, mungojnë nja pesë pikë. Kështu që, për këto rastet specifike, që me bërë tamam 100 pikë, jo 95 pikë, besoj që është gabim teknik dhe e respektojmë këtë. Mundemi, në propozimin e znj Islami, t'i vëmë edhe 5 pikë dhe janë 7 pikë për personat me nevoja të veçanta. Kështu që do të kisha rekomanduar, Kryetar, me tërheq, me kqyr me u konsultuar me Zyrën Ligjore edhe me kqyr përputhshmërinë me Ligjin 08/072 dhe me kqyr a mundet me vazhdu. Po flas vetëm për pagesa direkte. Për pjesën tjetër, në rregull jemi. Besoj që keni me pas mbështetje gjithçka që është në të mirën e fermerëve. Atë e kemi dëshmuar që një kohë të gjatë.

Igballe Islami: Gjatë diskutimeve me Kryetarin, e vërej që në fund prapë thotë: „Keni qenë të argumentuar", mirëpo po vlerësoj që nuk më ke dëgjuar. Unë e kam thënë dhe e vlerësoj shumë që ke vendosur me i prioritizuar, faktikisht, në atë tabelë. Mirëpo thashë: a ndikon realisht? A ndikon realisht? Edhe prapë mendoj që ndoshta nuk ndikon realisht. Kryetar, te puna e legjislacionit po duhet me u ndalë edhe me diskutu, se nuk është mirë tash vetëm ju me iu drejtu qytetarëve dhe me thënë që Zyra Ligjore ka vlerësuar që është bërë shkelje sa i përket dhënies së subvencioneve në Drejtorinë e Bujqësisë. Kryetar, ju e potencuat që edhe ju keni filluar me iniciuar procedurën e prokurimit për blerjen e pajisjeve apo makinerive. Po tash ne jemi të vetëdijshëm, krejt kjo ka ndodhur si rrjedhojë e ndryshimit që kërkohet: zotimi me rastin e inicimit të aktivitetit të prokurimit. Që i bie që, përderisa nuk e dimë kush do të jetë përfitues, nuk mundet Drejtoria për Buxhet dhe Financa me i zotu mjetet. Kjo ka qenë problem. Se, përndryshe, njëjtë kishit pasur me vazhduar edhe ju. Kjo është: Drejtoria për Buxhet dhe Financa nuk ka mundësi me i zotuar mjetet pa e pasur ID-në e përfituesit. Kështu që, përderisa ne nuk e kemi përfituesin e zgjedhur, nuk mundemi me hapë dhe me i zotu mjetet. Përderisa Zyra e Prokurimit e kërkon zotimin, ti nuk mundesh me nxjerrë një zotim ku nuk e din realisht kujt kemi me ia transferuar ato mjete. Krejt ky është ndryshimi që ka ndodhur në këtë vit, që është lidhur edhe prokurimi me SMFK-në. Kështu që, për qartësimin e qytetarëve, është mirë edhe me dhënë këtë informatë, se jo gjithçka që ka qenë pesë vitet e fundit është edhe tash njëjtë. Te poentimi, po vlerësoj, nëse ka hapësirë me u shtuar ato 5 pikë, jam shumë e interesuar që me të vërtetë me kriju një hapësirë, me kriju prioritet të aplikantëve të cilët janë me nevoja të veçanta apo status të veçantë, qysh janë quajtur edhe aty.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: E pata të paqartë. A din, si ish-ministër i Bujqësisë, një çështje nëse s'gaboj, ke qenë drejtor i Bujqësisë mandatin e kaluar. Tash, unë u mundova me të kuptuar, po prej rasteve kur s'arrita me kuptu te diskutimi yt, për shkak se fillove me përgëzimin që e kemi futur në plotësim-ndryshim. Më vonë the që plotësisht ndryshimet e bëra janë në kundërshtim me ligjin, përkundër që ne ju kemi përmbajt Zyrës Ligjore, edhe në fund the që prapë kemi përkrahur, është në dobi të sektorit të bujqësisë. E pranoj që prej pak rasteve ku pak , për mua, si rrjedhë logjike të diskutimit, s'e mora vesh. Se the: „Ju përgëzoj", mandej the: „Jeni duke bërë gabim edhe po bëni veprime të kundërligjshme", edhe përfundove fjalinë duke thënë që, do të thotë, e përkrah çdo iniciativë që shkon në dobi të përkrahjes së fermerëve. Unë lidhje kam pas me bujqësinë, po jam bërë ministër i Bujqësisë. Po prej se jam bërë ministër i Bujqësisë, do të thotë, e kam pikë të dobët këtë kategori, me thënë shumë sinqerisht. Tash e kemi buxhetin, kategorinë ku më së shumti e kam rrit buxhetin në bujqësi, për shkak se e përjetoj si përqindje, po flas si përqindje, po e keni lënë poshtë. Edhe çështja tjetër është që e përmende Udhëzimin Administrativ. Do të thotë, Udhëzimi Administrativ është politika vjetore e ministrit të Bujqësisë. Është e drejtë ekskluzive që i përcakton vlerat, prioritetet e çështjet e tjera. Po, me Udhëzim Administrativ, në kuptimin caktohen kufijtë. Udhëzimi Administrativ për pagesat direkte ose subvencionet nuk e përcakton modalitetin edhe politikën komunale. Do të thotë, duke qenë tash unë kompleksove pak, se duke qenë katër vjet ministër i Bujqësisë, edhe një vjet ministër në detyrë, do të thotë, unë asnjëherë nuk ia kam imponu asnjë komune çka me bë me sektorin e bujqësisë. Do të thotë, janë të përcaktuara ato norma, sipërfaqet janë të caktuara, vlerat minimale dhe maksimale, po asnjëherë Udhëzimi Administrativ nuk merret me politikën komunale të një komune: çka prioritizon, çka përkrah dhe çka ka prioritet në sektorin e bujqësisë. Kështu që, këto të dyja ndoshta edhe s'i kam kuptuar drejt. Do të thotë, nuk e përjashtoj si mundësi, por veç të qartësojmë si çështje. Ndërsa, në parim, unë mendoj që çdo vërejtje dhe sugjerim mundet me u inkorporuar dhe me u votu. Do të thotë, si plotësim-ndryshim, kjo Rregullore. Ama tash, veçse edhe një çështje tjetër the, që është e njëjta Zyre që ka thënë që është e ligjshme, neve na ka thënë s'është e ligjshme. Unë veç një di me ju tregu: kurrë në jetën time, as si ministër, as si Kryetar, s'ka shans me thirrë Zyrën Ligjore edhe me i thënë që për këtë proces doni me kthy andej drejtimin. Asnjëherë. Zyra Ligjore

është autonome, duhet me qenë tepër profesionale, kredibile, që cakton se çka do, çka duhet, çka s'duhet, çka bëhet, çka s'bëhet, nëse bëhet, qysh s'bëhet, qysh bëhet, edhe kaq. Kështu që nuk po mundem, se në rast se e njëjta Zyrë Ligjore, tash nuk e di unë edhe të njëjtin individ, por nuk mundem për të njëjtën çështje me dhënë interpretim të ndryshëm.

Ferdi Kadriu Kryetar, pikërisht ajo Zyrë ligjore që e ka bërë pak mjegull është që mua më ka lejuar me zhvillu procedurat kështu që kjo është specifika. Përndryshe, sa i përket ligjit, unë tregova që nuk ka përputhje me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. D.m.th. kjo është informata që e dhashë, që mundet me marrë drejtoresha, me marrë komisioni edhe me shqyrtua. D.m.th. është përgjegjësia e tyre. Ajo çka po e them nuk po e them veç për një konsum ditor, po e them për një praktikë më të mirë. Sa e mbështes a s'e mbështes, unë tregova një bindje personale, po nuk do të thotë që nuk mundem me gjet vërejtje nëse ka gabime. Për çka e tha edhe ti, që jam i zotuar çdo këshillë dhe rekomandim me e marrë, këto janë jashtëzakonisht specifike. Normat juridike të nevojshme i ceka që me i pas edhe komisioni parasysh. Ky është qëndrimi im. Sa i përket pikëve, veç me sqaruar, janë 95 pikë. Del totali në tabelar. Edhe një herë, këtë me mirëkuptim po e them kështu, që te propozimi i drejtoreshës mundet me u bë shtatë.

Erseka Barani: Desha me falënderua drejtoreshën e Shëndetësisë për reagimin, mirëpo mos të harrojmë që ne kemi edhe njerëz që kanë epilepsi, mos të harrojmë që kemi njerëz që janë me aftësi të kufizuara, kemi njerëz me sëmundje kardiovaskulare, rejt këta po përjashtohen me këtë Rregullore. Përveç kësaj, nëse ka sëmundje kardiovaskulare, ka edhe sëmundje të tjera që janë bashkë me të. Kështuqë mendoj që, për mos me i përjashtuar ata njerëz, do të ishte mirë. jo rastësisht e ceka që të paktën të shtohet edhe pasuesi për sëmundjet që nuk janë të përkrahura në listën esenciale, në mënyrë që mos me i lënë jashtë njerëzit. Vetë si drejtoreshë e Shëndetësisë e kuptoj shumë mirë shqetësimin e drejtoreshës, e di presionin që i bëhet komisionit, e di presionin që i bëhet prej qytetarëve, prej pacientëve që kanë sëmundje edhe Drejtorisë për Shëndetësisë, mirëpo mos të harrojmë që këto mjete janë të taksapaguesve dhe duhet në mënyrë të barabartë dhe gjithëpërfshirëse të shpërndahen te secili prej tyre. Meqenëse pas kësaj pike është edhe pika e buxhetit, do të jetë një kërkesë për shtim në subvencione nga ana ime në Drejtorinë për Shëndetësi.

Shefki Begu: Për arsye të numrit të vogël të nxënësve në dy fshatrat, Kaçanoll dhe Melenicë, ne jemi detyruar t'i mbyllim këto shkolla, në Melenicë kanë qenë gjithsej gjashtë nxënës, në Kaçanoll kanë qenë tre. Nxënësit e Melenicës i kemi dërguar në shkollën amë në Trepçë kurse të Kaçanollit jemi të detyruar me i bërë këtë Plotësim-Rregullore, sepse s'ka vijë të rregullt transporti. Të gjithë mësimdhënësit i kemi sistemuar në shkolla të tjera dhe nuk ka kurrfarë problemi. Sa i përket znj.Barani, e mbështes këtë plotësim të Rregullores për me subvencionuar edhe nxënësit e shkollave të mesme, sepse e kishte specifikuar shumë mirë me kilometra. D.m.th. edhe në Shalë nuk ka shumë nxënës. Kemi kërkesa në Drejtori të Arsimit për këtë çështje nga prindërit e atyre nxënësve.

Shkëlqim Ibrahimi: Është mirë me bë një praktikë që drejtorët me dhënë një konkluzion përfundimtar: cilat kërkesa i pranojnë dhe cilat s'i pranojnë. Deri tash vetëm drejtoresha e Bujqësisë dha përgjigje konkrete, pra që është një gabim teknik dhe përmirësohet. Edhe ju, drejtor, kështu që edhe unë e përkraha një iniciativë për transportin e nxënësve të shkollave të mesme. Është shumë e qëlluar. Por të gjitha kërkesat e tjera, me dalë me një konkluzion: a i pranoni apo s'i pranoni, me na lehtësu edhe neve. Nëse mendoni me na shpërfillë komplet, atëherë po krijohet një praktikë jo e mirë parlamentare. Edhe ne jemi të interesuar me e përkrah këtë Rregullore, po jo me injorim total. Dilni me konkluzion çka mundet, çka s'mundet, nëse s'ka pasur buxhet, tregoni a keni kërkuar me u rrit buxheti apo jo.

Kryesuesi i Kuvendit: D.m.th. krejt është ideja te Rregullorja, me i harmonizu të gjitha këto nevoja. Kështu, d.m.th. ndryshimi bëhet. Ekzekutiv, cilat vërejtje duhet me u fut në Ndryshim të Rregullores, sepse kjo aprovohet sot edhe jetë qashtu. Është mirë me i marrë për bazë vërejtjet të cilat u dhanë prej Kuvendit. Edhe pse kjo çështja e vërejtjeve, një diçka është e vërtetë, sepse ne të gjithë apo një pjesë të madhe, kemi qenë pjesë e ekzekutivit po edhe në Kuvend, që është e vërteta, ka nevojë që ekzekutivit me i dhënë vërejtje konkrete. Sikurse që te rasti me pikë, d.m.th. sepse edhe ne tash në këtë rast, me sekretarin bashkë, kemi nevojë me e ditë se cila vërejtje konkrete miratohen. Sepse pjesa dërrmuese e diskutimeve kanë qenë pak a shumë, qysh me thënë, jo diçka konkrete si vërejtje në parim, po që është problem. Tash unë me i nxjerrë këto konkluzione, përderisa ju s'i keni të qarta, unë me ia nxjerrë konkluzionin edhe me qit në votim. Kërkesa e Igballit ka qenë për pikë edhe sëmundjet malinje me qenë të përfshira në Rregullore. Tash, edhe vërejtja e znj.Barani që tha se

ka edhe shumë sëmundje të tjera të cilat mundemi me i përjashtu. D.m.th. është mirë me i rrumbullakësu, sepse kjo miratohet sot edhe jetë ashtu.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci Te çështja e sëmundjeve malinje, drejtoreshë, nëse e kuptova drejt, e dha një shpjegim, tha është e precizuar dy vite, por kjo nuk e përjashton mundësinë që, në rast riaktivizimi. Do të thotë, megjithatë edhe me procesverbal, çka po diskutojmë këtu, mundet me qenë tani me u inkorporu ose me sugjerime konkrete. Po edhe unë jam i thirrur që ajo mos me qenë e kufizume, se dikujt mundet, do të thotë, me pas një pauzë mbas një ose dy viteve, me ju riaktivizu mbas shtatë viteve. Kështu që kjo është çështje shumë e ndjeshme, për të cilën unë e përkrah idenë që mos me pasur kufizim kohor.

Albina Kakstrti Rama: Te pjesa e riaktivizimit të sëmundjeve malinje, në momentin që ai riaktivizohet, nëse riaktivizohet pas 15 vitesh, prapë ai llogaritet rast aktiv që është prioritet për subvencionim. Te pjesa që e potencoj të sëmundjet kardiovaskulare, janë këto rastet, d.m.th sëmundjet dhe rastet akute shëndetësore. Konkretisht janë sëmundjet kardiovaskulare, mos t'i përmend, për shembull, bypass-et e të tjerat, stentat. Ato janë raste akute shëndetësore që duhet me u subvencionu. Te personat me invaliditet, atëherë i kemi këto lëndime të rënda nga fatkeqësitë. Tash s'kemi dashur ne me i cek çfarë lloj fatkeqësie mundet me qenë. Mund me qenë fatkeqësi në komunikacion, mund me qenë si rasti i Kçiqit, aty djegia me bombolë, ose raste të tjera, ose rrëzimi prej një lartësie të madhe.

Erseka Barani: Është e qartë, personat me aftësi të kufizuara po përjashtohen nëse kanë sëmundje kronike. Kjo është ideja. Në automatizëm po përjashtohen prej kësaj. Unë nuk e di a ka ndodhur ndonjëherë në një komunë, kam shiku krejt komunat, në asnjë komunë nuk janë larguar sëmundjet kronike. Qëllimi i subvencioneve nuk është veç për sëmundjet malinje, por është për të gjitha sëmundjet.

Albina Kastrati Rama: Po, veç nëse i ke përcjellë komunat e tjera, asnjë komunë tjetër nuk ka 1 milion kontratë për furnizime mjekësore. 1 milion e më tepër. mbështetjen, nuk ia ndalëm. E thashë edhe më atëherë. Mirë, a keni llogaritur pakënaqësitë e qytetarëve që vijnë çdo ditë e nuk marrin, ose shuma është simbolike? A është mbështetje me 20€? Çfarë mbështetje me 30€ ose 50€?

Igballe Islami Për që ta kam përmendur emrin, drejtoreshë, besoj që nuk deshe në fjalimin tënd të parë me t'u kapë aty për fjalë, kur çka janë 50€. Po më vjen shumë keq, mirëpo nëse thu i kanë përfituar, veç çka janë 50€, i kanë shkuar shpenzime. Të jesh e bindur që unë kam pranuar SMS, jo që e kam vërejt kështu në këtë farë detaji vetë, për sëmundje kronike, ku kam pranuar kërkesa prej qytetarëve. Për dikë janë shumë 50€. Nëse për neve këtu nuk janë 50€ shumë. Duhet të jesh e bindur. E ke afër drejtorin e Mirëqenies Sociale, tregon shkallën e papunësisë, tregon shkallën dhe nivelin e skemës sociale që është Mitrovica, e atëherë e kupton që edhe 50 € janë shumë për ta. Nuk desha me të replikuar, mirëpo mos e bëj këtë shumë që është 50 €. Ne këtu, si asamble komunale, duke përfshirë edhe Ersekën, që ka qenë ish-drejtoreshë, jemi. Dy pika të rendit të ditës. Tjetra është draft-buxheti komunal për vitin 2027–2029. Në të njëjtën kohë, në vitin e ardhshëm ka me pas bartje të hyrave. Të gjithë ne kemi me insistuar që me u rrit kategoria e subvencioneve në Drejtorinë e Shëndetësisë. Kurrë nuk e pranoj këtë me thënë 50 € nuk janë kurrgjë sepse 50 € për dikë janë shumë.

Kryesuesi i Kuvendit Mirëpo, diçka duhet me u pajtu: tash nuk janë të mjaftueshme ato 50 € dhe ideja është që me i rrit ato.

Albina Kastrati Rama: Është shumë ndoshta e madhe për një qytetar, kini parasysh, është vetëm një herë në vit, tjetra, maltretimet që ju bëhen krejt vitin, se ata janë mësuar me marrë pare dhe me u maltretu, në fakt ishin mësuar. Realisht, ka me pas subvencione në janar, ka me pas shkurt, mars, krejt vitin. Ata, sa shpenzime ju shkojnë për me ardhë krejt vitin? Ku janë 50 €? Pastaj, a i mbulojnë ato shpenzime, veç vajtje-ardhje deri në komunë? Është qytetari ai që e vlerëson a ka nevojë, a ka pas pakënaqësi. A ka pas? A mundesh, për shembull, me një subvencion prej 80.000€ me i përfshi 1.000 raste? Një sëmundje, po mendoj raste kronike, është subvencionim. Ai pastaj ka me kriju pakënaqësi. Për shembull, kemi dy raste tash me sëmundje kronike. Unë po i marr 50€, rasti tjetër nuk po i merr. Atëherë, cila është barazia e këtyre rasteve në raport pastaj me sëmundje të tjera kronike? Po mendoj sëmundje të rënda si kanceri, sëmundje të tjera, sëmundje psikiatrike, ngecje mentale, raste akute shëndetësore.

Kryesuesi Kuvendit: Meqenëse besoj që e dini çështjen e Rregullores, në momentin që aprovohet nga Kuvendi, ne brenda shtatë ditëve nga votimi në Kuvend jemi të detyruar që Rregulloren ta përcjellim te Ministria e Pushtetit Lokal për interpretim ligjor. Nuk e di a ka mundësi që këto vërejtje të cilat u dhanë, komisioni, drejtoritë ose drejtoria t'i inkorporojnë, në mënyrë që të kompletohet rregullorja. Mirëpo, gjithmonë duke u bazuar në vërejtjet të cilat u dhanë në Kuvend, sepse nuk mund të futet diçka tjetër përderisa nuk është

diskutuar këtu. Prandaj, me këto vërejtje të cilat u dhanë nga anëtarët e Kuvendit dhe sugjerimet nga ekzekutivi, unë besoj që debati është shterur. Unë e qes në votim Rregulloren me vërejtje të aprovuara.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Në shumë shkurt, te neni 20, ju keni referuar te çështja e trajtimit të sëmundjeve, për shembull, ndër të tjerash, te sëmundjet e sapo diagnostikuara me kancer, sëmundjet malinje, si dhe trajtimi i tyre deri në dy vitet e para të trajtimit, do të thotë eliminohet afati i trajtimi këtu. Të bëjmë të gjithë çmos dhe, ishalla, kemi sa më pak raste. Lutja jonë është për sa më pak raste. Meqenëse po e jap këtë draft, s'po di a e ke evidentu ti Kryesues, apo Nazmiu, s'ka rëndësi, fëmijët me ngecje fizike dhe probleme psikike, rastet e rënda akute dhe kronike, edhe votojeni.

Tash vetëm një diçka është problematike, se jo të gjitha tani do të kenë mundësi buxhetore dhe tani vjen pyetja: kuptimi i trajtimit të barabartë është edhe një parim juridik. Do të thotë, kush aplikon i pari, i pari merr. Për shembull, në bujqësi në Shqipëri marrin vetëm 20% të fermerëve subvencione; ata të parët që aplikojnë i marrin, 80% të tjerët nuk marrin subvencione fare. Kështu që edhe këtu, meqenëse nuk mundemi me mbuluar krejt koston e sëmundjeve kronike, ka me u imponu që subvencionin ta marrin ata që aplikojnë të parët.

Erseka Barani: Ideja është që rasti dallon prej rastit. Mund të ketë kritere që e përcaktojnë. Ka pacientë që kanë dokumente që dëshmojnë se shpenzimet e tyre, edhe psc janë me një sëmundje të njëjtë si dikush tjetër, janë shumë më të larta. Ka raste që dallon edhe gjendja ekonomike familjare. Do të thotë, janë kriteret që e përcaktojnë se kush përfiton i pari në këto subvencione. Kështu që mos e keni atë hall, sepse ato janë të rregulluara me legjislacion. Mirëpo, mendoj që nuk duhet të përjashtohen sëmundjet kronike nga kjo Rregullore.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë te rasti i tabelës me pikë 100 ku duhet drejtoreshë.

Remzije Tmava: Po. Te kriteret specifike për sistemin e vlerësimit. Përshëndetje. Faleminderit për pyetjen. Te kriteret specifike të vlerësimit, te tabela, d.m.th te madhësia e pemishteve për hektar, kjo po shihet që është gabim teknik. Vetëm bëhet rregullimi. D.m.th. nga 50 vetëm rregullohet. Tek poentimi, unë ju kisha dhënë prioritet femrave si persona fizikë, pronarë të fermës ku zhvillohet aktiviteti, të dëshmuar me NIF, d.m.th gjinisë femërore që aplikojnë për grante dhe subvencione, me iu shtuar dy pikë, d.m.th gjithsej shtatë. Pra gratë fermere, dy pikë tek pika dy, vendi i investimit, ku është realizimi i investimit në zonat malore. Ndërsa femra si person, dy pikë plus pesë, bëhen shtatë. Gjithsej bëhen shtatë. Edhe te aplikuesit e rinj, numër pesë, një pikë. Aplikuesi i ri në momentin e aplikimit, personat deri në 40 vjet, plus dy pikë. Edhe personave me nevoja të veçanta, një pikë, d.m.th bëhen pesë me të tjerat.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë e hedh në votim, Draft-Rregulloren Nr. _/2026 Për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 08/2023 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me vërejtjet e Kuvendit, me vërejtjet e anëtarëve të Kuvendit.

Rezultati i votimit: të pranishëm 28, 28 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoj se unanimisht u miratua Rregullorja Nr. 3/2026 Për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 08/2023 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

Pika 4

Kryesuesi i Kuvendit: Kalojmë te pika e katërt, buxheti për vitin 2027 dhe vlerësimi për vitet 2028–2029, si dhe qarkorja buxhetore 2027/02 për komuna. E hapim diskutimin. Fillimisht vazhdojmë me grupet parlamentare.

Igballe Islami: Kryetar, në Komitetin për Politikë dhe Financa nuk kam diskutuar sa i përket Draft buxhetit me të vetmin qëllim që kam dashur ta shoh vizionin dhe misionin e drejtorive sa i përket buxhetit të vitit 2027–2029, krejt kjo sepse, kur e kam marrë buxhetin, kam parë që buxheti është komplet i orientuar vetëm në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, saqë më është krijuar bindja që disa drejtori kanë kaluar në sektorë, nuk ka të bëjë me drejtorinë. Tash, unë e kam parë vizionin dhe misionin e drejtorive dhe shoh që të gjithë kanë mision të gjithë kanë vizion. Mirëpo, nuk e di nëse këta nuk kanë arritur të të bindin edhe ty që të vendosësh buxhet në drejtoritë e tyre dhe t'u japësh mundësi që t'i kryejnë projektet sipas vizionit të tyre. Në Komitetin për Politikë dhe Financa, Drejtori për Buxhet dhe Financa, Kryetar, ka propozuar ndryshime dhe me ato ndryshime, është aprovuar buxheti për vitin 2027–2029 në Komitet. Ka pasur të bëjë me disa ndryshime në kategorinë e mallrave dhe ka pasur të bëjë me shtimin e vlerës së projektit në çerdhen e fshatit Kçiq për 450.000 € në vitin 2028. Ndryshimet janë reflektuar në kategorinë e mallrave, mirëpo nuk janë reflektuar në

kategorinë e kapitaleve te çerdhja në fshatin Kçiq. Kështu që, drejtori ma kthen këtë përgjigje: është aprovuar buxheti në Komitet me 450.000 € në vitin 2028 për çerdhen në Kçiq. Ka qenë propozimi i tij. Sa i përket pagave, nuk është që kam pasur ndërmend të dalim nga kategoria e pagave si kategori ekonomike, mirëpo vetë fakti që për herë të parë dorëzohet buxheti dhe e kemi vetëm totalin e stafit të aprovuar prej 1.965 staf dhe mbi 18.000.000 € paga, rrjedhimisht nga kjo pozitë unë nuk e kam të qartë se ku do të shpërndahen këta staf, për më tepër, unë kërkoj zotim të qartë para Asamblesë Komunale që ju do ta respektoni qarkoren buxhetore dhe kriteret e përcaktuara me të, veçanërisht me shpërndarjen e stafit në arsim dhe shëndetësi, meqenëse për momentin nuk e kemi të shpërndarë. Një çështje tjetër sa i përket stafit dhe pagave: meqenëse nuk e keni pasqyruar, duhet të vazhdojmë të diskutojmë edhe te kategoria e pagave dhe stafit. A e keni planifikuar stafin për funksionalizimin e çerdhes te DESI, e cila është në fazën e fundit të punimeve atje? Kalojmë te kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Në këtë kategori, përtej faktit që kjo kategori është rritur krahasim me buxhetin e vitit të kaluar, ne kemi ulje të buxhetit nëpër drejtori, siç është Drejtoria e Integrimeve Evropiane e Zhvillim Ekonomik, Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore me 140.000 €. Pastaj Administrata, Shëndetësia, Mirëqenia Sociale kanë ulje. Kultura, Rinia dhe Sporti ka ulje për 30.000 €. Më e dhimbshmja është që ka ulje në buxhetin e arsimit fillor dhe të mesëm me 176.000 € në total. Kështu që arsimi ka ulje të buxhetit edhe në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa në shëndetësi nuk shoh asnjë rritje, përderisa po i referohemi edhe furnizimit me barna në QKMF. Vlerësoj se arsimi dhe shëndetësia nuk po trajtohen thjesht si prioritete. Nuk po e shoh të reflektuar në buxhetin komunal për vitin 2027–2029. Mirëpo, paradoksalisht, përderisa të gjithë kanë ulje të buxhetit, shohim një rritje shumë të madhe te Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, që ka arritur 905.000 € shtesë. Është e vetmja drejtori që ka përfituar shtesë në mallra dhe ka arritur të ketë një buxhet rekord ndër vite, me 1.7 milionë € mallra dhe shërbime. Te analitika, unë e kam kërkuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, në faqen tetë, kushdo që e ka draft-buxhetin para vetes e sheh sa gabime ka në analitikë. E marrim faqen numër 8, e kemi Zyrën e Kryetarit, e cila është e buxhetuar me vetëm 30.000 € mallra, ndërsa totali aty është 243.000 €. Kryetar, ne këtu nuk jemi me hamendësua se çka është ajo diferenca tjetër. Ne flasim këtu bazuar në draft-buxhetin që e keni proceduar. Ka kaluar në Komitet, vjen këtu dhe ka gabime të hatashme. Nëse e marrim Zyrën e Kryetarit dhe shkojmë te tabela 4.1, është një vlerë krejt tjetër financiare. Kështu që unë ende nuk mund ta di cili do të jetë buxheti final sa i përket Zyrës së Kryetarit, po e marrim si shembull. Sa i përket analitikës, analitika kërkohet me një qëllim të vetëm: që të shohim se si do të shpërndahet buxheti, varësisht nga natyra e shpenzimit. Te Zyra e Kryetarit, Kryetar, nuk e di nëse të kanë pyetur, mirëpo krejt mjetet i kanë buxhetuar në një kod, që i bie që ti s'ke me ble as ujë, as furnizim për zyrë. E ke vetëm shërbime kontraktuese të tjera. E ke lirinë me bërë vetëm një procedurë dhe furnizime të tjera për stafin e kabinetit të Kryetarit nuk ka me pas. Po flas sipas draft-buxhetit tuaj. Një çështje tjetër, një kod ekonomik tjetër që vlen të potencohet, është se në seancën e fundit, kur është shqyrtuar raporti financiar i janar-mars, është thënë që fatkeqësisht ish-qeverisja ka shpenzuar mjete financiare për shërbime të avokaturës dhe të përfaqësimit. Ndërsa unë ju them që edhe ju paskeni planifikuar për vitin 2027 vlerën 27.000 €. Nuk po ju them fatkeqësisht, por po i referohem juve, se unë vlerësoj që është diçka shumë konkrete, shumë e mirë si për komunën, për përfaqësim të rasteve në gjykata. Mirëpo duhet të kemi pak kujdes gjatë formulimit edhe kur e kritikojmë tjetrin, se a po vërejmë që na keni kritikuar në seancën e fundit dhe menjëherë e keni vepruar ju njëjtë tash. Çka me thënë? Po vazhdojmë tutje te Drejtoria e Shërbimeve Publike. Në analitikë më ka interesuar shumë ta shoh se si ka vlerësuar drejtori ta shpërndajë buxhetin. Nëse drejtori ma deshifron çfarë është shërbim kontraktues tjetër, çka është mirëmbajtje rutinore, çfarë është mirëmbajtja e auto rrugëve, krejt këto i ke buxhetuar me të njëjtin kod. Ku është mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese? Apo ke menduar me e fut aty te shërbimet kontraktuese të tjera? Përndryshe, nëse buxheti në mallra është 5.000.000 € të jeni të bindur që mbi 3-4 milionë janë krejt shërbime kontraktuese të tjera, që i bie që Asambleja Komunale dhe roli ynë mbikëqyrës nuk e ka dijeninë se çfarë natyre të shpenzimit do të ndodhë atje. Është shërbime kontraktuese të tjera, unë e kuptoj që është kod ekonomik më i përgjithshëm dhe gjithmonë kur shkojmë përmes procedurave të prokurimit përdoret. Mirëpo, në rastin e buxhetit tonë, unë kam pritur që ke me e arsyetu shumë më mirë. Drejtoria e Infrastrukturës nuk është edhe në këtë vit që s'ka pasur buxhet. Bartja e tyre, mos them me të gjitha, është orientuar direkt në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës. Mirëpo, fatkeqësisht, unë e kam thënë edhe raportet financiare që ju vetë po i sillni në Asamblenë Komunale tregojnë që ju nuk keni mungesë të buxhetit edhe tash kur jemi në tremujorin e tretë. Ju keni thjesht mungesë menaxhimi. Këtë e them me bindje. Sot ishim në homazhe. Me të vërtetë, gjendja e varrezave është gjendje të tmerrshme. Kështu që, thjesht, unë prapë po them: në rregull që ka buxhet, po uroj që ky buxhet të shpenzohet, të mirëmbahet qyteti dhe të mos i kemi këto probleme. Në asnjë fazë të vitit fiskal nuk keni me ankuar për mungesë të buxhetit, përderisa raportet financiare

që ju i sillni në Kuvendin Komunal tregojnë që ju keni edhe suficit sa i përket shpenzimit të gjashtëmujorit të parë. Po kalojmë te subvencionet. Nuk e di nëse me qëllim është ulur subvencionimi. Kryetar, te administrata janë zvogëluar subvencionet, këtu kemi të bëjnë me bursat që shpërndahen në administratën komunale. D.m.th. janë zvogëluar për 50.000 €. Unë e vlerësoj që ju keni me i mbushur këto me bartjen e të hyrave, mirëpo për momentin administratës i janë ulur subvencionet për 50.000 €. Njëjtë, te Integrimet ka ulje për 80.000 €. Kryetar, vlerësoj që jeni ju kompetent, ose drejtori i Drejtorisë së Integrimeve Evropiane, që është i buxhetuar me një subvencion për entitetet publike në vlerë prej 86.321 €. Cili entitet publik është?

Po kalojmë te investimet kapitale. Një pjesë e projekteve kapitale po barten nga ky vit në vitin e ardhshëm fiskal, edhe pse ndryshohet nga ekzekutivi dhe ata që e kanë përpiluar buxhetin. Mirëpo, ne nuk e dimë nëse këtu nuk janë iniciuar apo janë në fazat e prokurimit. Zjarrfikësve u është zvogëluar buxheti për vitin e ardhshëm për 187.000 €, Kulturës për 342.000 €, e prapë arsimi është sakrifikuar me 310.000 € më pak në arsim për vitin 2027. E mos të flasim edhe për shëndetësinë, që është 50.000 €. Kryetar, prapë, Shërbimet Publike kanë përfituar 1.5 milion € më shumë në investime kapitale. Mirëpo, nga këtu nuk po them që Shërbimet Publike dhe Infrastruktura nuk kanë nevojë për rritje, mirëpo jam shumë kureshtare me ditë qysh ka arritur një drejtor i një drejtorie me të bind që vetëm kjo drejtori me pas rritje të buxhetit, qoftë në mallra, qoftë në kapitale. Me të vërtetë duhet të jetë një proporcion sa i përket ndarjes së buxhetit. Në asnjë fazë nuk po them që s'ke nevojë, mirëpo të lumtë qysh ke arritur me e bindur Kryetarin që veç ti ke plan, veç ti ke projekte dhe veç ti ke nevojë për shtim të projekteve. Afër teje është drejtori për Arsim, mirëpo të njëjtit i është zvogëluar buxheti edhe në mallra, edhe në kapitale. Unë uroj që ti me këto ke me mundur me funksionuar, shkollat në këtë rast si kanë me mundur me funksionuar pa 176.000 € në mallra. Te buxheti, ashtu qysh e keni sjellë ju, shënon që teatri i qytetit ka me u ndërtua me 2.000 €. Shënon që ka me u ndërtua muzeu i qytetit me 2.000 € për vitin 2027. Unë e di që ndoshta kanë me u shtua, por për momentin janë këto vlera. Kryetar, gjatë mandatit tonë është blerë një pajisje për pastrimin e liqenit, me të vërtetë ka qenë temë, ka qenë temë nga Vetëvendosja, ndërsa sot shoh që ju e keni planifikuar një pajisje për pastrim të liqenit në vlerë 200.000 €, cila është paramasa, ku ka me u ble, çfarë parallogarie? dhe a jeni ju të sigurt që blerja e pajisjes prej 200.000 € ka me e zgjidhur problemin liqenit njëherë e përgjithmonë? Kryetar, nuk është shpërndarë buxheti sa i përket zotimeve shumëvjeçare. Këto janë tash disa finesa që po dua me t'i thënë në aspektin ndoshta më shumë profesional, me kontribuar. Kur është ndarë qarkorja buxhetore, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe zyrtari kryesor financiar e kanë kuptuar, e kanë marrë qarkoren dhe duhet t'u jepet prioritet zotimeve shumëvjeçare. Unë vlerësoj që nuk janë paraqitur zotimet shumëvjeçare ashtu qysh i keni në sistemin e SMFK-së. Mos t'i përmend projektet, se unë jam e sigurt që edhe ju e keni vetëdijen. Janë mbajtur dëgjimet buxhetore, Kryetar, edhe në Koshtovë, edhe në Kçiq. Kërkesë kanë pasur me vazhduar ndërtimin e rrugëve. Qysh është e mundshme, i shkon njeri në lokalitet, mban dëgjime buxhetore dhe nuk ia vendos asnjë cent në buxhet? As në Koshtovë, as në Kçiq nuk ka asnjë cent investim për vitin 2027.

Ersoka Barani: Isha duke e dëgjuar me shumë vëmendje kolegen time dhe pikërisht shumicën prej atyre vërejtjeve që kolegia i paraqiti i kemi paraqitur ne si opozitë në mandatin e kaluar dhe asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje nga ekzekutivi i kaluar, as nga Kryetari, Kështu që po bashkëndiej me ty e dashur kolege. Unë dua të ngre disa çështje konkrete infrastrukturore, janë kërkesa konkrete që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë dhe cilësinë e jetesës së qytetarëve tanë, që sipas meje duhet të merren parasysh në planifikimin buxhetor. Së pari, kërkoj që rruga "Sali Çeku" të përfshihet në projektet e ndriçimit publik, ka qenë kërkesë për katër vite me radhë gjatë hartimit të buxhetit në mandatin e kaluar dhe asnjëherë nuk është përfshirë, pavarësisht që rruga "Sali Çeku" është rrugë në qendër të qytetit të Mitrovicës, frekuentohet vazhdimisht nga qytetarët dhe është rrugë shumë e banuar. Në të njëjtën kohë, ka prani të qenve endacakë, gjë që e bën shumë më të rëndësishme që prania e ndriçimit publik të jetë më e sigurt gjatë mbrëmjes. Mendoj që duhet të trajtohet si nevojë konkrete e komunitetit dhe të planifikohet në kuadër të investimeve kapitale.

Së dyti, ndalem te rruga "Ukshin Kovaçica". Këtu kemi një problem shumë të madh që kërkon jo vetëm ndërhyrje infrastrukturore, por edhe qasje të mirë menduar për sigurinë e qytetarëve. Kemi problem të madh me trotuarin prej fillimit të rrugës Te Sharragjitë deri te Universiteti dhe deri në fund te Migjeni, ka problem të theksuar të trotuarit. Aty është edhe shkolla "Abdullah Shabani". ku frekuentojnë çdo ditë, , mbi 1.000 nxënës mirëpo ka edhe shumë banorë, aty janë duke u ndërtuar edhe disa banesa kështuqë vështirësia e kalimit të qytetarëve nëpër trotuar është tepër e lartë dhe ngre në pah edhe sigurinë publike. njëkohësisht unë shoh shumë gra me fëmijë që detyrohen të dalin në mes të rrugës për të ecur dhe kjo ua pamundëson edhe shoferëve qarkullimin e lirë me vetura. Kështu që është mirë që të buxhetohet në këtë planifikim. Mos të harrojmë që,

kur investojmë në trotuare janë të sigurta dhe të qasshme, ne ndikojmë drejtpërdrejt edhe në sigurinë dhe lëvizjen e grave, vajzave dhe fëmijëve. Gratë, fëmijët dhe personat e tjerë që lëvizin në këmbë janë përdorues të përditshëm të hapësirave publike dhe duhet të kemi parasysh që të planifikojmë edhe investime kapitale. Investimi në trotuar nuk është vetëm investim që prek vetëm infrastrukturën, por edhe sigurinë, qasjen dhe barazinë në përdorimin e hapësirës publike. Pjesa tjetër, një kërkesë që dua ta paraqes, është asfaltimi i rrugës "Tafil Sadiku" në Zhabar. Mendoj që, në qoftë se ka kontratë aktive, nuk ka shumë hapësirë të madhe aty. Mendoj që ka filluar në mandatin e kaluar, por nuk ka përfunduar, është një pjesë e vogël, ka qenë kërkesë e vazhdueshme e banorëve të asaj zone. Nga informacionet dhe shqetësimet që kam, është një ndër rrugët që ka mbetur pa u shtruar në atë zonë dhe bëhet fjalë për një zonë të frekuentuar. Poashtu, në atë zonë të përfshihet edhe ndriçimi, në qoftë se ekziston rrjeti i ndriçimit.

Gjithashtu kërkesë shumë e rëndësishme mendoj që është rruga "Mbretëresha Teutë", kjo Rrugë është rruga e vetme kryesore e Komunës së Mitrovicës, ku të gjithë ne jemi frekuentues çdo ditë. Janë bërë disa vendkalime për këmbësorë, por gjatë natës nuk janë të dukshme ka ndryshuar edhe vendkalimi, krahasuar me atë se si ka qenë përpara. Kryetar, ajo rrugë është shtruar gjatë mandatit të kaluar dhe unë po i vë në pah punët jo të mira që janë bërë. Çfarë po kërkoj unë te "Mbretëresha Teutë" është vendosja e sinjalizuesve me ndriçim në vendkalimet e këmbësorëve,

Xhyljeta Imeri: I nderuar Kryesues, i nderuar Kryetar Peci, ekzekutiv, kolegë të Asamblesë dhe të gjithë të pranishëm. Ju përgëzoj për përgatitjen e projekt buxhetit për vitin 2027. Dua të ndalem veçanërisht te investimet kapitale, sepse këto investime nuk janë vetëm shifra në tabela buxhetore por prekin drejtpërdrejt interesat dhe nevojat e qytetarëve dhe krijojnë kushte më të mira për fëmijët, familjet dhe komunitetin tonë. Duke filluar nga arsimi, nga Drejtoria e Arsimit kërkoj që në buxhetin e vitit 2027 të planifikohet ndërtimi i një klase aneks në shkollën "Aziz Sylejmani", paralelja e ndarë në Suhodoll. Aktualisht, klasa që përdoret është e improvizuar dhe ka hapësirë vetëm për tri banka, ku mund të vendosen më së shumti gjashtë nxënës. Fatmirësisht, numri i fëmijëve në këtë shkollë është në rritje dhe në shtatorin e vitit të ardhshëm do të përballemi me mungesë të një klase. Prandaj, kërkoj që kjo çështje të planifikohet me kohë dhe të mos presim në momentin kur problemi të bëhet edhe më i madh. Një tjetër kërkesë është hapja e klasës parafillore në shkollën "Aziz Sylejmani". Kjo është e vetmja shkollë në qytet që nuk ka klasë parafillore. Duke pasur parasysh rëndësinë e edukimit në fëmijërinë e hershme dhe duke u thirrur në Ligjin për Fëmijërinë e Hershme, çdo shkollë është e obliguar që të ketë klasë parafillore.

Në faqen 33, tabela numër 4, janë planifikuar mjete për ndërtimin e çerdheve, ku është një investim shumë i mirëseardhur dhe e përgëzoj këtë planifikim. Uroj që këtë herë këto projekte të realizohen dhe ndërtimi të fillojë sa më shpejt, pasi në buxhetin e vitit të kaluar ishin planifikuar mjetet për çerdhe, por ndërtimi nuk u realizua. Gjithashtu, kërkoj që të përshpejtohet sa më shumë funksionalizimi i çerdhes në ish-objektin e DES-it, në mënyrë që ky objekt të vihet në shërbim të fëmijëve dhe prindërve. Në të njëjtën tabelë janë planifikuar mjete për kabinete shkollore, por ato janë paraparë vetëm për shkollat e mesme të larta. Për mua, kjo është e pamjaftueshme. Kërkoj që në këtë kod të përfshihen edhe shkollat fillore, sepse pikërisht aty merret bazamenti i diturisë. Ajo që mësohet dhe praktikohet në mënyrë konkrete në moshë të hershme krijon bazën e dijes për të ardhmen. Po ashtu, më shqetëson fakti që, në kohën e dixhitalizimit, nuk është planifikuar asnjë tabelë digjitale për shkollat. Sipas këtij planifikimi, duket sikur nxënësit duhet të vazhdojnë edhe më tej me shkumës dhe dërrasë të zezë. Kërkoj që tabelat digjitale të planifikohen në këtë buxhet, në mënyrë që shkollat tona të ecin me kohën dhe nxënësit të kenë mundësi të mësojnë në kushte më moderne. Gjithashtu, kërkoj që të ndahen mjete për hapjen e vendeve të punës për psikologë dhe asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta. Prania e këtyre profileve në shkolla nuk është më një nevojë dytësore, por është vërtet urgjente. Tek kodi për ndërrimin e infrastrukturës në oborret shkollore, fillore dhe të mesme, kërkoj që t'i jepet prioritet oborrit të shkollës "Harun Beka" në Gushavc, që për momentin është tërësisht në baltë, fëmijët nuk kanë ku të dalin, as të luajnë, as të zhvillojnë edukatën fizike, por edhe rreshtat ku të hyjnë kanë problem.

Nga Drejtoria e Shëndetësisë kërkoj që në repartin e somatologjisë të krijohet një kënd i veçantë për fëmijët, në mënyrë që ata të kenë një ambient më të ngrohtë dhe më miqësor gjatë trajtimit të tyre.

Sa i përket infrastrukturës rrugore, në faqen 31, në kodin për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit, stacionit të pompimit, furnizimit me material për ujësjellës dhe rehabilitimit të rrjetit të ujësjellësit, kërkoj të përfshihet një ndërhyrje për ndërrimin e gypave të ujësjellësit në Lagjen Muhaxhirët, në Shipol. Banorët e kësaj lagjeje kanë problem të vazhdueshëm me furnizimin me ujë të pijshëm, veçanërisht gjatë sezonit të verës. Bëhet fjalë

për një lagje me banim të dendur dhe furnizimi i rregullt me ujë është një nevojë bazike. Po ashtu, kërkoj që rruga "Ukshin Kovaçica" të rregullohet së bashku me trotuaret. Rregullimi i saj është urgjent, duke marrë parasysh se është një ndër rrugët më të frekuentuara në qytet. E përsëris edhe kërkesën për ndërtimin dhe rregullimin e fillimit të rrugës pas "Fazli Barani", tek ish-Hortikultura. Gjendja aktuale po u shkakton dëme automjeteve dhe po krijon probleme edhe për qytetarët. Gjatë verës pluhuri është i madh, ndërsa gjatë vjeshtës krijohen gropa dhe grumbullohet ujë. Në lagjen Bair, në Rrugën "Fadil Deliqi", kërkoj të bëhet ndriçimi publik, të vazhdohet deri në fund, si dhe të vendosen pengesa për vozitje të shpejtë. Gjithashtu, në lagjen Bair kërkoj që të planifikohet ndërtimi i rrugës "Ajet Bairami", e cila ka nevojë për ndërhyrje. Në rrugën "Hoxhë Hasan Tahsini", e cila lidhet me Zhabarin, kërkoj ndërtimin e trotuarit, sepse mungesa e tij i vë çdo ditë në rrezik këmbësorët dhe banorët nga automjetet. Gjithashtu, e vlerësoj si shumë të qëlluar dhe të nevojshëm planifikimin për blerjen dhe montimin e liftave në banesat kolektive. Megjithatë, mjetet e planifikuara prej 80.000 € mendoj që janë të pamjaftueshme për nevojat që ka qyteti. Prandaj, nëse ka mundësi buxhetore, kërkoj që kjo shumë të rritet së paku në 150.000 €. Në fund, dua të theksoj se këto kërkesa nuk duhet të shihen vetëm si kërkesa për një lagje, për një shkollë apo për një rrugë. Pas secilës prej tyre janë qytetarë që presin kushte më të mira dhe shërbime më të sigurta.

Gjergj Beka: Kam një rekomandim për Drejtorin e Buxhetit dhe Financave nga Komiteti për Komunitete. Tek ne si Komitet ka ardhur një kërkesë nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve, d.m.th janë të planifikuara 15.000 €. Prej këtyre 15.000 €, 10.000 € të barten te kategoria për subvencione. E kam edhe një propozim konkret, pasi e pashë që për vitin e ardhshëm nuk kishte ndonjë projekt për Kçiqin. Bile, është një kërkesë modeste që pjesë e këtij buxheti të jetë shtruarja, d.m.th riasfaltimi i Rrugës së Malit.

Jeton Ujkani: Normal që siç e dimë kërkesat e popullatës janë shumë të mëdha, ndërsa buxheti është i limituar. Unë e kam një propozim për varrezat e Fshatit Vinarc, të cilat janë përfunduar, por nuk ka mundësi të përdoren më ato, fshatarët veç e kanë gjetur lokacionin dhe e kanë dhuruar pronën, propozoj që të bëhet rregullimi i asaj parcele të re për varrezat dhe mjetet të merren, të barten nga kodi: zgjerimi i rrjetit të kanalizimit dhe pusetave, ku është i paraparë të investohet edhe në fshatin Vinarc. Nga ky kod, ku janë 200.000 €, të barten 50.000 € për rregullimin e varrezave të fshatit Vinarc.

Shkëlqim Ibrahimi: Unë, për të mos u përsëritur, po dua të vij deri te një konkluzion realisht, vetëm Drejtorisë së Shërbimeve Publike po i rritet buxheti, ose Drejtorisë së Luleve, siç po e njeh populli. E tha edhe Kryetari përqindjen ndoshta Drejtorisë së Bujqësisë, Drejtorisë së Arsimit i bie që i është zvogëluar buxheti për 19%. Në vitin 2026, për investimet kapitale në arsim kanë qenë të planifikuara 1.230.000 €, ndërsa në vitin 2027 janë 993.000 €. Pajtohesh, Kryetar, te investimet kapitale në arsim është zvogëluar buxheti për 19%? Keni potencuar që top prioritete janë arsimi, shëndetësia dhe infrastruktura si investime kapitale. E njëjta ka ndodhur me të njëjtin trend edhe në shëndetësi. Prej 665.000 € investime kapitale në shëndetësi në vitin 2026, në vitin 2027 janë 410.000 €, që i bie 38% zvogëlim i investimeve kapitale. I njëjti trend është ndjekur edhe te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sportit me 37%. Veç po dua të bëj një krahasim, për investime kapitale në shëndetësi janë paraparë për këtë vit 410.000 €. Për këto po pajtohemi, duke u bazuar në buxhet, ndërsa vetëm për rrugën "Cenë Stantërgu" janë paraparë 770.000 €, a po donë me vazhdua trendin e njëjtë? D.m.th. është një buxhet i stërmadhuar për një rrugë të caktuar, ndërsa investimet kapitale janë 410.000 € për shëndetësi. Është edhe një kërkesë publike që ia kam bërë drejtorit të Shërbimeve Publike, është çështja e përroit në Fshatin Shupkovc, që ka filluar të mbulohet te pjesa e xhamisë dhe duhet të përfundohet komplet, edhe të rregullohet nënkalimi. Veç po dëshiroj me ju tregu diçka, se s'e kam përmendur kurrë, kur e keni bërë largimin e reklamave ilegale, që ju kemi përkrah të gjithëve në atë proces, reklama që ka treguar adresën për te restoranti në Zaskllë e keni hedhur në nënkalim, kur të doni, mundeni me shku me pa dhe sot është ajo aty. Kisha pasur qejf me e trajtu me seriozitet, se aty kanë mbetur njerëz pa vetëdije që janë shkelur për shkak të mungesës së nënkalimit dhe mungesës së investimeve. E ke edhe drejtorin e Pronës tash, që është prej atij lokacioni dhe e din saktë. Është i njoftuar që sot nxënësit, prej klasës së parë deri në të nëntën, detyrohen me shku afër magjistrales, sepse nënkalimin nuk e kanë të pastër dhe nuk kanë rrugë tjetër, përveç një pjese që është bërë në kohën tonë atje. Kështu që të kisha lutur, merre parasysh këtë pjesë dhe mundohu me e rregullua sa më shpejt, sa s'ka ndodhur ndonjë fatkeqësi e madhe.

Çështja tjetër, Kryetar, diskutimet publike, dëgjimet buxhetore, a i keni marrë parasysh kur i keni futur në buxhet? Veç po ju tregoj me një statistikë. Prej 193 kërkesave, vetëm 17 kërkesa janë të evidentuara në regjistër, që i bie 0.09% në total. Na e kemi sjellë një raport të dëgjimeve buxhetore pa kurrfarë konkluzionesh,

d.m.th në Udhëzimin ku duhet të konstatohet statusi i kërkesës, e keni lënë bosh. Mundeni me marrë me e kqyr, me e shkarkuar. Po e shoh që s'ka as interes me u dëgjuar një rast ku janë shkelur fëmijë.

Jam ndalur edhe për tre çështje të tjera, Instituti GAP t'i ka listuar disa premtime, 70 e diçka premtime, sipas Institutit GAP, Kryetar, e ke rregullimin e kanalizimit në Kçiq, mungon në buxhet, e ke të listuar te premtimet në Institutin GAP. Ndërtimi i udhëkryqeve që e bëjnë qarkullimin më të sigurt, duke filluar nga Ilirida, Zhabari, Ura e Gjakut, Parku Solana dhe rrethrrotullimi te shkolla e Zhabarit – mungojnë në buxhet. Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit, edhe pse kjo s'është kompetencë e komunës unë nuk e di pse e keni pranuar si premtim. Këto, infrastrukturë me qasje të plotë për personat me nevoja të veçanta, rrugë, trotuare, ndërtesa publike, përveç liftit që u bë dhe që ka qenë projekt i iniciuar prej mandatit të kaluar, që është mirë që u bë. Gjelbërimi i qytetit me fasada të gjelbra, si në bibliotekën "Latif Berisha" dhe ndërtesa të tjera publike, nuk e ke. Krijimi i mini-pyjeve në çdo qendër arsimore, duke e kthyer gjelbërimin në pjesë të edukimit, nuk e ke. Te shëndetësia, reformimi i shërbimit të urgjencës, duke futur kartelën shëndetësore digjitale për çdo pacient, nuk e ke askund. Ndërtimi i një poliklinike stomatologjike publike, nuk e ke. Te kultura, ndërtimi i një qendre kulturore multifunksionale me ekspozita, kinema dhe amfiteatër veror, ndërtimi i një galerie të arteve dhe krijimi i muzeut alternativ, nuk i ke.

Liridona Muharremi: Faleminderit, Kryesues. I nderuar Kryetar, nënkryetar, ekzekutiv, kolegë asamblistë, media dhe të gjithë të pranishëm. Po dua të ndalem shkurt te disa pika të këtij draft buxheti, sepse besoj që disa shifra kërkojnë edhe përgjigje konkrete. Po filloj me Drejtorinë e Administratës. E kemi një projekt të njëjtë prej legjislaturës së kaluar, por tani i ka 100,000 € më pak, po dua të di se çfarë ka ndryshuar në këtë projekt dhe të specifikohet se çfarë do të bëhet ndryshe. Sa i përket Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, e kemi një projekt me titullin "Rregullimi i objektit të garazheve të zjarrfikësve", i cili nuk është realizuar, por po vazhdon të buxhetohet. Pse nuk është realizuar, ku ka ngecur dhe kur pritet të përfundojë? Tek Shëndetësia e kemi vetëm një projekt të paqartë: "Rregullimi i objekteve të QMF-ve dhe AMF-ve", që ka një buxhet prej 50,000 €. Cilat objekte do të rregullohen dhe pse nuk është specifikuar qartë? Ndërkohë, buxheti i Shëndetësisë po ulet nga 165,000 €. Me 21 objekte shëndetësore, si ka mundësi të funksionojë me këtë buxhet? Tek Arsimi ka ulje prej 146,870 €. Si do të mundet kjo drejtori t'ia dalë me të gjitha shkollat që i ka qyteti, me këtë buxhet? Po dua të jem e qartë se nuk jam vetëm për të kritikuar, por dua të propozoj dhe të kontribuoj, në mënyrë që ky buxhet të jetë më konkret.

Përveç pyetjeve që i ngrita, dua të paraqes edhe disa propozime konkrete. Propozimi im i parë është sa i përket Lagjes Zhabar. Drejtor, besoj e dini se është një pjesë e trotuarit të rrugës kryesore, rruga "Ulqini", e cila është e pashtruar dhe banorët zakonisht kanë pasur ankesa se nuk mund të qarkullojnë lirshëm. Propozimi tjetër, sa i përket Lagjes Zhabar, është asfaltimi i rrugës së Jaz-it, si dhe ndriçimi publik në disa rrugë të Lagjes, ku mungon ndriçimi. Propozoj që në buxhet të parashihet edhe asfaltimi i rrugës "Ajet Bairami" në lagjen Bair. Propozimi i tretë është për fshatin Dedi, propozoj që të përfshihet në buxhet rregullimi dhe asfaltimi i rrugës që përfshin pjesën nga hyrja e Fshatit deri në Fshat, me gjatësi afërsisht 800 metra. Propozimi i katërt është që të bëhet rregullimi dhe asfaltimi i rrugës që çon tek vëllezërit e dëshmorit të parë të Brigadës 141 "Mehë Uka" të Zonës Operative të Shalës, Avni Shabani. Rruga "Faruk Spahija", Frashër i Vogël, ka gjatësi prej 400 metrash. Mendoj që këto projekte duhet të trajtohen me prioritet, në mënyrë që të jenë pjesë e përgjegjësisë që kemi ndaj qytetarëve.

Artan Berisha: I nderuari Kryesues, Kryetar, nënkryetar, ekzekutiv. Drejtor Naser, ke shkuar në Kçiq në shtatë lagjet dhe ke monitoruar gjendjen për punën e kanalizimit. E din për cilën pjesë e kam fjalën, te Shoshollët, edhe komplet lagjet. Po më intereson, pse nuk është futur në buxhet kur përafërsisht numri i banorëve është diku rreth 600. Me të vërtetë janë banorët kcq dhe ajo pjesë ka nevojë të futet në buxhet dhe të trajtohet. Po besoj që reflektoni edhe ju edhe Kryetari, dhe e futni në buxhet. Sa i përket rrugës "Ylfete Humolli" në Bair, pse është hequr rruga "Ylfete Humolli" në Bair për asfaltim? A ka mundësi të na tregoni kur dihet që është në qendër dhe problemi është që ajo rrugë, edhe për një javë, dy javë, ose tani kur të fillojë dimri, nuk ke mundësi të kalosh me makina në atë rrugë. Në atë rrugë jetoj unë vetë.

Nazmije Sejdiu: I nderuar Kryetar, nënkryetar, ekzekutiv, të dashur qytetarë. Në planifikimin e investimeve kapitale për vitin 2027–2029 janë përfshirë investime për më shumë fshatra të Komunës së Mitrovicës. Mirëpo, për fshatin Lushtë nuk parashihet as ndriçimi i fshatit, as zgjerimi i rrjetit të kanalizimit, as asfaltimi i rrugëve, as trotuaret. Fshati Lushtë nuk kërkon privilegj, por kërkon trajtim të barabartë me

investime konkrete, njësoj si çdo fshat tjetër i Komunës së Mitrovicës. Dhe për këtë arsye, po propozoj që fshati Lushtë të përfshihet në buxhet.

Egzon Sadiku: Faleminderit, Kryesues. Kryetar, edhe njëherë po e përmendi Institutin GAP, te premtimet që i ke dhënë në fushën e arsimit, aty përmendet premtimi i një çerdheje në Zhabar, kurse këtu, në draft buxhet, nuk e pashë kërkund që është propozuar si projekt. Propozoj që të futet në buxhet.

Lavdim Zeneli: I nderuar Kryetar, Nënkryetar, të nderuar drejtorë, kolegë të asamblesë dhe ju, qytetarë të Mitrovicës. Sot, në kuadër të diskutimeve për buxhetin e Komunës së Mitrovicës për vitin 2027, dua t'i paraqes disa kërkesa konkrete që burojnë nga nevojat dhe shqetësimet e qytetarëve. Prandaj, kërkesat që i paraqes, me qëllim që të shqyrtohen dhe, aty ku është e nevojshme, të përfshihen në planifikimin dhe buxhetin komunal për vitin 2027. Një nga kërkesat kryesore që ngre është lumi Lushta. Sipas gjendjes në terren, rrethojat përgjatë lumit Lushta janë të dëmtuara, në disa pjesë kërkojnë edhe intervenim, poashtu, pas situatës me vërshime, është e nevojshme që të vlerësohet gjendja e përgjithshme e këtij segmenti dhe të ndërmerren masat e nevojshme, kjo çështje nuk duhet të trajtohet vetëm nga aspekti estetik, por edhe nga aspekti i sigurisë së qytetarëve. Një tjetër kërkesë është ndërhyrja në fushën sportive të shkollës "Ismail Qemali", këto hapësira përdoren nga nxënësit dhe të rinjtë dhe kanë nevojë për rehabilitim dhe përmirësim të kushteve. Kërkoj që të shqyrtohet përfshirja e tyre në planifikimin e vitit 2027 për këto ndërhyrje: rregullimi dhe rehabilitimi i fushave sportive, vendosja e portave të reja, përmirësimi i rrethojave, ndërmarrja e masave të nevojshme të sigurisë, po ashtu vendosja e shenjave të nevojshme sinjalizuese, si dhe ndriçimi i hapësirave sportive aty ku vlerësohet i nevojshëm. Një çështje tjetër që kërkon vëmendje është ndriçimi në hapësirën te Spitali i Bairit. Kërkoj që kjo hapësirë të kontrollohet nga shërbimet përkatëse dhe të ndërmerren masat e nevojshme për funksionalizimin dhe përmirësimin e ndriçimit. Një kërkesë tjetër është ndërhyrja në rrugën "Nexhip Dragaj", veçanërisht në pjesën te Hendikos-i, kërkoj që të bëhet vendosja ose funksionalizimi i ndriçimit publik, kontrollimin e gjendjes së trotuareve dhe hapësirave publike, përmirësimi i infrastrukturës përreth objektit, si dhe ndërmarrja e masave që mundësojnë qasje më të përshtatshme për personat me nevoja të veçanta. Një tjetër kërkesë është rruga "Mehmet Akif Ersoy". Siç dihet edhe nga gjendja në terren, rruga është e shtruar me kubëza, ndërsa në pjesë të saj vërehen dëmtime dhe çrregullime të sipërfaqes, poashtu, vërehen ndërhyrje edhe rreth pusetave të kanalizimit. Kërkoj që të bëhet një vlerësim teknik i plotë dhe të shqyrtohet mundësia që në buxhetin e vitit 2027 të përfshihet rehabilitimi dhe rregullimi i rrugës "Mehmet Akif Ersoy", rregullimi i pjesëve të dëmtuara të kubëzave, kontrollimi i gjendjes së rrjetit të kanalizimit, si dhe rregullimi ose zëvendësimi i kapakëve të dëmtuar të pusetave. Është e rëndësishme që rruga të mos rregullohet vetëm në sipërfaqe, nëse paraprakisht ekzistojnë probleme të infrastrukturës nëntokësore. Një kërkesë tjetër që dua ta adresoj për buxhetin komunal të vitit 2027 është asfaltimi i rrugicave në fshatin Selac, si dhe realizimi i lidhjes së kanalizimit për banorët e kësaj zone. Kjo kërkesë vjen si rezultat i nevojave të drejtpërdrejta të banorëve, pasi gjendja aktuale e rrugicave paraqet vështirësi të mëdha në qarkullim, veçanërisht gjatë sezonit të dimrit, ku për shkak të reshjeve dhe kushteve atmosferike ato bëhen të pakalueshme. Prandaj, kërkoj që në kuadër të planifikimit për vitin 2027 të parashihet një buxhet për rregullimin e rrugicave të fshatit Selac, si dhe për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit, me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës së banorëve, qarkullimit dhe infrastrukturës bazë të këtij fshati.

Armend Begu: I nderuari Kryetar, i nderuari kryesues, të nderuar drejtorë, kolegë. Sot, në këtë seancë, e kemi si pikë të rendit të ditës pikën më të rëndësishme të vitit në vijim: miratimin e projekt buxhetit të Komunës së Mitrovicës së Jugut. Pres që pikat e përfshira në buxhetin e vitit 2027, si dhe kërkesat për projekte që mendoj se duhet të futen në këtë buxhet të realizohen dhe të implementohen. Me hartimin e këtij projekt buxheti ka shumë projekte infrastrukturore, si rrugë, kanalizime, ndriçim, trotuare, objekte shkollore dhe fusha sportive, që janë në plan të realizohen. Në këtë projekt buxhet janë të përfshira edhe disa kërkesa të mia që i kam adresuar ndër vite në këtë Kuvend, kur në ekzekutiv ishte Partia Demokratike e Kosovës. Mirëpo, asnjëherë nuk janë realizuar, vetëm se na thoshte Kryetari: "Bëhet mirë, bëhet mirë." Në këtë projekt-buxhet, për rrugët e fshatit Vllahi, të cilat i kam adresuar shumë e shumë herë, janë të destinuara dhe planifikuara 200,000 € për vitin 2027, si dhe disa shuma të tjera për vitet në vijim. Tash, dy rrugët që pritet të rregullohen dhe pres të rregullohen, janë të asfaltuara, është rruga "Murat Hasani", në drejtim të lagjes Hasani. Është edhe rruga "Mon Moni", e cila përfshinë tri lagje dhe gjatësia e saj nuk kalon mbi 300 metra. Është rruga "Mon Uka" që ashtu i lidhë tri lagje tjera, është rruga "Sadri Hajzeri", që lidh një lagje. Të gjitha këto janë me distancë të shkurtër, nuk janë të gjata. Ndërsa rruga "Ahmet Kurti", që i lidh tri lagje të tjera të fshatit Vllahi, është në kryerje sipër dhe shpresoj që sivjet duhet të përfundojë.

Kryesuesi: Shkojmë për një pauzë 15 minutëshe pastaj vazhdojmë me diskutimin për këtë pikë.

Armend Begu: Po vazhdoj aty ku mbeta. Pos këtyre projekteve dhe rrugëve të fshatit Vllahi, që i kam adresuar ndër vite, unë kam adresuar edhe projekte të tjera, siç janë rruga e fshatit Dedi, rrugët në fshatrat Maxherë, Melenicë dhe Zijaq, të cilat nuk janë trajtuar asnjëherë më herët dhe për të cilat janë ndarë mjete, si për rrugët, ashtu edhe për projektet. Mirëpo, kur ka filluar viti, ato nuk janë realizuar. Janë edhe disa projekte të tjera që nuk janë përfshirë, si ujësjellësi për fshatrat Vlahi, Melenicë, Zijaqë dhe Maxherë. Mirëpo, kam informatën që është në proces e sipër, në fazat fillestare të projektimit. Kalojmë edhe te disa rrugë brenda qytetit, të cilat kanë nevojë për trajtim. Edhe pse ne jemi të vetëdijshëm se nuk mund t'i kemi të gjitha prioritare, pasi prioritetet caktohen. Për shembull, është rruga "Konstantin Kristoforidhi", e cila është shumë e shkurtër, por kurrë, asnjëherë, nuk është trajtuar gjatë të kaluarës. Është e kyçur në rrugën "Mbretëresha Teutë". Është edhe rruga "Xhafer Bistrica", te varrezat serbe, në Lagjen Kolonia, e cila ka nevojë të trajtohet. Aty janë disa familje të dëshmorëve dhe të gjithë i takojnë kategorive të dala nga lufta. Janë edhe disa rrugë të paemërtuara në lagje të ndryshme të qytetit, të cilat kanë nevojë të trajtohen me kubëzim apo asfalt. Këto na mbetet që në të ardhmen t'i adresojmë dhe t'i ndihmojmë ekzekutivit në identifikimin e tyre. Mandej, është edhe shtegu i ecjes, i cili është përfunduar në drejtim të Tri Shkronjave dhe që ka nevojë për restaurim dhe ndriçim, për shkak se ka pësuar dëmtime të theksuara nga keqbërës të pandërgjegjshëm. Në kohën në vijim do të kërkojmë edhe shumë projekte të tjera të rëndësishme për qytetarët, që të jenë prioritare. Mirëpo, siç thashë, është e kuptueshme se të gjitha nuk mund të realizohen përnjëherë. E falënderoj ekzekutivin për këtë projekt, sado që ndoshta ka mangësi, por është projekti i parë.

Sazan Ramaxhiku: I nderuar Kryetar, Nënkryetar, i nderuar ekzekutiv, kolegë asamblistë, media të nderuara dhe ju, banorë të pranishëm. Unë do ta votoj buxhetin, por krahas votës kemi edhe një obligim moral. Drejtoria e Mirëqenies Sociale gjatë këtij mandati ka qenë aktive dhe është përpjekur t'i prekë sa më shumë kategoritë e qytetarëve në nevojë. Prandaj, kërkoj që në kuadër të të hyrave vetanake të komunës, në bazë të mundësive, të futet në prioritete që të planifikojmë më shumë buxhet për subvencionet e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale. Këtu nuk po flasim thjesht për një zë buxhetor, por po flasim për fëmijët me aftësi të kufizuara, për fëmijët autikë, fëmijët me sindromën Doun, fëmijët e shurdhër, fëmijët e verbër dhe familjet e tyre, të cilat çdo ditë përballen me sfida të mëdha. Prandaj, prioritetet tona duhet të vendosen duke dëgjuar kërkesat, nevojat dhe ndjeshmërinë e prindërve dhe familjeve të këtyre kategorive. Ky nuk është vetëm obligim institucional, por është obligim njerëzor dhe moral. Nëse e kemi mundësinë nga të hyrat vetanake, duhet t'i orientojmë ato aty ku nevoja është më e madhe dhe ku mbështetja e komunës e bën ndryshimin më të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Prandaj, edhe njëherë po e theksoj: do ta votoj buxhetin, por kërkesa ime është e qartë – më shumë mbështetje financiare për mirëqenien sociale dhe veçanërisht për fëmijët dhe familjet me nevoja të veçanta.

Bajram Istrefi Faleminderit, kryesues, Kryetar, Nënkryetar, ekzekutiv, kolegë asambleistë dhe ju, media. Unë kam kërkesë që të përfshihet në këtë buxhet për vitin 2027 trotuari i rrugës "Sami Gashi". Në atë rrugë çdo ditë lëvizin rreth 640 nxënës. Si dhe kam kërkesë për një pllakë përkujtimore për Bislim Bajgorën, Ukshin Kovaçicën, Ahmet Selacin, Sherif Tërstenën e të tjerë. Po ashtu, kam kërkesë për restaurimin e varrit të heroit "Mehë Uka".

Kushtrim Zeneli: Drejtor, e keni paraparë zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik në Shalë të Bajgorës, Broboniq, Zhabar, Koshtovë, Iliridë e të tjera. Sa është mundësia që rrjeti i kanalizimit për këtë vit, ose të parashihet për vitin 2028, të shtrihet edhe në fshatra të tjera, në Shalës së Bajgorës, në Rashan, Tërrstenë, Mazhiq, Melenicë dhe Vllahi? Po ashtu, edhe tek ujësjellësi dhe kanalizimi, e keni paraparë ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit edhe stacionit të pompimit. A mundeni vetëm të na tregoni qartë se për cilat projekte bëhet fjalë dhe cilat fshatra do të preken nga ky projekt, edhe cila do të jetë strategjia dhe synimi për të nxjerrë investime edhe nga niveli qendror?

Kryetari Faton Peci: Faleminderit, Kryesues. Ju kam dëgjuar me vëmendje. Mirë keni qenë, pa përjashtim. Krejt çka keni thënë si nevoja janë të vërteta, pritshmërit i kam pasur edhe më të mëdha për juve. Kam menduar që keni për të përmendur hala edhe më shumë nevojat e qytetarëve sesa që i keni përmendur deri në këtë fazë. Edhe ashtu, qysh po e shoh, që edhe ju keni pasur pritshmëri për mua, se po doni që për herë të parë po hartoj buxhet, t'i realizoj dhe t'i përmbush për katër vite këtë premtim që e kemi dhënë. Kështu që, kjo është një sinjal shumë pozitiv që edhe ju keni pritshmëri prej të parit të komunës. E dyta, e pashë njëfarë tendence këtu, disi duke thënë: "Kjo drejtori, ajo drejtori, i ka dhënë buxhet këtij, i ka dhënë atij." Ekzekutivi i komunës është një trup. Përgjegjësinë primare, kryesore, e ka një individ, ai që e keni përballë dhe që po ju flet. Kështu që, unë nuk e shoh kështu. Do të thotë, ideja "kjo drejtori, ky drejtor, ai drejtor", ne duhet të frymojmë si një trup

i vetëm ekzekutiv, edhe të ndihmojmë njëri-tjetrin për atë sa dimë dhe mundemi. E prioritetet i caktoj unë. Po ju them të drejtën, po i dëgjoj të gjithë, edhe drejtorët, krejt preokupimet, edhe kush flet me gjuhën e argumentit e ka përkrahjen time. Tash, disi tendenca është me ju thënë këtyre drejtorëve: "Ju jeni të diskriminuar, veç Naseri është në pozitë më të mirë", me sa mundem, mes të tjerash. Tash, faktet janë kokëforta. Numrat flasin dhe janë gjurmë. E tash krejt varet se kush çka prezanton. Thashë, ju prezantoni diçka që duhet mirë me u bërë dhe mirë me u rregulluar. Po të filloja me i përmendur të gjitha çka duhet të përmenden, jo vetëm në Mitrovicë, por në krejt Kosovën, do ta bëja xhenet. Por ja që mes nevojës dhe mundësive ekziston një diskrepancë e madhe. Tash thatë që në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës është rritur buxheti. Unë vetëm po ju tregoj, për ata që nuk e dinë, cila ka qenë gjendja në drejtori këtë vit, ku ne kemi ardhur me një buxhet të aprovuar paraprakisht. Do të thotë, nga kontratat e gjetura pa planifikim buxhetor, dhe mënyra më e mirë për ta bërë planifikimin e buxhetit dhe realizimin e tij është ajo shprehja popullore: "Shtriji këmbët sa e ke jorganin." Tash, prapë më duhet t'ju tregoj që e keni shtrirë kuptimin e kësaj shprehjeje shumë përtej mundësive që keni pasur si mbulesë financiare dhe buxhetore. Kontratat pa mbulesë financiare, të cilat kanë qenë obligime për Ekzekutivin e Komunës së Mitrovicës, përkatësisht nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës, a e dini sa është për vitin 2026? Nëse nuk e dini, po ju tregoj. Jo domosdoshmërisht duhet ta dini, 2.260.000 € na është dashur t'i kemi në buxhetin e komunës për këtë vit, për t'i mbuluar kontratat kornizë. 2.260.000 € obligime, ndërsa buxhet na keni lënë 790.000 €, kontratat e kontraktuara me kontrata kornizë janë në vlerën 2.260.000 €. Do të thotë, gati 1.5 milion € na keni lënë obligime dhe po vini e po thoni: "Si e keni rritur buxhetin?" Po, na duhet me e rritur buxhetin, sepse ne nuk e rrisim buxhetin vetëm në këtë kategori. Përndryshe, neve ka me na sakatu përmbaruesi. Vetëm për këtë vit, do të thotë vetëm për vitin 2026, nga kontratat e realizuara ndër vite, por që kanë pasur intervalin kohor të implementimit gjatë vitit 2026, kemi obligime prej 2.260.000 €, ndërsa buxhet na keni lënë 790.000 €. Afër, mbi 1.4 milion €, ne jemi në minus, në deficit, dhe na duhet që, aty ku është gjendja më e keqe, të tentojmë ta sanojmë gjendjen, në mënyrë që të mund ta kthejmë për së mbari aspektin e planifikimit buxhetor. Tani po thoni: "Jo, qentë endacakë..." Dallimi është si dita me natën prej kur kemi ardhur dhe siç ka qenë para tre-katër muajsh. Tash veç ai që nuk do të shohë mund të thotë që nuk ka ndryshuar gjendja. Besoj që dilni nga ura dhe shihni se çka komuna. Nejse, tash këto kategori dhe këto shpenzime, edhe këto kontrata kornizë, do të thotë: mirëmbajtja e rrugëve, sipërfaqeve, gjelbërimi, mirëmbajtja verore e rrugëve në qytet, larja dhe fshirja e rrugëve, subvencionimi i UNITET-it, për shkak se dihet cila është gjendja e kësaj ndërmarrjeje që ne i themi rajonale. Po s'është rajonale, është veç komunale. Po, me letra kurrë s'u kanë rajonale. Më vonë, një ditë, keni me pas ndonjë mundësi me diskutuar dhe me i pasqyruar krejt skandalet që janë aty. Mandej është mirëmbajtja e ndriçimit publik, që me të drejtë shumica e asamblistëve e ngritin si temë dhe si shqetësim. Mandej është riparimi i rrugëve, rrugicave, shesheve, platove, sinjalizimi i rrugëve, mirëmbajtja e semaforëve dhe mirëmbajtja e varrezave. Krejt këto janë shpenzime që ju i keni lënë 2.2 milionë €, ndërsa ne i keni lënë veç 790.000 € buxhet. Kështu që, sa i përket asaj pse ka rritje më të madhe në këtë drejtori, arsyeja është e thjeshtë: ne duam të ofrojmë shërbim, ne duam të kemi ndriçim, ne duam pastërti dhe duhet edhe t'i mbulojmë borxhet. Çdo qeverisje, kur përfundon, ka me i lënë disa obligime financiare. Edhe unë, një ditë, kur s'kam me qenë Kryetar i komunës, kam me lënë , por megjithatë është shumë e rëndësishme të mund ta bëjmë njëfarë balance dhe një menaxhim të mirë financiar. Kështu që, ju keni lënë 2.2 milionë € obligime, ndërsa ne i kemi lënë 700.000 € buxhet. Tash, për të mundur t'ju treguar, për shembull, se sa e keni vështirësuar çështjen e investimeve kapitale në arsim, gati jeni duke më futur në gjynah. Po, vetëm po ju tregoj: nëse vitin paraprak kanë qenë 1.2 milionë € investime kapitale në arsim, këtu, në këtë buxhet, nuk e keni paraparë. Por e kam të nënshkruar me ministrin e Arsimit, Hajullah Çeku, që 5.000.000 € investime kapitale shtesë fillojnë vitin e ardhshëm, përveç këtij buxheti. Kështu që nuk flitet për 100.000 apo 200.000 € minus. Jo more, për arsimin i kemi 5.000.000 € shtesë. Gjimnazin kemi me e ndërtuar si një prej Gjimnazeve më moderne që ekzistojnë në Kosovë. Kështu që edhe shkolla e muzikës, edhe çerdhet, jemi në negociata. Do të jemi në negociata edhe me Ministrinë e Arsimit për të gjitha shkollat që i përmendën disa prej asamblistëve për renovim, fushat sportive dhe të gjitha këto tema të tjera. Diskutuam për gjendjen në shëndetësi edhe për investimet kapitale. Mirë është me pasur investime kapitale. Të dakorduar e kemi me ministrin e Arsimit, me kryeministrin, çështjen e spitalit rajonal. Kështu që nuk bie investimi në shëndetësi. Më shumë se 5 milionëshi në arsim, ne kemi me ndërtuar Spitalin Rajonal. Po supozoj që, kurdo që të përfundojë, ka me qenë përsëri në gjendjen më të mirë, për shkak se përfundon me pajisjet më të reja dhe me teknologjinë më moderne. Kështu që nuk jeni duke diskutuar këtu për rënien e investimeve, për shkak se unë e kam buxhetin komunal, por njëkohësisht i di edhe negociatat dhe komunikimet që kam me Qeverinë Qendrore, prej kryeministrit Albin Kurti e tutje. Temë tjetër që është e rëndësishme të potencohet këtu është

pajisja te liqeni akumulues. Shumë mirë që e ngrite si temë dhe the që ka qenë objekt i diskutimit. Po është objekt i diskutimit dhe, për faqe të zezë, ka qenë ajo pajisje. Thonë: gjysmë dite punon, tri ditë prishet, për shkak se është blerë e vjetër, për shkak se është jashtë standardeve dhe për shkak se ka njëfarë misioni minimalist. Kështu që gjendja te liqeni akumulues nuk ka qenë e mirë këtë vit dhe ne synojmë që ta ndryshojmë pozitivisht në vitin e ardhshëm. Ka pasur ekspertë që kanë ardhur dhe na kanë prezantuar pajisje më moderne, të cilat e adresojnë çështjen e algave. Jemi në komunikim edhe me universitete të ndryshme dhe me ekspertë ndërkombëtarë se si ta trajtojmë çështjen e algave. Por, njëkohësisht, e kemi edhe zotimin e Qeverisë që vitin e ardhshëm të kemi 1 milion € shtesë, prej të cilave 200.000 € për pajisje për trajtimin e liqenit akumulues. Gjithashtu, kam me pas kontratë të re për mirëmbajtjen e hapësirës dhe hapësirave të gjelbra, por njëkohësisht edhe për mirëmbajtje, pastërti dhe çështje të tjera. Nuk duhet me harruar një fakt: ta zëmë, mjetet e lira financiare për investime kapitale, a e dini sa i kemi pasur edhe pse buxheti është i ri, prej 8.3 milionë €ve, sa ka Komuna e Mitrovicës buxhet për investime kapitale, ne mjete të lira i kemi 1.596.979 €. Do të thotë, prej 8.3 milionë €ve, ne mjete të lira i kemi vetëm rreth 1.5 milion €. S'kemi më shumë. Krejt angazhimin dhe përkushtimin e kemi me partneritet dhe me bashkëpunim me ministritë e linjës. Po kemi edhe buxhetin që e përmendi njëri prej asambleistëve, të cilin e kemi filluar me 2.000 €. Krejt e dimë që nuk kryhet me 2.000 €, por duam me e hapur kodin buxhetor, duam me e bërë projektin ideor dhe projektin detal dhe ta sigurojmë përkrahjen financiare prej Ministrisë së Kulturës, sikurse kemi siguruar përkrahje për muzeun. Synojmë që ta realizojmë atë për vitin 2028 për teatrin dhe për shumë institucione të tjera. Kështu që hapja e kodeve dhe vlerat e vogla buxhetore bëhen për t'u hapur si kod, për ta pasur vijimësinë dhe për të filluar përgatitjet për projektin ideor dhe projektin detal, për të vazhduar më pas me një intensitet më të madh kur t'i vijë intervali kohor dhe çështja e planifikimit. Kur u diskutua për disa lokalitete, ndër të tjera, unë po e shoh që këtu ka një lëshim teknik te kodi 53028, kur flasim për kanalizimet. Orientimi im është që kanalizimi i parë që trajtohet në këtë projekt është çështja e fshatit Kçiq. Ka qenë zotim publik dhe Kçiqi trajtohet në radhë të parë në këtë projekt, për shkak se gjendja është jo e mirë. Edhe tjetra, jo vetëm Kçiqi, por të gjitha lokalitetet e tjera, duke përfshirë edhe Koshtovën dhe lokalitetet e tjera, janë në mesin e prioriteteve që synojmë që ta shumëfishojmë përkrahjen financiare me përkrahjen e Qeverisë dhe eventualisht edhe të donatorëve, është pikërisht për shkak se, sinqerisht, jam në siklet që, pas 27 vitesh liri, ende nuk e kemi arritur ta mbyllim ciklin e ujërave nëntokësore, kanalizimin e ujërave të zeza dhe çështjet e tjera, sepse ajo është parakusht për zhvillim. Tema të tjera, për shembull, u diskutua çështja e ujit. Ne kemi një marrëveshje, është zotimi im, që thjesht t'i adresojmë dhe ta plotësojmë ciklin e furnizimit me ujë, posaçërisht në fshatrat e zonës së Shalës së Bajgorës. Një memorandum e kemi për momentin me Ministrinë e Ekonomisë, ku procedurat janë në proces të konkurrimit, ose të shpalljes publike. Por, njëkohësisht, kemi edhe donatorë të tjerë që kanë shprehur gatishmërinë në fazën e dytë, pasi faza e parë e përfshin Vllahinë, Melenicën, Maxherën, Dedinë dhe Zjaqen. Ndërsa faza tjetër ka me përfshi Barën, Mazhiqin, Rashanin, Tërstenën dhe Vidishiqin. Po flasim për një interval kohor prej një deri në një vit e gjysmë, besoj që plotësohet ky cikël me fondet e komunës, me fondet e Qeverisë dhe me donatorët që i kemi negociuar dhe i kemi siguruar. Tash ka pasur edhe diskutime të tjera, Armendi na i ka përmendur disa rrugë që tash janë të kontraktuara, posaçërisht lagjet që i ke përmendur, Vllahinë e të gjitha ato fshatra, tashmë kanë marrë rrugë. Tash është ngritur edhe çështja e vizionit dhe misionit të drejtorive në fillim. Vizioni dhe misioni është, ofrimi i shërbimeve, qeverisja afër qytetarëve. Do të thotë, pak a shumë, rritja e cilësisë në arsim, shërbime shëndetësore, infrastrukturë moderne. E keni ngritur çështjen e stafit në arsim. Ne i kemi, do të thotë, 89 pozita tashmë të buxhetuara, e aty mandej do të kemi një përfshirje ose shpërndarje aty ku është nevoja më e madhe. Aty përfshihet edhe çerdhja te DES-i, që është e paraparë me buxhet, rekrutimi i stafit për çështjet e tjera. E rëndësishme është që planifikimi, ose raporti i gjashtëmujorit të parë, flet për një trend pozitiv edhe të rritjes së inkasimit të të hyrave. Ne planifikojmë që vitin e ardhshëm, si rezultat edhe i disa ndryshimeve në Rregullore, në mënyrë të ndjeshme ta rrisim inkasimin e të hyrave. Për këtë arsye, njëkohësisht edhe me pjesën e dhënies në shfrytëzim të pronave të reja që planifikojmë t'i japim, ato kanë me pasur njëfarë efekti shumëfishues në inkasimin e të hyrave të komunës.

Naser Muja: Dëgjova me vëmendje të gjitha kërkesat e parashtruara. Janë aq shumë, saqë mu duk që s'u punua katër vitet përpara kurrgjë. Seriozisht po e them, edhe prej opozitës edhe prej pozitës. Kërkesat janë të shumta dhe nuk mund të ndryshojmë sot diçka të tillë. E keni derën të hapur të gjithë me ardhë dhe unë ju respektoj të gjithëve, pa marrë parasysh pozitë apo opozitë. Kontratat i kam kornizë dhe kam me i plotësuar disa kërkesa të juaja. Me ndryshuar në buxhet për momentin nuk kemi mundësi, për arsye se ne e kemi bërë një buxhet bashkërisht me gjithë kabinetin, me gjithë drejtorët. Kështu që është e telash tash me bërë një kod

të posaçëm. Kam me qenë në dispozicion të të gjithëve, pa dallime, edhe për asamblistët e opozitës edhe për ata të pozitës. Znj. Igballe më pyeti: si arrite me e bind Kryetarin për gjithë këtë buxhet? Ka qenë shumë e thjeshtë, sepse kërkesat kanë qenë aq të mëdha dhe obligimet aq të mëdha, saqë edhe ky vend në terren, bashkërisht, kemi dalë dhe kemi parë. Do të thotë, kjo u bë në mënyrë të sinkronizuar dhe nuk ka pasur nevojë me e bindur. Te ti, Shkëlqim, te ajo pjesë nën urë, aty plotësisht ke të drejtë. Besoj që javën tjetër aty ka me u rregulluar çështja.

Kryetari Faton Peci: Kam harruar diçka shumë të rëndësishme. Mes të tjerash, është diskutuar, në kuadër të premtimeve të mia publike, çështja e udhëkryqit që te ne njihet si udhëkryqi te Nënë Tereza. Këtu keni të drejtë. Në diskutimet që i kam pasur me ministrin e Infrastrukturës, ai më ka pyetur se cili është prioriteti numër një që ti, si Kryetar i Mitrovicës, e ke si investim të Ministrisë së Infrastrukturës. Për mua, kërkesa ime numër një si investim infrastrukturor për Mitrovicën është rregullimi i rrethrrotullimit te lokaliteti që ne e njohim si tek Nënë Tereza. Kështu që planifikimi është që deri në fund të muajit të përfundojë projekti dhe Ministria e ka marrë përsipër në tërësi investimin infrastrukturor aty, që siguron në radhë të parë siguri për qytetarët. Po, e vërteta është se ajo është pika më e rrezikshme sa i përket aksidenteve dhe përfundimit të tyre me fatalitet. Kështu që unë e kam vendosur si kërkesë numër një të drejtuar te Qeveria. Ajo ka marrë rrugë. Ata tash janë në fazën finale të hartimit të projektit dhe ka me u buxhetuar dhe ka me u adresuar. Jo vetëm ajo, por njëkohësisht edhe çështja e udhëkryqit te Zhabari, paralelisht, është si të thuash pjesa e dytë e atij projekti, që synon me u adresuar bashkë me rrugën që ne e quajmë rruga e gaterrëve. D.m.th. këto janë dy prej projekteve që unë i kam prioritizuar në kërkesat e mia për adresim në nivel të Qeverisë. Ajo është një pikë me ndjeshmëri dhe rrezikshmëri. Edhe unë kam thënë që prioritet është me investuar aty ku mundet me u parandaluar aksidenti e aq më tepër edhe fataliteti për qytetarët. Nuk ka kurrgjë më prioritet se ai projekt.

Gazmedn Gjoshaj: Sa i përket zotimeve shumëvjeçare që ju thatë se nuk janë respektuar, ato të gjitha janë respektuar në përpikëri, përveç njërit, që është rruga Zhabar–Vllahi, të cilën po dojna me e kryer sivjet. Ndërsa, sa i përket numrit të stafit, ajo është në bazë të Rregullores së re të Ministrisë së Financave. Më së pari jemi duke shtuar BDMS-in dhe mandej pjesën tjetër prej 89 numrave, ato kanë me u bartur nëpër drejtori të ndryshme. Ndërsa numri që është, veç numër, nuk ka me mbetur, sepse nuk po dua me lënë numër afektiv. Me qenë në rend dite unë kisha ditur me e mbrojte, po pasi nuk është në rend dite, s'kemi çka të diskutojmë për të.

Valon Brahimi: Unë e kam parë që në buxhet nuk ka asnjë projekt infrastrukturor, në kuptimin e rrugëve për Kiqin. S'ka pasur parimisht as për kanalizim. Po në rregull, u dakordu që do të ketë për kanalizim. Po më intereson me e ditur, drejtor, sa metra kanalizim e keni paraparë me rregulluar në Kçiq në vitin 2027 dhe cilat lagje përfshihen? Edhe po më intereson me ditur a po përfshihen në këtë buxhet edhe kërkesat e asamblesë, Igballes, Gjergjit edhe të Shkëlqimit, që me nda nja dy-tri centë edhe për rrugë në Kçiq, se ke nja 60 rrugë pa rregulluar. Edhe pjesa tjetër që ndërlidhet me çështjen e buxhetit ka të bëjë me drejtorin e Arsimit. Drejtor, ju e dini që keni kontrata aktive për transportin e nxënësve. Nuk e di a e dini që, për herë të parë në Kçiq të Madh, prej që ekziston shkolla e keni veç një paralele të klasës së parë. D.m.th. ka mbetur një paralele me 10 12 nxënës. Po e shoh të rëndësishme që ata nxënës, për shembull te lagjja Aliut, që janë lart, prapë i lini kilometra larg. Një kilometër larg prapë jeni duke i lënë fëmijët prej shtëpive. Është lokaliteti më i thellë. Kërkoj që kjo punë urgjentisht të rregullohet dhe operatori ekonomik t'i çojë nxënësit deri ku paguhet. Jemi lënë në gjysmë të rrugës për lagjen Aliu, është Ijala. Edhe, në të njëjtën kohë, kisha kërkuar me marrë masa, 50% e nxënësve të shkollës së fshatit Kçiq i vijojnë mësimet në shkollën e Smrekovnicës. Është mirë diçka me bërë me Drejtorinë Komunale të Arsimit të Vushtrrisë dhe me u ndalë kjo farë praktike. Shkolla e Kçiqit po zbrazet. Unë jam i Kçiqit, po përgjegjësia është e juaja, drejtor. Nuk duhet me u mbyll shkolla për shkak se jo që s'ka fëmijë, po s'ka interesim të njerëzve me ardhur aty.

Igballe Islami: Përgjigjja e drejtorit të Financave që nuk është në rend, me të vërtetë është shqetësuese. Kështu, shumë sinqerisht po e them. Ka propozuar Komiteti për Politikë dhe Financa. Është procesverbali ku ka kërkuar vetë, jo që ka kërkuar dikush tjetër. Ky ka kërkuar me u shtuar 450.000 € në Kçiq. Nuk e ka reflektuar në buxhet. Përderisa ka kërkuar, është dashur me qenë sot këtu. Unë nuk e di qysh s'po ju duket që është rend dite. Ne jemi tu diskutuar për buxhet? Kryetar, nuk pati kurrfarë tendence ndaj askujt. Gjurmët flasin, ti the gjurmët; numrat flasin. Janë ato që shihen. Ti vetë e ke prioritizuar Drejtorinë e Infrastrukturës. Jo që patëm ne tendencë. Nuk është në rregull me thënë që keni gjetur obligimet, qysh e the, se kemi diskutuar edhe njëherë në një seancë tjetër. Kjo ka pasur të bëjë me kontrata në shtrirje trevjeçare, ku janë zotimet për tre vite. As edhe një kontratë, bashkë, as edhe një kontratë nuk është pa mbulesë financiare. Janë kontratat, janë në Zyrën e Prokurimit. Janë deklaratat e nevojës. Vetëm një gjeje që është pa mbulesë financiare, sepse

ne këtu lehtë mundemi me fol, po mirëpo janë dokumentet ato që flasin. Tjetra, ne mundemi me diskutuar, mirëpo para nesh tetë vite ka qeverisur Vetëvendosja në Mitrovicë. Tetë vite, jo katër. Mirëpo, dyfishin e tonës, edhe këtu ka qenë prej nënkryetarëve e drejtorëve të përfshirë Naser Mujën, që ka qenë drejtor, e ulte dhe bënte kërkesa pikërisht për infrastrukturë. Kështu që kjo është ajo që tha edhe Erseka më herët: ndërrojnë rolet, mirëpo ne jemi këtu për me i përfaqësuar qytetarët. Kështu që unë prapë shumë kërkoj falje. Ndoshta e zgjata pak shumë, mirëpo te pjesa e buxhetit jam munduar vetëm me kryer pjesën, ndoshta mbikëqyrëse, ndaj Ekzekutivit. Ndërsa, kërkoj, meqenëse është planifikuar rikonstruimi i urës së Sitnicës, kërkoj, Kryetar, duke e parë shumë të nevojshme, urën e Vaganicës, të futet në buxhet ndërtimi i saj. Me të vërtetë është në gjendje jo të mirë dhe ka frekuentim të madh. Gjithashtu kërkoj që të buxhetohen edhe rrugët në Vaganicë edhe te Ura e Gjakut, sepse nuk kanë asnjëra buxhet për vitin 2027. Mirëpo kërkoj që ura e Vaganicës me të vërtetë të jetë prioritet, për shkak të kushteve dhe rrethanave në të cilat ndodhet për momentin.

Kryetari Faton Peci: Shumë shkurt, rreth çështjes së urës së Vaganicës, është bashkë me udhëkryqin pjesë e trajtimit të Ministrisë së Infrastrukturës, kemi marrë zotimet. Ata kanë dalë, kanë deleguar ekipet profesionale, projekti ka përfunduar, Kështuqë intervenimi në urën e Vaganicës është në proces. Përveç të tjerash, është edhe në kuadër të përgjegjësive që ndahen mes komunave dhe institucioneve qendrore, në këtë rast Ministrisë së Infrastrukturës. Ajo është pjesë e përgjegjësisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe ata e kanë marrë përsipër renovimin dhe ndërhyrjen në të.

Shefki Begu: Unë i kam disa pyetje. Tri i kam prej Xhuljetës, një prej Liridonës dhe një Lavdimit. Pyetja e parë është për një klasë, d.m.th një aneks-klasë në "Aziz Sylejmani". Kjo kërkesë ka qenë edhe më herët dhe më duket që e kemi një projekt për të, do ta marrim seriozisht këtë kërkesë. Edhe mandej ke për edukimin parashkollor. Këtu ne kemi probleme, se ju e dini që kemi pasur problem me numrat dhe i kemi krejt 17 numra, që këta shkojnë me konkurs të rregullt. Edhe duhet me i pasur prioritetet. Ne fëmijët me nevoja të veçanta i kemi në pozitë të palakmueshme, d.m.th. krejt i kemi pesë asistente për fëmijë me nevoja të veçanta dhe duhet me orientuar pak me numra në këtë kategori. Përndryshe, do të ishte prioritet edhe kjo. Edhe për furnizimin me mjete të konkretizimit, kompjutera për shkolla. Është kërkesë e arsyeshme, sidomos në shkollimin fillor. Kemi shumë nevojë dhe do të marrim masa edhe në këtë pjesë. Liridona një pyetje tha se si ne do të gjendemi me këtë buxhet. Me këto mjete do t'i orientojmë sipas prioriteteve dhe nevojave më urgjente në shkolla. Ne mendojmë që, me një ndarje proporcionale dhe një menaxhim më të mirë, do t'ia dalim edhe kësaj radhe. Lavdimi tha për një fushë. Po, ne i kemi dy fusha fusha multifunksionale në shkollën "Skënderbeu" edhe në shkollën "Migjeni". D.m.th. edhe aty e kemi prioritet, po kur t'i vijë radha. Valon, nuk kemi pasur ankesë për nxënësit për transport. E dëgjova prej teje. Kemi me e marrë seriozisht. Është e arsyeshme. Me udhëzim administrativ është se aty ku është shkolla më afër; aty duhet me vijuar mësimin. Po ne do të marrim masa dhe kjo është kërkesë e arsyeshme.

Naser Muja: Valon, besoj që kanë me u përfshirë të gjitha lagjet, se prioriteti numër një ka qenë Kçiqi për kanalizim për ne. Edhe vetë kam dalë në vendin e ngjarjes, ndoshta të ka treguar dikush, edhe i kemi analizuar të gjitha. Po kanë me u kryer të gjitha kanalizimet në fshatin Kçiqi Madh dhe Kçiqi Vogël në vitin 2027. Sa i përket pyetjes së zonjës Islami, që tha se kanë qenë zotimet për të gjitha këto shërbime, asnjë zotim s'kemi gjetur. Veç po t'i them shumë qartë: ka qenë një kontratë e lidhur me 600.000 €, për ngritje, mirëmbajtje dhe revitalizim, nuk ka qenë asnjë mjet i zotuar. 600.000 € veç një kontratë e keni pasur pa zotim të mjeteve. Igballe, kisha lutur me pasur faktin se keni pasur mirëmbajtjen e rrugëve verore, 350.000 €. Veç këto dy kontrata e kalojnë shumën që ju keni planifikuar.

Shkëlqim Ibrahimi: Për neve, si asambleistë të PDK-së, është gjithçka e qartë. Nuk jam i kënaqur aspak. Përgjigjet i kemi marrë dhe e pamë se sa janë përfshirë kërkesat tona, të cilat besoj se janë të arsyeshme.

Fitore Mehmeti: Përshëndetje, Kryetar, i nderuar Kryesues, ekzekutiv, Nënkryetar dhe të pranishëm. E nderuar Liridona, patët një pyetje për mua dhe po ju përgjigjem me shumë kënaqësi, lidhur me pyetjen për aneksin te zjarrfikësat. Sa i përket zjarrfikësve, nuk e di a keni bërë diçka, jo çfarë kemi bërë ne për këta tetë muaj. Kjo është përgjigjja që mendoj se e përmbledh krejt. Sa i përket përgjigjes së Liridonës, zjarrfikësit nuk e kanë sjellë projektin përfundimtar, e kanë vetëm një projekt ideor. Ne e presim projektin përfundimtar dhe i përfundojmë të gjitha punët që na përkasin neve.

Ramadan Beshiri: Po ju përgjigjem pyetjes së asamblistës, si dhe komentit të zonjës Sazan Ramaxhiku dhe asamblistit Bajram Istrefi, të cilët patën sugjerime shumë me vend. Ne, në draft-buxhetin e këtij viti, kemi 54,000 € më tepër për subvencione në mirëqenie sociale, a janë të mjaftueshme, jo nuk janë të mjaftueshme,

kjo është çështje tjetër, mirëpo kemi edhe koordinim që nga të hyrat vetanake të vitit që po lëmë, një pjesë e tyre do t'i dërgohen apo do t'i transferohen Drejtorisë për Mirëqenie Sociale. Në kuadër të këtyre të hyrave mund të planifikojmë edhe për pllakat përkujtimore, të cilat po ashtu janë shumë me vend dhe që i ka paraqitur zoti Bajram Istrefi. Këto janë ide edhe tonat, të Kryetarit dhe drejtorit Shefki Begu, të cilat në diskutimet tona të brendshme i kemi paraparë edhe heronjtë e kohëve më të hershme, në mënyrë që ta ruajmë memorien kolektive dhe secili prej tyre të ketë nga një pllakë përkujtimore. Sa i përket fëmijëve me aftësi të kufizuara, edhe në Planin për Shërbime Sociale dhe Familjare, i cili vjen së shpejti, ata janë prioritet i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale. Mirëpo, normalisht, duhet ta kemi parasysh që të kufizohemi bazuar në buxhetin që kemi. Dëshira ka qenë për një buxhet shumë më të madh për Drejtorinë e Mirëqenies Sociale. Mirëpo, një lajm i mirë mund të ndodhë nëse rrethanat politike shkojnë mirë dhe vazhdon puna e Kuvendit, që të bëhet granti specifik për mirëqenien sociale. Pastaj nuk do të kemi më problem për subvencionimin as të fëmijëve, as të gjitha kategorive të tjera të cenueshme.

Gjergj Beka: Pyetje për drejtorin Naser: a e ke në planin tënd të punës rregullimin dhe asfaltimin e rrugës së malit që e propozova më herët, por nuk mora përgjigje prej teje, si dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit në fshatin Kçiq, sepse nuk e pashë askund?

Naser Muja: Për vitin 2027 nuk është në projekt-buxhet. Për vitin 2028 do të jetë në buxhet. Ndërsa, sa i përket pyetjes tjetër, për ndriçimin dhe zgjerimin e tij, nuk mund të realizohet vitin që vjen. Ndërsa, për mirëmbajtjen, çfarëdo nevoje që kemi, kemi kontratë dhe mund të reagojmë ku të jetë e nevojshme.

Kryesuesi Safet Kamberi: Vërejtja e Kryetarit që të korrigjohet te zgjerimi i rrjetit të kanalizimit dhe pusetave, të shkruhet Kçiq, Shalë e Bajgorës, Koshtovë dhe kështu me radhë, bëhet fjalë për kodin 35028, në kuadër të nënprogramit 48022. Është vetëm një ndryshim teknik, ndërsa ndryshime të tjera nuk ka nevojë, sepse përveç kërkesave që ishin si nevojë, nuk pati ndonjë kërkesë specifike që të intervenohet në kategoritë buxhetore.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë e hedh në votim, Draft-buxhetin për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029.

Rezultati i votimit: të pranishëm 31, 18 për, 13 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoj se me shumicë votash u miratua Buxheti për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029.

Pika 5

Kryesuesi i Kuvendit sa i përket Propozim-vendimit për caktimin e pronës komunale për ndërtimin e fushave të tenisit dhe fushave të padelit theksoi se kemi pasur një vërejtje ose interpretim të dhënë nga ministria e linjës në raport me këtë çështje. Në kuadër të aprovimit të propozimit të ri, duhet të futet edhe si pikë shfuqizimi i vendimit paraprak, i cili është marrë në Kuvendin e Komunës. Atëherë, e hap diskutimin.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Shumë shkurt po e marr fjalën këtu, për shkak se më ka habitur, mënyra se si është kthyer kjo pikë e rendit të ditës përsëri për rivotim, kur dihet fakti që flitet për të njëjtën parcelë, për të njëjtën hapësirë, me destinacion për aktivitete sportive dhe me investim nga Ministria e Sportit dhe Rinisë. Ndërsa vërejtja ka qenë që vizatimi nuk është kështu, por duhet të kthehet në këtë mënyrë. Do të thotë, sido që të jetë, unë jam ithtar që të kemi ligjshmëri dhe të jemi strikt, por vetëm kthimi i pikës së rendit të ditës dhe marrja e gjithë kësaj pjese të intervalit kohor është, sinqerisht, e paarsyeshme. Sido që të jetë, është një vonesë që na është shkaktuar diku një ose dy muaj, sepse deri në këtë fazë ndoshta vetëm ishte bërë shpallja publike e investimit, i cili është një investim tepër i rëndësishëm dhe që e plotëson kuadrin, vetëm këtë vit dhe vitin e ardhshëm, investimet në sport kapin vlerën mbi 5.000.000 €, në fusha të hapura dhe të mbyllura për veprimtari të ndryshme. Kështu që, duke përfshirë Omnisportin, dy fusha futbolli, pesë fusha tenisi, dy fusha padeli dhe pastaj edhe çështjet e tjera që janë në proces. Por, sido që të jetë, mirë që po shoh që nuk ka të interesuar për të diskutuar, sepse sikur heshtja juaj po tregon që krejt ky kthim është pa lidhje. Nuk e di nëse Ministria e Pushtetit Lokal apo Ministria e Financave e ka kthyer këtë çështje, duke thënë se nuk është kështu, por duhet të kthehet në këtë mënyrë.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë e hedh në votim, propozim-vendimin, ku në kuadër të këtij propozim-vendimi futet edhe pika e shfuqizimit të vendimit paraprak të Kuvendit, në raport me të njëjtën çështje.

Rezultati i votimit 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoj se u miratua unanimisht Vendimit për caktimin e pronës komunale për ndërtimin e fushave të tenisit dhe fushave të padelit.

Pika e 6

Kryesuesi para se të hapë diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për formimin e jurisë profesionale për ndarjen e Çmimit "Kadri Kadriu" theksoi se Drejtoria ka bërë propozimin e personaliteteve të cilat duhet të jenë pjesë e jurisë profesionale: Tafil Peci, Skënder Muja, Sabri Behrami dhe dy anëtarë të tjerë të cilët janë planifikuar nga anëtarët e Kuvendit, me e-mail e keni marrë edhe konkluzionin e Komitetit për Politikë dhe Financa: Komiteti për Politikë dhe Financa miraton propozim-vendimin për formimin e jurisë profesionale për ndarjen e Çmimit "Kadri Kadriu". Komiteti për Politikë dhe Financa i rekomandon Kuvendit të Komunës që të ndryshojë përbërjen e jurisë profesionale si në vijim: Tafil Peci, Skënder Muja, dhe Merita Maloku. Propozim-vendimi për formimin e jurisë profesionale për ndarjen e Çmimit "Kadri Kadriu", (i ndryshuar sipas rekomandimit të pikës 2 të këtij konkluzioni, i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim. Në Komitet ka qenë pyetja për barazinë gjinore dhe është plotësuar me Merita Malokun.

Atëherë, a ka diskutim rreth kësaj çështjeje nga anëtarët e Kuvendit? Nuk ka diskutim. Atëherë, e qes në votim bazuar në rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Rezultati i votimit: 24 për, 0 kundër dhe 1 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar me shumicë votash Vendimin për formimin e jurisë profesionale për ndarjen e Çmimit "Kadri Kadriu".

Pika e 7

Kryesuesi i Kuvendit theksoi se edhe për Propozim-vendimin për formimin e Komisionit për ndarjen e Çmimit "Lah Nimani", e kemi konkluzionin e Komitetit për Politikë dhe Financa: Komiteti për Politikë dhe Financa miraton propozim-vendimin për formimin e Komisionit për ndarjen e Çmimit "Luan Nimani". Komiteti për Politikë dhe Financa i rekomandon Kuvendit të Komunës që, në përbërjen e Komisionit, anëtarët nga radhët e Kuvendit të përfaqësohen nga katër subjektet politike më të mëdha të përfaqësuara në Kuvend, duke pasur parasysh edhe përfaqësimin gjinor. Propozim-vendimi për formimin e këtij Komisioni për ndarjen e Çmimit "Lah Nimani" i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Atëherë, konkluzioni ka qenë që katër partitë më të mëdha të përfaqësohen në këtë përbërje të Komisionit prej shtatë anëtarësh. Dy janë nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile. Atëherë, a pajtoheni që ky të jetë çelësi i Kuvendit dhe partitë e tjera të deklarohen?

Në vazhdim Kryesuesi kërkoi nga subjektet politike të propozojnë anëtarët e tyre për anëtarë të Komisionit:

Shkëlqim Ibrahimi: Nga radhët e PDK-së, propozoj z. Fisnik Suma.

Kushtrim Zeneli: Nga radhët e LVV-së, propozoj znj. Rinesa Preteni.

Elfate Ademi Bahtiri: Nga radhët e GUXO-së, propozoj znj. Rozana Peci.

Xhyljeta Imeri: Nga radhët e LDK-së, propozoj z. Oltion Ahmeti.

Kryesuesi thekson se dy anëtarë janë nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile: Emin Baliqi, Besim Shala dhe Edin Lahi.

Kryesuesi i Kuvendit hedh në votim Propozim-vendimin për formimin e Komisionit për ndarjen e Çmimit "Lah Nimani" në përbërje si në vijim: Fisnik Suma, Rinesa Preteni, Rozana Peci, Oltion Ahmeti, Emin Baliqi, Besim Shala dhe Edin Lahi.

Rezultati i votimit: 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoj se unanimisht miratohet Vendimi për formimin e Komisionit për ndarjen e Çmimit "Lah Nimani".

Pika e 8

Kryesuesi i Kuvendit sa i përket Propozim vendimit për mbështetjen financiare për katër familjet e rrezikuara nga rrëshqitja e dheut në lagjen Bair, e dini që ne, në një nga seancat e kaluara kemi aprovuar një vendim për tetë familje të tjera. Mirëpo, ndërkohë janë identifikuar edhe katër familje të tjera, sipas drejtorisë.

Ramadan Beshiri: Kanë qenë 12 familje, por për shkak se rregullorja për subvencionimin e parasheh me e pasë një tavan, u desh të shkonim me tetë familje njëherë dhe pastaj me katër familje.

Kryesuesi i Kuvendit: Faleminderit, drejtor, për sqarimin. Dikush nga anëtarët e Kuvendit, a ka diskutim rreth kësaj çështjeje? Nëse nuk ka, e qes në votim.

Rezultati i votimit: 31 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoj se unanimisht miratohet Vendimi për mbështetjen financiare për katër familjet e rrezikuara nga rrëshqitja e dheut në lagjen Bair.

Pika e 9

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për miratimin paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës personave fizikë dhe juridikë, të parcelës me numër P-71208072-01870-5.

Artan Berisha: Sa i përket kësaj pike, kjo dihet se është në Bair, te spitali, dhe bëhet fjalë për 21 ari. Kryetar, unë e di që ndoshta nuk e ke informatën, dhe sigurisht nuk e ke, duke u nisur nga ajo që je thirrur për të punuar me ligje. Nuk është bërë bartja e kësaj parcele në kohë dhe kjo parcelë i takon Ministrisë së Shëndetësisë. Është dokumenti. Ne e kemi pasur këtë parcelë në plan për këmbim, e kemi bërë vlerësimin e kësaj, kemi dashur ta bëjmë këmbimin e kësaj për hapjen e rrugës por gjatë procedurës e kemi bërë edhe vlerësimin e kësaj parcele dhe kur ju kemi drejtuar me shkresë Ministrisë së Shëndetësisë, Ministria e Shëndetësisë pretendon se është parcelë e saj, është përgjigjja e tyre në Drejtorinë e Kadastrit, është në zarf, ashtu siç ka ardhur. është lexuar dhe është brenda në zarf, në zyrë, diku te drejtori i kadastrit. Në qoftë se ai nuk mund ta gjejë, atëherë besoj se javën e ardhshme ose në seancën e ardhshme mund t'ua siguroj. Në një farë forme ndihemi edhe në lajthitje sa i përket kësaj, sepse ne e kemi stopuar procedurën në mes dhe nuk jeni lëshuar në këto veprime. Kështu që po mendoj se jemi në lajthitje te kjo pjesë. Pa u vërtetuar saktë, 100 për qind, se e kujt është parcela, nuk do të ishte mirë as të vinte këtu. Është mirë që të tërhiqet si pikë e rendit të ditës. E di që është në dokumente këtu, mirëpo bartjen nuk e ka bërë Ministria e Shëndetësisë asnjëherë, kur kam kërkuar zyrtarisht, është edhe shkresa ime, del që është pronë e spitalit. Mund të na nxjerrë telashe në të ardhmen. Pasoja juridike sigurisht që do të kemi.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: E para, për mua është e habitshme që është duke folur ish-drejtori i Kadastrit. Unë nuk punoj me zarfa, punoj me atë që thonë letrat. Mekanizmi i verifikimit të çdo prone është Kadastri dhe të dhënat që i posedojmë. Ka shumë anomali në aspektin kadastral. Njëra proj vështirësive, objektivisht, dihet: të gjithë regjistrat origjinalë kadastralë i ka marrë Serbia dhe nuk i ka sjellë. Ne, si shoqëri, nuk kemi ditur të bëjmë presion të mjaftueshëm karshi Serbisë, posaçërisht në procesin e negociatave, që t'i kthejë ato regjistra origjinalë. Por unë jam i prirur t'ju besoj, unë kurrë nuk kam pirje që, kur dikush ma sjell një dokument prej Kadastrit, të them se nuk është i vërtetë ose nuk është real. Për shkak se mendja ime e shëndoshë nuk mund të supozojë që dikush në Kadastër e ka të evidentuar një pronë, ndërsa diku tjetër, nëpër arkiva, ekziston një zarf me një përgjigje që thotë diçka tjetër. Unë as drejtori nuk besoj se ka obligim ta dijë se çka ka në zarfat e komunikimit. Për këtë arsye, në praktikën demokratike, në procesin e bartjes së përgjegjësive prej një titullari te titullari tjetër, ekziston ai proces që quhet "handover". Ia jep krejt çka ke për punë, çka është në proces, dhe, nëse ka ndonjë zarf, duhet t'ia japësh drejtorit të ri dhe t'i thuash: Drejtor, këtu na ka ardhur një zarf prej ministrisë. Kështu që, çështja është që unë i kam bërë kërkesë ekzekutivit. I kam thënë: prej kësaj seance, listën që është e aprovuar për dhënien në shfrytëzim, cilat janë gati, sillni, sot i kemi dy. Tash, unë dua ta dëgjoj edhe opinionin e drejtorit, sepse ai është iniciuesi. Çështja është që, në seancat e radhës, prapë duke u bazuar në atë listën e datës së fundit të marsit të këtij viti, çka është gati, unë do ta qes si pikë të rendit të ditës deri në fund të mandatit. Ndoshta do të vijë njëherë një seancë ku do t'i kemi 50 pika, ku ka prona për t'u dhënë në shfrytëzim për afarizëm, për të krijuar hapësirë për biznese, unë do ta bëj shpalljen publike, le t'i presim propozimet që do t'i marrim. Por kjo është një situatë e re. Do të thotë, kjo është një situatë e re. Tash ka edhe një lëndë. Unë po i shoh, kryesuesin dhe përfaqësuesin e sekretariatit, këta i kanë dokumentet. Tash, a duhet t'i besojmë qytetari, fletës poseduese, apo duhet të besojmë ty që po thua se është një zarf atje? Komuna e Mitrovicës së Jugut, do të thotë, fleta poseduese, pronari: Komuna e Mitrovicës. Data e azhurnimit: 11.06.2015. Po këtu ka fletë poseduese të nxjerrë nga Kadastri. Ti po na konteston me një zarf. Tash, qysh me vepru tutje? Unë jam i prirur t'iu besoj letrave. Në rast se dikush na lajthit dhe na sjell dokumentacion që nuk është valid dhe nuk është në rregull, ata përballen me proceset e tjera. Ama, përderisa

është e azhurnuar, përderisa e kemi prej Kadastrit, unë mendoj që duhet të shkojmë tutje. A vjen ndonjë interesim apo nuk vjen interesim, është temë tjetër për diskutim. Por drejtori duhet të japë sqarimin.

Artan Berisha: Kryetar, nuk është problemi me punuar me zarfa, sepse edhe ti e ke përvojën institucionale qysh shkon. Bile, s'kemi çfarë të të mësojmë ty për zarf, se e di. Kur ke diçka me urgjencë, e çon kërkesën fizike, e protokollon, e fut në zarf dhe postieri e dërgon. Në atë formë e ka kthyer edhe Ministria. Kjo është çështja e zarfit, Kryetar. Është dërguar kërkesa me zarf dhe është kthyer me zarf. Bartjen pse nuk e ka bërë Ministria e Shëndetësisë, ajo nuk është pjesë e imja. Në fund të fundit, Ministria i ka letrat, mundet me ardhur nesër, pasnesër, kurdo që të jetë, sepse ajo e ka marrë në shfrytëzim. As FSK-në nuk e ke, as shkollën, domethënë, krejt i ke prona që nuk janë të bartura.

Kryesuesi i Kuvendit: Ministria e Shëndetësisë prej kujt e ka marrë?

Artan Berisha: Prej komunës, prej Kuvendit Komunal, ka vendim të Kuvendit për këtë. Unë si shqetësim e ngrita, e kam diskutuar edhe në grupin tim parlamentar. Për neve është vërje në lajthitje. Ju kam paralajmëruar, po besoj që jam në rregull sa i përket kësaj pjese.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse nuk gaboj, në vitin 2014-2015 ka qenë një propozim-vendim në Kuvendin e Komunës. Në atë kohë kam qenë nënkryetar i komunës dhe është tentuar që, për të njëjtën pronë, të jepej në shfrytëzim për ndërtimin e çerdhes. Ne e kemi kundërshtuar si Kuvend dhe nuk ka kaluar. Nëse s'gaboj, po gjithherë po referohem si pronë komunale, nuk është miratuar.

Nazmi Kelmendi: Për shkak të transparencës, po e lexoj një shkresë të datës 13.08.2014. "Ju njoftoj se më datë 1 dhjetor 2006 është nënshkruar marrëveshja në mes të Administratorit të UNMIK-ut dhe Ministrit të Shëndetësisë për shfrytëzimin e tokës ku është ndërtuar Spitali Rajonal i Mitrovicës. Kjo marrëveshje nuk ka kaluar nëpër procedurat e rregullta në Asamblenë Komunale të Mitrovicës. Prandaj kërkojmë nga ju për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të parcelës 1870/1, e cila gjendet në zonën spitalore dhe është e paraparë me planin hapësinor të qytetit." Do të thotë, nuk ka kaluar nëpër procedurat e Asamblesë dhe këtu nuk bëhet fjalë për parcelën. Titullari i parcelës është Kuvendi Komunal. Këtu bëhet fjalë për 2,000 metra katrorë nga sipërfaqja e tërësishme.

Kryesuesi i Kuvendit: Të them të drejtën, tash si anëtarë të Kuvendit, besoj që pjesa dërrmuese e neve, si anëtarë të Kuvendit, e kemi për detyrë t'u besojmë certifikatave. Në bazë të certifikatës ose dokumenteve të lëshuara nga Kadastri, ne e marrim ose nuk e marrim vendimin. Por, sa i përket kontestit të kësaj çështjeje, unë nuk e di sa është çështja jonë. Nëse ka kontest, unë besoj që kjo çështje kthehet përsëri. Atëherë këtë çështje e qes në votim.

Rezultati i votimit: Të pranishëm janë 29 anëtarë të kuvendit, 15 për, 13 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se më shumicë votash miratohet Vendimi për miratimin paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës personave fizikë dhe juridikë, të parcelës me numër P-71208072-01870-5.

Pika e 10

Kryesuesi i Kuvendit sa i përket Propozim-vendimit për formimin e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës personave fizikë dhe juridikë, të parcelës me numër P-71208072-01870-5, Komisioni, në këtë rast, duhet të ketë pesë anëtarë. dy nga ekzekutivi, dy nga Kuvendi dhe një nga shoqëria civile.

Shkëlqim Ibrahimi: Ne si PDK nuk kemi propozim dhe nuk bëhemi pjesë e asnjë komisioni ku kemi dyshime për prona të tilla.

Kushtrim Zeneli: Nga VV-ja propozojmë Egzon Mehmetin.

Arta Neziri: Nga LDK-ja propozohet Oltion Ahmeti.

Kryesuesi i Kuvendit: Nga shoqëria civile propozohet Edin Lahi.

Nënkryetari Enis Osmani: Nga ekzekutivi propozohet drejtoresha e Shëndetësisë, Albina Kastrati Rama, dhe drejtoresha e Emergjencave, Fitore Mehmeti.

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votimpropozim vendimin me përbërjen e komisionit si vijon: Egzon Mehmet, Oltion Ahmeti, Albina Kastrati-Rama, Fitore Mehmeti dhe Edin Lahi.

Rezultati i votimit: Të pranishëm janë 29 anëtarë të kuvendit, 17 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se me shumicë votash miratohet Vendimi për formimin e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës personave fizikë dhe juridikë, të parcelës me numër P-71208072-01870-5.

Pika 11

Kryesuesi i Kuvendit: Vazhdojmë me Propozim-vendimin për miratimin paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës personave fizikë dhe juridikë, të parcelës me numër P-71202012-VI009-1. Atëherë, diskutimin e shpallim të hapur. Para se të kalojmë te diskutimi, meqenëse këtu i kemi banorët e fshatit Kçiq, e ftoj Përfaqësuesin e Fshatit që ta marrë fjalën.

Fatmir Salihu: Përshëndetje Kryetar, drejtorë, asamblistë dhe bashkëfshatarë të Kçiqit të Madh. Po jap një arsyetim kundër kësaj pike të rendit të ditës, për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale në Kçiq të Madh. Çështja e gurthyesit të Kçiqit të Madh nuk është një shqetësim i ri, por është një problem me të cilin banorët e këtij fshati përballen tash e shtatë vite. Në vitin 2021, gjatë kohës kur drejtor i Infrastrukturës ishte z. Naser Muja, veprimtaria e gurthyesit ishte bërë objekt i shqetësimit të vazhdueshëm të banorëve, si dhe i ankesave dhe peticioneve të tyre. Në maj të vitit 2022, veprimtaria e gurthyesit ishte ndaluar nga Drejtoria e Inspeksionit të Kuvendit Komunal, për shkak të mungesës së lejes komunale për shfrytëzimin e pronës komunale, pas ankesave dhe peticioneve të banorëve. Pasojat e asaj veprimtarie janë konkrete dhe të dukshme. Janë dëmtuar rreth 3 kilometra rrugë të asfaltuara nga komuna, është dëmtuar rrjedhja dhe qasja e burimet të ujit, të cilin ne, banorët e fshatit Kçiq, e dimë se kanë qenë diku rreth 37 burime uji dhe prej tyre kanë marrë ujë rreth 200 familje. Janë evidentuar dëmtime dhe çarje në shtëpitë e banorëve, të evidentuara atëherë, në vitin 2019 dhe 2020. Është dëshmuar qartë se kundërshtimi i komunitetit ka qenë i vazhdueshëm dhe i dokumentuar. Sot përballemi me një propozim për dhënien në shfrytëzim të një sipërfaqeje prej 99 hektarësh, ndërsa më parë bëhej fjalë për një sipërfaqe më të vogël katër hektarë, për një periudhë prej 99 vitesh. Për këtë arsye, shqetësimi i banorëve është edhe më i madh. Nëse një veprimtari e tillë ka shkaktuar dëme të konsiderueshme në të kaluarën, është e arsyeshme që komuniteti të shqetësohet se zgjerimi i saj në një sipërfaqe shumë më të madhe mund t'i shtojë këto pasoja për shtëpitë, rrugët, burimet e ujit, tokën bujqësore dhe mjedisin. Pikërisht në këtë sallë, në të kaluarën, banorët e Kçiqit janë ftuar për të diskutuar në dëgjim publik për këtë problem nga deputetet e atëhershme dhe të tanishme, znj. Arjeta Fejza dhe znj. Fitore Pacolli, të cilat në atë kohë e patën shprehur qëndrimin e tyre kundër gurthyesit. Sot, qëndrimi ynë si banorë dhe si Këshill i Fshatit është i qartë: ne jemi kundër gurthyesit dhe kundër dëmtimit të vendit tonë. Kçiqi nuk ka nevojë për një gurthyes. Kçiqi ka nevojë për një çerdhe. Kçiqi ka votuar dhe ka nevojë për një rrugë. Kçiqi ka votuar dhe ka nevojë për ura. Kçiqi ka nevojë për shtëpi të kulturës dhe hapësira për fëmijë dhe të rinj. Kçiqi ka nevojë për investime që përmirësojnë jetën e banorëve, jo për veprimtari që rrezikojnë shtëpitë, ujin, tokën, rrugët dhe mjedisin e tyre. Ne nuk jemi kundër zhvillimit. Ne jemi për një zhvillim që i shërben Kçiqit dhe banorëve të tij. Prandaj, për ne kjo nuk është vetëm një pikë e rendit të ditës, por një çështje që prek drejtpërdrejt jetën, pronën dhe sigurinë e banorëve të Kçiqit të Madh. Në këto rrethana, kërkojmë që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës dhe të mos procedohet pa u trajtuar paraprakisht shqetësimet e banorëve, peticionet e tyre që ekzistojnë në komunë dhe pasojat e dokumentuara nga veprimtaria e mëparshme e gurthyesit. Kçiqi i Madh nuk ka nevojë për gurthyes. Kçiqi i Madh ka nevojë për investime kapitale. Kçiqi i Madh ka nevojë për zhvillim, jo për dëmtim. Kçiqi i Madh nuk e kundërshton zhvillimin, por kërkon që zhvillimi të mos bëhet në dëm të banorëve, pronës së tyre, ujit, infrastrukturës dhe mjedisit. Prandaj kërkoj nga të gjithë asamblistët që të votojnë kundër këtij propozim-vendimi. Tash i kam edhe tri-katër pyetje për kryetarin ose drejtorët e drejtorive komunale. Si ka mundësi që çerdhja nuk rregullohet në Kçiq të Madh, pasi që ka qenë në projektbuxhet dhe e buxhetuar?

Ndërhyrje nga Kryetari i Kominës z. Faton Peci: Mos më trego mua për çështje të tjera. Tetë minuta i ke në dispozicion fol për çka e ke marr fjalën. Nuk mundesh të mbash ligjërata këtu. Fol për temën dhe shfrytëzoje të drejtën ligjore.

Fatmir Salihu: E kam të drejtën time të flas tetë minuta, të lutem të përfundoj.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë, po e sqaroj qëllimin e marrjes së fjalës tënde në scancë. Gjithsesi, unë nuk dua të ta marr kohën. Ta jap edhe kohën shtesë, nuk ka problem. Mirëpo, dua që, në bazë të Rregullores së Kuvendit, në momentin kur qytetarët vijnë dhe dëshirojnë që përfaqësuesi i tyre të diskutojë në raport me një çështje, ne jemi në pikën konkrete. Domethënë, diskutimi duhet të jetë në raport me çështjen për të cilën po

flitet deri tash dhe nuk lejohet të dalë jashtë saj dhe të preken tema të tjera. Ju lutem, ngritini të gjitha ato shqetësime dhe çështje që dëshironi t'i thoni, por në raport me çështjen për të cilën po zhvillohet diskutimi.

Fatmir Salihu: Unë e pranoj. Por çfarë të bëj unë me banorët? Punëtorët e kabinetit të Kryetarit më kanë thënë që ke me prit në rend gjashtë muaj. Unë kërkesat e mia s'm'i kanë marrë parasysh hiç. Le të tregojnë drejtorët se çfarë kërkesash ka parashtruar Fatmiri, Kryetari i Këshillit të Kçiqit të Madh, Unë po dal tash jashtë, si i poshtër, si i lig. Domethënë, kërkesat e mia nuk janë përfillur. Për këtë dua t'i lexoj në ato tetë minuta. E shfrytëzova kohën edhe për ato. A ka diçka të keqe?

Kryesuesi i Kuvendit: Po, vetëm në çështjen për të cilën e ke marrë fjalën, në çështjen e rendit të ditës.

Fatmir Salihu: E çfarë po ju dhemb këtu? Çfarë po ju dhemb? Kujt po i dhemb këtu?

Kryesuesi i Kuvendit: Jo, nuk është çështja këtu.

Fatmir Salihu: E di, Unë i di rregullat. M'i ka treguar edhe z. Kamberi. Po, por unë, në pamundësi, besoj se nuk mundem të hyj edhe në ato çështje të tjera. Besoj se për këtë arsye i lexova, sepse kërkesat e mia nuk janë marrë parasysh, pavarësisht vullnetit tuaj. Unë tetë minuta i pata. Katër i shfrytëzova. Në fillim pata edhe një minutë për të lexuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Jo, jo. Ti i ke edhe katër minuta, nëse bisedon në raport me temën.

Fatmir Salihu: Faleminderit, z. Kamberi.

Kryesuesi i Kuvendit: Faleminderit, Fatmir.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Dua ta sqaroj. E para, secili qytetar që përfaqëson një komunitet, në bazë të legjislacionit, e ka të drejtën të vijë dhe të referohet, këtë të drejtë e shfrytëzove edhe ti dhe nuk ta mohon askush. Por nuk i lejohet dikujt të jetë i privilegjuar, pa qenë i zgjedhur i qytetarëve për asamble, të vijë dhe të mbajë fjalim politik për krejt veprimtarinë që përfshin Kçiqin, Mitrovicën dhe temat e tjera. E ke pasur temën, ne të dëgjuam me vëmendje. Të reagova për shkak se nuk mundesh të vish këtu të bësh fushatë kundër meje për çështje të caktuara, sepse nuk ke mandat. Nuk ke mandat në temat që ti i ngrite. E jep opinionin, kjo është në rregull. Sa i përket asaj se a të kam takuar më parë, personalisht ty nuk të kam takuar. Ndoshta të kam parë edhe ndonjëherë, por sot po të shoh për herë të parë.

Fatmir Salihu: Ndoshta më ke harruar.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Po, ndoshta të kam harruar, , sepse takoj shumë qytetarë dhe mund ta kem harruar ndonjë. Unë të dëgjova me vëmendje. Fillove të dalësh jashtë mandatit dhe reagimi im është se ti këtu je i thirrur, dhe e shfrytëzove të drejtën dhe të gjithë të dëgjuam, përfshirë edhe kryetarin e komunitetit. E ke mandatin tënd. Në rregull, qofsh me jetë të gjatë dhe uroj të jesh sa më gjatë kryetar i Kçiqit të Madh. Por nuk mund ta shfrytëzosh të drejtën dhe gjenerozitetin e kësaj komune për të ardhur të flasësh dhe pastaj të kalosh në tema të tjera. Pastaj e para, ju keni ardhur me përfaqësues dhe e keni shfrytëzuar të drejtën për të diskutuar. Për mua janë legjitime shqetësimet tuaja. Krejt është legjitime, për shkak se ju po bazoheni në praktikën tepër negative që e keni pasur në të kaluarën. Unë po them: e para, këtu nuk po flitet për 99 hektarë, për shkak se askush nuk e di se, në rast se ka interesim, kush dhe sa i kërkon. Nëse dikush kërkon dy hektarë, pesë hektarë apo dhjetë hektarë, 99 hektarë është parcela. Kjo nuk nënkupton që dikush kërkon 99 hektarë. Do të thotë se ka shumë keqkuptime.

E dyta, unë po ju them që, si Kryetar i Komunës, nuk lejoj asnjë veprimtari ose praktikë të tillë të minimit, të dëmtimit të rrugëve dhe të gjitha çështjeve të tjera që ju i përmendët dhe i theksuat këtu, për të cilat unë mendoj se ju duhet t'u drejtoheni organeve përkatëse, për dëmet dhe problemet që i keni pasur si lokalitet. A i ke denoncuar ndokënd? Ku i ke denoncuar? Hajde, më trego ku i keni denoncuar. Po, nuk ke denoncuar askund, sepse e ke linjën e komunikimit me PDK-në. Këto i dimë ne, si dhe disa çështje të tjera në Kosovë. Çështja është e thjeshtë. Unë nuk e kam përcaktuar këtë. Plani Zhvillimor Komunal është i votuar në vitin 2020. Harta Zonale është e përcaktuar në vitin 2020. Unë nuk e kam përcaktuar këtë lokacion për këtë veprimtari. A kuptoni? S'e kam përcaktuar. Nuk ka qenë në dorën time. Nuk ka qenë në dorën time. Të gjitha parcelat që janë për dhënie në shfrytëzim, duke u bazuar ligjërisht në destinacionin që e kanë, unë kam për t'i sjellë këtu në Kuvend. Jo vetëm këto, por edhe të gjitha të tjerat. Ndoshta do të ketë reagime të ndryshme në çdo cep të qytetit ku ka pronë komunale, me preferencë ato prona që janë të uzurpuara ose ato që i kanë marrë dhe nuk kanë investuar. Të gjitha kam për t'i sjellë një nga një në secilën seancë, deri në fund të mandatit. Nuk ka shans që dikush të ushtrojë ndonjë veprimtari që mund të jetë në kundërshtim me interesin publik, me interesin e lokalitetit apo të lagjes ku e ushtron atë veprimtari. E imja ka qenë me ekzekutivin. Ekzekutivin i kam pyetur

se cilat janë dy parcelat që deri në këtë fazë janë të gatshme për procedim. I kanë sjellë këto të dyja dhe të dyja i kam proceduar. Njëra u votua, ndërsa për tjetrën po vendoset. Edhe sikur, hipotetikisht, të vendoset për të, prapë nuk ndodh asgjë menjëherë. A e dini pse nuk ndodh? Sepse ka një komision tjetër, ka një projekt që duhet të aplikohet, ka një mekanizëm të Ministrisë së Ambientit që e monitoron, ka një mekanizëm të pavarur të minierave dhe mineraleve. Nuk janë praktikat e mëhershme. As nuk lejohen veprimtari jashtë standardeve dhe as nuk lejohen leje apo licenca jashtë standardeve. Kështu që, edhe nëse sot kalon, nuk ndodh asgjë menjëherë, për shkak se pretendimi juaj ndoshta është se dikush mund të vijë për një veprimtari krejt tjetër, të cilën ju do ta duartrokisnit dhe do ta mirëprisnit. Unë personalisht jam i interesuar që të ketë sa më shumë veprimtari në atë lokalitet.

A e dini pse? Në radhë të parë, për ta evituar rrezikun e zjarreve. Do të thotë, ne kemi planifikuar 290 hektarë, ia kemi dhënë ushtrisë, që ajo pjesë. E çka ka të keqe që ia keni dhënë shtetit dhe ushtrisë? Atje të mos ketë asnjë hapësirë publike për 11.000 banorë. A e kuptoni atë punë? Po mendoj vazhdimisht. Unë mendoj që fakti që është dhënë ushtrisë, Kçiqi është me fat. Është me fat për shkak se Kçiqi është ndoshta prej lokaliteteve më të sigurta në Mitrovicë, sepse e ka pronën aty ku e ka Ushtrinë e Kosovës.

Banorët le të aplikojnë këta për të marrë kullosa, në rast se diku ka të përcaktuar për kullosa. Për shembull, në rast se nuk shkon kjo pikë e rendit të ditës, ti s'mundesh me marrë për kullosë. Ti mundesh me apliku, e bën një projekt, formohet komisioni dhe mundeni me apliku për kullosë. Do të thotë, ato janë tri veprimtari. Më mirë është me e marrë në shfrytëzim, me e shfrytëzuar për kullosë. Më mirë një tokë që ka zot, qoftë edhe përkohësisht me një kontratë, sesa të mbetet djerrinë dhe ne të përballemi vazhdimisht me rrezikun e zjarreve. Në rast se njëra prej hapësirave është e dedikuar për kullosë, fermerët e Kçiqit mund të aplikojnë me një projekt për ta marrë në shfrytëzim për kullosë dhe mundet ligjërisht, për një periudhë afatgjatë, të ketë destinacionin e kullosës dhe shfrytëzimit nga blegtorët e Kçiqit. Kështu që kjo nuk ju privon juve nga kjo e drejtë. Përkundrazi, ne duhet ta trajtojmë ndoshta me një avantazh, në rast se qytetarët e atij lokaliteti aplikojnë që, për shembull, 20 hektarë të jenë në shfrytëzim.

Por edhe për këto nuk përfundon gjithçka, për shkak se ka edhe një Ligj të aprovuar, në nivel të Republikës, që duhet të kalojë, si dhe disa procedura të tjera. Ka edhe një zyrë brenda Zyrës së Kryeministrit që i ka disa filtra të tjerë. Kështu që nuk është krejt e thjeshtë, qysh po mendoni ju, që kjo çështje përfundon menjëherë. Do të thotë, unë po vazhdoj, nuk diskutoj më për pikën e rendit të ditës. I dëgjuam hallet dhe shqetësimet tuaja. Më vjen keq për gjithë atë vuajtje që ju e keni pasur gjatë asaj periudhe, më vjen keq edhe që nuk i keni denoncuar te organet e rendit, në mënyrë që të gjithë ata keqbërës që ua kanë vështirësuar jetën dhe kanë shkaktuar dëmet që i përmendët, të kishin marrë adresimin adekuat. Unë, gjatë mandatit tim si Kryetar, nuk lejoj asnjë veprimtari që shkakton dëm për komunitetin.

Naser Muja: Edhe njëherë desha të ndërlidhem pak me dy rastet, edhe te Valoni, edhe te Përfaqësuesi i Fshatit, ku u përmend emri im. Kam qenë drejtorë është e vërtetë dhe kam dalë vetë në vendin e ngjarjes dhe i kam parë shqetësimet tuaja. Por, në atë kohë, ju keni arritur një marrëveshje me operatorin ekonomik. Përfaqësuesi i fshatit, me nënshkrime të banorëve, ka ardhur tek unë. Nuk e di emrin e tij, por ka qenë ai personi që ka sjellë nënshkrimet e banorëve, të cilët kanë qenë të pajtimit që aty të operojë operatori ekonomik. Ai e ka bërë edhe asfaltimin e rrugës. Pra, dëmtimin që është bërë, e ka bërë operatori ekonomik dhe jo Komuna. Unë kam qenë shumë i bindur që operatori ekonomik ka pasur obligim ta përfundojë komplet rrugën deri te Fshati, deri aty ku ka qenë e dëmtuar. Çfarë ka ndodhur më pas me Inspeksionin, kur tha se ka qenë kah mesi i vitit, unë më tutje nuk jam në dijeni. Por një marrëveshje e tillë ka ekzistuar mes banorëve dhe operatorit ekonomik. Asfaltimi që është bërë është bërë nga operatori ekonomik dhe jo nga Komuna. Ky është sqarimi që unë e di nga ajo kohë dhe për këtë jap përgjegjësi.

Gjergj Beka: Desha ta sqaroj me z. Muja. Atëherë, ka qenë drejtor, z. Besnik Beka, Domethënë, rruga është asfaltuar nga Komuna, jo nga operatori ekonomik.

Naser Muja: Ato që i thashë, i thom me bindje të plotë. Dëmtimi është bërë prej Smrekovnicës deri ku fillojnë Kupëzat.

Gjergj Beka: Po flas për dëmtimin, po flas për herën e parë kur është asfaltuar ajo rrugë. Ajo rrugë është asfaltuar nga Komuna.

Naser Muja: Për herën e parë pajtohem me ty, por pas dëmtimit është bërë edhe një intervenim, i cili është bërë nga operatori ekonomik.

Valon Brahimi: Z. Muja kur i jam referuar periudhës kur ke qenë drejtor, nuk kam thënë që ti ke përgjegjësi për prishjen e rrugës, intervenimet janë bërë në pjesë të caktuara. Në atë kohë kam qenë anëtar i Këshillit të Fshatit dhe në pjesë të caktuara i kam mbyllur disa gropa, nga Burgu deri te Kabëzat. Por rruga është e dëmtuar deri në kodër, komplet, dhe kjo është përgjegjësi e operatorit. Dhe po të them edhe diçka, Kryetar, meqë iu referove kësaj pune dhe PDK-së: lirisht mund të deklarohen edhe këta këtu që i ke pasur në fushatën tënde, unë nuk kam pasur asnjë prej tyre me vete, prandaj, pata vërejtje edhe te zonja Arta, sepse po e nxit këtë situatë. Unë kam banorët e mi, por nuk i kontrolloj banorët, ti ke më shumë kontroll mbi ta sesa unë. Këta të Vetëvendosjes nuk janë me mua; ata kanë ardhur për interesat e veta, jo për mua. Këtë desha vetëm ta sqaroj.

Artan Berisha: Kryetar, është mbajtur një peticion me 930 nënshkrime, të cilat janë dorëzuar në Kuvendin Komunal, me kërkesë që të ndërpritet çdo kontratë dhe çdo pëlqim që është dhënë nga Kuvendi Komunal. Kuvendi Komunal nuk ka pasur të drejtë të japë një pëlqim të tillë. Edhe kjo lëndë është në Prokurori. Lënda e gurthyesit është në Prokurori. Është lëshuar një pëlqim nga Kuvendi Komunal, përmes ish-drejtorisë, dhe është proceduar si pëlqim me ato dokumente, me të cilat kanë aplikuar. Ne kemi mbajtur edhe një dëgjim publik këtu, në këtë sallë, ku kanë qenë shumica e këtyre banorëve. Pas kësaj ka qenë edhe znj. Fitore Pacolli dhe znj. Arjeta Fejza. Tash, vetëm Arjeta është deputete, falbardhësisht ministre e kemi edhe znj. Fitore. Po them falbardhësisht, sepse në atë kohë ka deklaruar dhe e kam edhe në procesverbal dhe po ta citoj se si shoqe, sigurisht që do t'ia përcjellësh. Komuna ta largojë pëlqimin e dhënë, sepse nuk ka komunë dhe as drejtor që del kundër vullnetit të qytetarëve. Kërkon edhe dosjen për ta shqyrtuar dhe peticioni i dërgohet drejtpërdrejt znj. Fitore Pacollit. Por, në mënyrë decidive, thuhet që t'i hiqet pëlqimi i dhënë nga Komuna. Znj. Arjeta Fejza ka qenë këtu, është keq që sot nuk është këtu, sepse i kemi bërë ftesë, por nuk ka ardhur. Është shumë keq prej saj, sepse kur vjen pyetja për të dalë e për të marrë vota, del edhe deklarohet, ndërsa tani nuk është këtu. Po e them kështu siç po shprehem: është e turpshme që tani të mos dëgjojë dhe të mos e shohë këtë pjesë. Ajo do ta shohë dhe do ta dëgjojë, por nuk i ka hije kështu. Kryetar, peticioni është te Drejtoria e Kadastrit, te Drejtoria e Urbanizmit, te Drejtoria e Inspeksionit dhe te Sekretaria e Kuvendit. Këto janë bërë dhe janë protokolluar në të katër vendet për të cilat fola. Kështu që, vullneti qytetar i Kçiqit është që kjo pikë të mos kalojë. Kështu ka qenë atëherë dhe kështu është edhe tash. Dhe është mirë që në tema serioze të merret parasysh vullneti i qytetarëve. Lënda është në Prokurori. Besoj se je i njoftuar, Kryetar. Jam shumë i sigurt. Besoj se edhe për peticionin je i njoftuar. Kryetar a je i njoftuar që është bërë peticion, pyeti drejtoritë para se të sillni diçka këtu, duhet të njoftoheni për këto gjëra. Po ta them që kjo çështje është e menduehme dhe definitivisht nuk kalon. Ne veç e dimë, sepse vijmë prej atij fshati dhe nuk jemi të interesuar vetëm të bëjmë dëm andej. E dimë se çfarë mund të ndodhë. Edhe unë e kam një shtëpi aty dhe e di që, pas tre apo pesë vjetësh, mund të mos mund të jetojmë më në atë shtëpi për shkak të pluhurit dhe betonimit.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: I ngritët disa tema për të cilat dua të them se unë nuk kam dijeni as për peticionin, as për faktin që kjo çështje është pjesë e trajtimit në institucionet e drejtësisë. Unë nuk punoj në Prokurori; punoj në Komunë. Dje kam qenë në Qeveri dhe nuk kam se si ta di se çfarë bën Prokuroria. Tema tjetër jo rastësisht, në fillim të seancës e kam përmendur se Ministrinë e Mjedisit e drejton znj. Fitore Pacolli, me Fitoren nuk kemi qenë fare shokë. Bile, po të tregoj se në Komisionin Parlamentar, ku ajo e ka monitoruar punën time, kanë qenë edhe deputetë të opozitës, si znj. Ganimete Musliu. Vetëm se ajo nuk ka qenë me këtë qasje, por ka qenë ndër opozitaret më të rrepta ndaj punës time si ministër. Por, meqenëse më herët na keni bërë disa sulme të padrejta, tani, pas një kohe të gjatë, jemi duke ecur përpara. Sido që të jetë, unë e vlerësoj shumë punën e znj. Fitore Pacollit dhe e di pasionin që e ka për t'i trajtuar çështjet mjedisore. Do të thotë, e ka këtë si një pikë të rëndësishme dhe, në kuptimin tim, mendoj që në disa pika është duke shkruar pak më agresivisht sesa duhet. Por e shoh me admirim angazhimin e saj. Për këtë arsye, ndër të tjera, njëra prej "siguresave" është që, edhe nëse nuk më besoni mua, ju kam thënë se jashtë standardeve dhe jashtë rregullave, edhe sot, edhe në të ardhmen, nuk do të lejohet të kalojë asgjë. Unë po ju siguroj se nuk po flas në emër tim, por po e marr të drejtën të flas edhe në emër të znj. Fitore Pacollit. Edhe njëherë po e përmbyll: unë kam hyrë në këtë rrugë për zhvillimin e Mitrovicës. Ku ma keni lënë? A ju a Agimi, ai tjetri apo LDK-ja? Ku ka potencial për zhvillim, për atë veprimtari dhe për atë që është e dedikuar, unë do ta nxjerr në shpallje. Unë personalisht e kuptoj krejt brengën dhe shqetësimin e qytetarëve të Kçiqit. Ndërkohë, le të ecim përpara. Keni për të parë se ndoshta edhe unë do të vij përsëri dhe do të flas me ju. Por, nëse brenda ditës takoj 20 apo 50 njerëz, dikush hidhërohet pse nuk e kam pritur. Ai që nuk e kam pritur thotë: "Nuk më priti mua", ndërsa ai që e kam pritur

do të thotë se e ka pasur atë kërkesë. Nuk ka shans që unë të përkrah një ide ose një projekt që nuk e ka mbështetjen apo për të cilin nuk sigurohemi se nuk bie ndesh me veprimtarinë dhe jetën e tyre. Kështu që, ky është vetëm një veprim që unë po dua ta përfundoj. Në rast se ajo realizohet, duhet të ketë edhe 20 shkallë të tjera sigurie që të mos shkaktohet dëm. Vendimi është në grupin e Asamblesë dhe mendoj që, kryesues, është ezauruar kjo çështje. Le ta ndajë secili mendimin dhe vendosni si mendoni se është më së miri.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Për hir të sqarimit, Kryetar i Fshatit Kçiq, data më e afërt e lirë për takim me kryetarin është 15 tetori. Gjashtë muaj ditë nuk kemi pasur kërkesë. Nëse ke kërkesë të protokolluar, hajde ta verifikojmë. Unë jam garanci që nuk ka pasur kërkesë nga banorët e fshatit. E verifikova edhe në kabinet. Data më e afërt e lirë për takim me kryetarin është 15 tetori. Për çdo çështje tjetër që është adresuar, unë jap përgjegjësi dhe llogari para teje dhe para secilit, sepse e di sigurt se për çfarë po flas. Të lutem, vetëm për hir të korrektësisë, dëgjo. Tash u përmend edhe ministrja znj. Fitore Pacolli, si dhe deputetja znj. Arjeta Fejza. Për hir të korrektësisë, nuk jemi duke e dhënë parcelën sot. Po të ishim duke e dhënë parcelën sot ose duke e përcaktuar operatorin, besoj se kjo do të ishte shqetësimi kryesor i juaj. Mirëpo, nuk po jepet parcela sot, vetëm për hir të korrektësisë. Kjo është për t'u hapur procesi. Ndërsa znj. Arjeta ka qenë një zë shumë i fuqishëm në anën tuaj kundër atyre keqpërdorimeve që i cekëm edhe z. Valoni, edhe ti, kryetar. Ndërsa tash nuk jemi në një fazë ku po e japim pronën. Jemi në fazën ku po shpallet. Unë ta sqarova edhe ty, edhe disa kolegëve të tu jashtë. Sot hapet thirrja, e cila është 30 ditë. Aplikon dikush, ndoshta nuk aplikon askush. Më pas është çështja e komisionit që e trajton. Pastaj është komisioni i ankesave. Pra, vetëm me u hap sot kjo thirrje, derisa të kalojë i gjithë procesi, minimalisht edhe pesë-gjashtë muaj nuk përfundon. Sepse 30 ditë janë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, në fazën e ligjshmërisë: a keni të drejtë apo nuk keni të drejtë? Pastaj janë 30 ditë faza e hapjes së ofertave. Kështu që, vetëm për hir të korrektësisë, desha ta cek që të mos keqpërdoret emri as i ministres, as i deputetes. Ne jemi duke folur për emra shumë publikë. Unë e kuptoj shumë mirë edhe znj. Arjeta. Ndoshta, me zërin tuaj, do të vazhdojë e njëjta veprimtari, por jo në këtë mënyrë. Kështu që, ta dini saktësisht: data më e afërt për takim me kryetarin është 15 tetori. Ju presim edhe pa takim. Nëse i keni shqetësimet, unë i marr përsipër. Kryetar, me mirëkuptimin tënd, besoj që data më e afërt është 15 tetori. Por, hajde, pa e pritur atë datë, nesër unë të pres vetë. Këtë mund ta garantoj dhe mund të diskutojmë secilin shqetësim që e keni.

Kushtrimi Zeneli: Së pari, përshëndetje për banorët e Kçiqit. Nuk e pata ndërmend të marr fjalën, por më duhet ta marr fjalën pasi që u ngritën këto çështje dhe u thanë disa spekulime këtu. E dini, sikurse kur e dëgjova z. Berisha dhe z. Brahimi, dukej sikur këta e paskan ndalë gurthyesin. Tash mua më duhet të sqaroj pak a shumë se si ka shkuar puna me gurthyesin, sepse kam qenë goxha një avokues për këtë çështje. Më vjen keq që po ia them z. Berisha, por këto që i the nuk janë të vërteta. Është plotësisht e vërtetë se ne e kemi kundërshtuar punën e gurthyesit në atë kohë. Por, për ta kuptuar drejt këtë çështje, duhet të shikohet pak edhe historiku i saj. Në radhë të parë, duhet të sqarohet një fakt shumë i rëndësishëm: kjo pronë për herë të parë hyn në listën për dhënie në shfrytëzim në dhjetor të vitit 2022, kur në qeverisje sapo kishte ardhur PDK-ja. Edhe ka pasur një diskutim mjaft të rëndësishëm këtu në Kuvend. I vetmi prej asamblistëve këtu që ka kundërshtuar gurthyesin në Kçiq, ose pronën që quhet "Fishta", ka qenë z. Gjergj Beka në atë kohë, si dhe z. Sevdaim Uka dhe asamblistë të tjerë që kanë qenë këtu. Edhe në ekzekutiv, çele gurin e gojës, asnjë e as drejtori i Kadastrit e as z. Brahimi.

Kjo pra, diskutimet, është lehtë e vërtetueshme. Vetëm Sekretaria e Kuvendit mund ta nxjerrë procesverbalin e datës 27 dhjetor 2022, në mënyrë që qytetarët ta shohin se si është trajtuar kjo çështje, kush ka qenë për, kush ka qenë kundër dhe si ka kaluar vendimi. Pra, mos ta harrojmë: në vitin 2022, kur kjo pronë është futur në listën e pronës për dhënie në shfrytëzim, kujtimet kanë qenë shumë të freskëta për dëmet që ka bërë gurthyesi në atë kohë. Tash, çfarë ka ndodhur me gurthyesin? Për më shumë se 15 vjet ka punuar operatori aty dhe nuk ka qenë vetëm një operator. Ne as atëherë nuk kemi qenë kundër zhvillimit ekonomik, investimeve apo krijimit të vendeve të punës. Qëndrimi ynë atëherë ka qenë kundër një gurthyesi që funksionontc pa respektuar kriteret ligjore dhe që dëmtonte ambientin dhe infrastrukturën e fshatit. Në atë periudhë janë ngritur shqetësimet lidhur me dëmtimin e rrugëve, kanalevc të ujit, pluhurin, zhurmën dhe dëmet e tjera që u shkaktoheshin banorëve dhe infrastrukturës. Dallimi është se këto shqetësime ne i kemi adresuar institucionalisht, pavarësisht se kush ka qenë në pushtet. Ne si Vetëvendosje nuk e kemi problem që, edhe nëse jemi në qeverisje, të kundërshtojmë diçka që shkon në dëm të qytetarëve. Vetëm paragjykimi nuk është i mirë. Tash u përmend z. Agim Bahtiri. Këto çështje i kemi adresuar edhe gjatë qeverisjes së z. Agim Bahtirit dhe edhe në atë kohë, kur Qeveria Kurti e kishte marrë detyrën.

Pas kundërshtimeve të shumta që kanë qenë, edhe ankesave të banorëve, me të cilët kemi qëndruar afër, si dhe me deputetet znj. Arjeta Fejza dhe znj. Fitore Pacolli, Komuna e Mitrovicës e ka themeluar një komision për verifikimin e ankesave të banorëve. Komisioni është formuar më 27 nëntor 2018, kur drejtor i Mjedisit në atë kohë ka qenë z. Asllan Jusufi. Përveç kësaj, komisioni nxjerr përfundimin se Kuvendi Komunal këtë pronë e ka dhënë në shfrytëzim më 6 dhjetor 2006. Domethënë, prej asaj kohe ky gurthyes ka vazhduar të operojë atje. E keni me dokumente. Pas konstatimeve të komisionit, Inspektorati i Komunës së Mitrovicës ka dalë në vendin e ngjarjes dhe i ka ndërprerë punimet e gurthyesit. Domethënë, Inspektorati i Komunës së Mitrovicës, kur kryetar ka qenë z. Agim Batiri. Këtu jemi të qartë, si Valoni, ashtu edhe Artani. Pavarësisht ndërhyrjes së Inspektoratit Komunal, operatori ekonomik përsëri ka vazhduar punën. Për këtë arsye, ne e kemi adresuar çështjen edhe në institucionet qendrore, me ndihmën dhe mbështetjen e banorëve. Ministria e Mjedisit, në atë kohë, i ka ndërprerë punimet me vendim, pasi operatori ekonomik nuk ka qenë i pajisur me pëlqimin mjedisor të nevojshëm. Domethënë, arsyeja e ndërprerjes së punimeve ka qenë se ai nuk ka pasur pëlqim mjedisor dhe leje të nevojshme, përveç dëmeve që u janë shkaktuar banorëve dhe Kçiqit. Madje, edhe tash, dua të them edhe diçka: ne nuk kemi për ta lënë, ashtu siç nuk e kemi lënë në kohën e z.Agim Bahtirit, që të bëhet dëm. Nuk kemi për ta lënë përsëri, nëse jepet. Edhe një gjë tjetër, sepse këtu ka shumë banorë të Kçiqit dhe është në interes të tyre. Besoj se banorët e dinë se gjatë kohës kur është kundërshtuar. E kam edhe një gjë për ta përmendur gjatë kohës kur kjo çështje është kundërshtuar, ka pasur aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje që tash janë në procedura gjyqësore, si rezultat i padive të operatorit ekonomik që i ka bërë në atë kohë. Domethënë, edhe Imer Fejza është në procedurë gjyqësore për këtë çështje. Edhe a e dini se është mirë me e qartësuar para banorëve dhe para qytetarëve, sepse këtu po krijohet një idc sikur sot, nëse votohet kjo pikë, nesër fillon puna e gurthyesit. Kjo nuk është fare e vërtetë dhe është propagandë. Fakti që kjo pronë po del në shfrytëzim nuk do të thotë që nesër ka me u ndërtuar diçka që është në dëm të banorëve, a kupton? E kam përmendur edhe më herët, dhe po e përmend edhe kryetarin: do të ketë edhe procedura të tjera ligjore, ku institucionet janë të obliguara të sigurojnë transparencë dhe konsultim publik, dëgjime publike me të gjithë banorët e Kçiqit, si dhe të merren parasysh sugjerimet, vërejtjet dhe rekomandimet për projektin, çfarëdo që të jetë ai. Dhe krejt në fund, nëse në të ardhmen paraqitet ndonjë operator ekonomik.në po e them këtë që të gjithë banorët e Kçiqit do të kenë të drejtë të japin sugjerimet, vërejtjet dhe rekomandimet për projektin, çfarëdo qoftë ai dhe

pavarësisht se kush e merr në shfrytëzim. Pra, zotimi im është që po e them publikisht: edhe nëse në të ardhmen paraqitet ndonjë operator i cili nuk i respekton ligjet në fuqi, që dëmton ambientin, rrugët apo ujin, ne, ashtu siç kemi reaguar atëherë, prapë do të reagojmë njësoj.

Ashtu siç kemi reaguar kur kemi qenë në qeverisje, edhe në nivel lokal, edhe në nivel qendror.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë besoj që shqetësimi i banorëve të Kçiqit nuk është i thjeshtë, sepse unë besoj që këta kanë shumë arsye për të qenë të shqetësuar në raport me një historik të kaluar të veprimtarisë që ka ndodhur në gurthyesin e Kçiqit. Ne e dimë se ai gurthyes ndoshta ka 15 apo 20 vjet që ka vepruar në Kçiq dhe, realisht, unë i njoh shumicën e atyre që janë sot këtu. E di që pjesa dërrmuese e tyre, kryetar, jetojnë rreth kodrës dhe në njëfarë forme janë të afektuar nga ato shqetësime që vazhdimisht i kanë pasur për shkak të detonimeve. Unë besoj se, sa i përket edhe gurthyesit, edhe peshës së detonimeve, mund të them me kompetencë që jam goxha i kualifikuar dhe profesionist i fushës, sepse jam gjeolog dhe ekskluzivisht e kam këtë fushë. E di të flas edhe në mënyrë profesionale për këtë çështje. Por nganjëherë sikur po tentojmë t'i tregojmë Kçiqit diçka, ndërsa në atë diskutim një pjesë e çështjes nuk po sqarohet. Unë e kuptoj z. Brahimi, e kuptoj z. Beka dhe z. Berisha deri diku, të cilët po bisedojnë, sepse kanë familjarë, kanë rreth dhe janë të afektuar, si të them, nga problemi i banorëve në këtë çështje. Kushtrimi thash, lëreni të flasë, sepse besoj se po jep argumente të rëndësishme për banorët e Kçiqit. Ju thoni: "Jo, unë nuk e shikoj bash në kontekstin se çfarë po flet Vetëvendosja", por unë isha duke i dëgjuar për pasojat të cilat janë krijuar dhe vazhdojnë të krijohen në Kçiq, dhe për të cilat vazhdimisht është duke dhënë argumente z. Zeneli. Unë kështu e pashë dhe ju keni të drejtë të thoni se nuk jam as psikolog, as filozof, por së paku besoj se kam përvojë të gjatë në këtë fushë dhe në këtë tavolinë, edhe me ju, që t'i kuptoj gjërat drejt dhe të mos i shikoj këto çështje me emocion. Ndoshta përvoja e ka bërë të vetën që gjërat t'i shikoj pak më ftohtë. Dhe nganjëherë, kur gjërat shikohen kështu, edhe konstatimet vijnë më natyrshëm dhe me më shumë peshë. Unë jam shumë i bindur që Kçiqi ka nevojë për investime, sepse investimet e rrisin mirëqenien e banorëve dhe ndikojnë drejtpërdrejt te qytetari i Kçiqit. Ne kemi investuar, kemi investuar pas luftës atje edhe me ujësjellës, edhe me rrugë, sikurse në çdo fshat dhe lagje të Komunës së Mitrovicës. A është dhënë ajo që u takon? Jo. Unë besoj që ata banorë, dhe banorët e Mitrovicës në përgjithësi, kanë nevojë për shumë më tepër investime. Mirëpo, nganjëherë janë rrethanat ato që nuk lejojnë të bëhet shumë më tepër. Është çështja e buxhetit. Më herët e kam një përvojë goxha të gjatë këtu. Prej vitit 2009 jam anëtar i Kuvendit dhe, kur e marr buxhetin e draftuar, të them të drejtën, nuk shoh ndonjë dallim të madh nga një mandat në tjetrin ose nga një vit në tjetrin. Pothuajse është i njëjti. Ju keni qenë në qeveri, kemi qenë ne, kanë qenë ata; në fund, ka vetëm ndonjë ndërrim të numrave prej një pozicioni në një pozicion tjetër. Buxhetin nuk e rritëm ne, përveç të hyrave që rriten vazhdimisht, jo aq sa dëshirojmë. Do të kishim dashur që ekonomia të ishte shumë më e fortë, jo të kishim 4 milionë, por të kishim rreth 10 milionë të hyra tona, të cilat do ta rrisnin edhe buxhetin. Por kjo është, fatkeqësisht, gjendja ekonomike e Mitrovicës dhe e vendit në përgjithësi. Dua t'u kthehem prapë banorëve atje dhe arsyes përse realisht jemi sot këtu. Kryetar, ky është shqetësimi konkret i banorëve të fshatit. Domethënë, unë jam shumë i bindur se asnjëri prej tyre dhe asnjë banor i fshatit Kçiq i Madh nuk është kundër investimit. Nuk është se prona komunale, të cilën e dimë se është pronë e jona komunale, nuk duhet të trajtohet. Komuna ka të drejtë ta trajtojë, ka të drejtë ta valorizojë, ka të drejtë t'ia rrisë vlerën, sepse duke u rritur vlera krijohet mirëqenia dhe zhvillohet ekonomia edhe e Mitrovicës. Por jam shumë i bindur edhe për ne, për banorët e fshatit Kçiq i Madh, se ky është halli. Ne e kemi parë reagimin pak më të ashpër ndaj kësaj ideje, sepse, siç thuhet: "Kur të hanë gjarpri, tutesh edhe hardhucës." Domethënë, ky ka qenë halli ynë. Domethënë, ne e kemi përjetuar rëndë, por në të vërtetë e kanë përjetuar këta si banorë, sepse shumica janë të asaj pjese. Edhe këtu e kanë dilemën. Këta duan garancion, Kryetar, në raport me gjithë ato që u bënë, në raport me të gjitha ato investime që po bëhen. Jo vetëm në raport me këtë çështje. Nesër mund të ketë edhe parcela të tjera për të cilat mund të investohet. Unë e di, e kemi bashkëbiseduar bashkë. Një prej investimeve që ti e ke pasur në konceptin tënd të investimit ka qenë një veprimtari prodhuese atje. Jo, nuk po flitet për këtë hapësirë, por po flitet për një hapësirë tjetër milionëshe, por që ne e presim të ndodhë. Prandaj, në këtë kontekst, ky është halli ynë. Ky është halli i banorëve të Kçiqit. Edhe unë po flas si banor i Kçiqit, nën petkun dhe nën lëkurën e z. Beka , z. Brahimi, z. Berisha dhe të banorëve gjithsesi, por jo nën hallin e të tjerëve që po pretendojnë me të ditur më të mirë se ne atë që e kemi përjetuar. Ky është halli ynë.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Vetëm shumë shkurtimisht. Në krejt këtë pjesë të diskutimit përdore një formë të tillë metafore, por që më pëlqeu. Analogjia është me Kçiqin, që e ka "ngrënë gjarpri" në të kaluarën dhe tash "po tutet prej hardhucës". Është shprehje popullore që e ka përjetuar shumëkush në lëkurë, prej traditës

sonë. Unë jam këtu me ju dhënë garanci që, gjatë mandatit tim, Kçiqin se ha gjarpri. Kryesuesi ma tregoi edhe një çështje tjetër, për të mundur me pasur një pasqyrë edhe më të qartë të preokupimit tim, se si të mund të sjell investime në Kçiq. Unë kam bërë përpjekje për të sjellë një fabrikë të një investitori që ka pasur vlerën e 40 milionë euro. Dhe e dini pse nuk shkon? Ajo mund të vijë diku në një lokalitet tjetër të Mitrovicës. Unë preferencën e kam pasur për Kçiqin, por, kur kam dashur të filloj interesimet dhe të shikoj PZIIK-në, të cilën ia kanë lënë për çdo veprimtari, atë veprimtari që do t'ju sillte juve 40 milionë €, në këtë plan unë hasa vështirësi në Kçiq. Kam dashur që investimin më të rëndësishëm, të parin, ta kemi në Kçiq, me vlerë 40 milionë €. Por, kur e kam parë këtë dhe emrat që jua kam treguar në fillim, ata nuk e kanë lejuar Kçiqin për ta sjellë këtë veprimtari, për ta sjellë fabrikën prej 40 milionë €, por e kanë lënë këtë veprimtari: kullotë, bujqësi dhe gurore. Kështu që, nuk e kam caktuar unë. Edhe dëshirën për 40 milionë € në Kçiq, që e kam pasur si preferencë numër një, nuk kam mundur ta realizoj. Unë vetëm di t'ju them kështu: nuk dua të predikoj se këtë pikë e kam sjellë dhe 100 të tjera kam sjellë në anë të Kçiqit, në Frashër, në çdo cep të territorit, sepse jam i përkushtuar të investoj dhe të zhvilloj mbi bazën e rregullave. Unë po ju them: gjatë mandatit tim Kçiqin nuk e ha gjarpri. Për këtë të jeni të sigurt. Kaloi apo s'kaloi kjo pikë e rendit të ditës, është në dorën e asamblistëve. Ndërsa, për të pasur një veprimtari që shkakton dëm, jo. Unë i pari do t'i ndërmarr masat dhe veprimet nga ekzekutivi. Për më tepër, janë edhe pesë-gjashtë filtra të institucioneve qendrore që nuk lejojnë një gjë të tillë. Mos lejoni të manipulohet kjo për politikë ditore. Çdo qytetari i përkulem me respekt dhe kam për t'ia kthyer vetëm me shërbim. Dhe kurrë, në asnjë rrethanë, nuk lejoj që të dëmtohet interesi i qytetarit. Betohem në krejt qenien time. Jetoj për të bërë shërbim dhe zhvillim. Nuk lejoj as Kçiqin, asnjë qytetar të Mitrovicës, por as të Kosovës, kur diku kam ndonjë përgjegjësi, të dëmtohet. Vendimi është i juaji. Cilido qoftë ai, nuk nënkupton asgjë për pjesën tjetër. Ne kemi për të qenë këtu dhe kemi për ta parë secilin në sy, njëri-tjetrin.

Artan Berisha: Z. Zeneli, gjithçka që thatë e kam kuptuar. Besomë, po të ishte fjala për ndonjë shokun tim nga Prishtina, edhe unë do ta kisha mbrojtur. Po në realitet ju bash hiq asgjë nuk keni thënë. Z. Zeneli, ato pëlqime janë dhënë nga anëtarët e partisë suaj. Po të mos i kisha përkrahur unë banorët, zotëri, ato pëlqime do të kishin kaluar pa u dëgjuar. Unë i kam mbajtur edhe në dëgjimin publik. Ku i ke dëshmitarët? Ja ku i ke, janë këtu. Hyni në procedurë dhe shikojeni. Nuk ka procedurë për dhënien e pronës në shfrytëzim. Asnjë dokument që duhet të jetë i kompletuar në lidhje me këtë çështje janë përcjellë. Tjetër është të flasësh. E kuptoj që po i mbron. Edhe unë do ta kisha mbrojtur shoqen time, besa ndoshta edhe pa urdhër të saj nuk kisha guxuar me punua. Ju kam treguar që bëhet fjalë për gurthyes, pikërisht ashtu siç ka qenë kërkesa. Nuk ka pasur asnjë fshehtësi. Ku i ke banorët? Ja ku i ke banorët! Këtu po e shoh shumicën e tyre. I ke banorët, të cilëve u kam thënë se zotëria këtu ka ardhur dhe e ka paraqitur kërkesën për gurthyes. Valon Brahimi ia ka ndërprerë punën. Ku e kemi këtu? Ti, z. Zeneli së pari, më dëgjo. Mësohu të jesh i sinqertë. Duhet të kesh moral në politikë dhe dokumenti ekziston, mësohu të jesh i sinqertë nëse dëshiron të bësh teatër, bëj teatër.

Valon Brahimi: Ish-drejtori, që ke referuar ti z. Fidan, ka qenë ai që ia ka ndërprerë punën kohë pas kohe, por ai ka filluar përsëri me punu. Kur unë kam pasur kërkesë prej Drejtorisë së Kadastrit dhe Inspektorëve të Ndërtimit, jo unë, se s'kam pasur për të dalë aty dhe për ta zbatuar ligjin. Kur unë kam qenë drejtor, kam urdhëruar të zbatohet ligji, në funksion të ligjit. Edhe gurthyesi, prej kohës kur është marrë vendimi, kur ka qenë drejtor, më nuk ka punuar. Nëse nuk është kështu dhe unë ty po të betohem në Zot se kam me dhënë dorëheqje nëse tash shkohet dhe konstatohet. I ke lart dokumentet. Diku ka qenë nga mesi i majit të vitit 2022, kur drejtori Muja mund ta ketë ndalur. T'i tregoj dokumentet. Inspektorët e Ndërtimit e kanë ndalur. Nuk e kam ndalur me tendencë. E ka ndalur ligji. Veç kështu që mos i përzieni këto gjëra.

Xhyljeta Imeri: Përshëndetje për të gjithë juve. Unë po ju drejtohem jo si banore e Kçiqit, por po ju drejtohem si asambleiste dhe përfaqësuese e të gjithë qytetarëve. Kjo pikë e rendit të ditës, sipas mendimit tim, është e papranueshme. Sot po na kërkohet t'i japim dritën e gjelbër shfrytëzimit afatgjatë të gati 100 hektarëve tokë në Kçiq të Madh. Për çfarë? Pyetja ime është: a po ia jepni këtë mal dhe këtë kodër të Kçiqit ndonjë kompanie për gurthyes apo për ndonjë fabrikë që po përpunon fruta mali? Të gjithë e dimë se çfarë nënkupton një gurthyes në atë zonë: shkatërrim të mjedisit, pluhur, degradim të natyrës, dëmtim të rrugëve dhe tmerr për banorët e Kçiqit të Madh. Unë vetëm tri vota i kam marrë në Kçiq, por s'mund ta ngre dorën për t'i helmuar për 99 vjet qytetarët e asaj zone. Ne jemi zgjedhur këtu për ta mbrojtur interesin e qytetarëve, jo për t'u bërë argat bizneseve që shkatërrojnë mushkëritë e gjelbra të komunës sonë për interesa të tyre financiare. Kolegë të nderuar, sot duhet ta vendosim veten në vendin e qytetarit dhe ta largojmë për një moment petkun politik. Sot nuk po vendosim vetëm për të tashmen; po vendosim për 99 vjet, për 99 gjenerata të ardhshme. Ndoshta pas 10 apo 20 vitesh zhvillimi ekonomik dhe nevojat e qytetit do të jenë krejtësisht të tjera dhe ndryshimi i

destinimit të kësaj parcele mund të ishte shumë më i dobishëm për qytetin, por edhe për ata që e marrin në shfrytëzim. Prandaj, duhet të mendojmë përtej mandatit tonë dhe përtej interesave të momentit. Sot secili prej nesh e ka emrin mbi këtë vendim dhe nesër do të mbajmë përgjegjësi për të.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Vetëm një korrigjim. Ne nuk po vendosim për 99 gjenerata. 99 vjet është. Një gjeneratë është 30 deri në 33 vjet. Kështu që ke shkuar tepër larg. Vetëm ta dini: një gjeneratë nuk është një vit, por është 30 deri në 33 vjet. Është një gjeneratë. Edhe tjetra, do t'i sugjeroja kryesuesit ta vendosë temën kështu: këtu nuk predikohet asnjë veprimtari. Nëse kalon, krijohet një komision për herë të fundit. Nuk është e thënë që aty do të ketë gurthyes. Do të thotë, është e rëndësishme edhe njëherë për asamblistët pra korrigjimi që nuk po flasim për 99 gjenerata, por për 15 deri në 99 vite. Por kjo nuk nënkupton që aty ka me qenë gurthyes. Mund të ketë ndonjë veprimtari tjetër. Kështu që, kryesues, do të kisha sugjeruar të mos shkojmë tepër gjatë me këtë pikë. Le të vendosin asamblistët.

Gjergj Beka: Unë s'po dua me e zgjatur, se u tha në njëfarë forme. E dimë që po e dojn Kçiqin dhe po më vjen mirë. Po, domethënë, veç po e rikonfirmoj atë qëndrim timin që e kam pasur edhe në të kaluarën, edhe në pushtetet e kaluara. Domethënë, edhe sot unë jam kundër kësaj pike dhe sa herë që të jetë në pyetje kjo parcelë, do të jem çdo herë kundër.

Kryesuesi i Kuvendit Atëherë, vë në votim Propozim vendimin për miratimin paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës personave fizikë dhe juridikë, të parcelës me numër P-71202012-009-1"

Rezultati i votimit: Të pranishëm 31 anëtare të Kuvendit, 13 për, 17 kundër dhe 1 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoj se nuk miratohet Propozim vendimin për miratimin paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës personave fizikë dhe juridikë, të parcelës me numër P-71202012-009-1.

Pika e 12

Kryesuesi i Kuvendit: Në sallë janë të pranishëm 18 anëtarë të Kuvendit, kemi forum të mjaftueshëm për ta vazhduar mbledhjen.

Meqenëse pika 12 ka të bëjë me formimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronës të parcelës me numër P-71202012-009-1që nuk u miratua atëherë tërhiqet kjo pikë, nuk trajtohet.

Pika e 13

Kryesuesi i Kuvendit theksoi se lidhur me Propozim vendimin për formimin e Komisionit për Ankesa për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurë për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës, ky komision me mandat dyvjeçar dhe i trajton të gjitha ankesat të cilat vijnë nga komisionet për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale. Përbërja e komisionit do të jetë prej pesë anëtarëve: dy nga Kuvendi Komunal, dy nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile.

Nënkryetari: Nga Ekzekutivi propozoj z. Nazmi Kelmendi dhe znj. Arjeta Beqiri, ndërsa shoqëria civile propozohet z. Lulzim Hakaj.

Armend Begu: E propozoj znj. Sazan Ramaxhiku.

Visar Syla: E propozoj z. Xhevdet Osmani.

Kryesuesi i Kuvendit vë në votim propozim vendimin duke përfshi përbërjen e komisionit si në vijim: Xhevdet Osmani, Sazan Ramaxhiku, Arjeta Beqiri, Nazmi Kelmendi dhe Lulzim Hakaj.

Rezultati i votimit: të pranishëm janë 16 anëtarë, 16 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se miratohet Vendimi për formimin e Komisionit për Ankesa për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurë për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës.

Pika e 14

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me Kërkesën për transferin e mjeteve financiare në investime kapitale.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi e vuri në votim Kërkesën për transferin e mjeteve financiare në investime kapitale.

Rezultati i votimit: Të pranishëm janë 18 anëtarë, 18 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se miratohet Vendimi për transferin e mjeteve financiare në investime kapitale.

Pika e 15

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.1/26 dt. 29.07.2026.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi e vuri në votim shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.1/26 dt. 29.07.2026.

Rezultati i votimit: Të pranishëm janë 18 anëtarë, 18 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se miratohet Vendimi për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.1/26 dt. 29.07.2026.

Pika e 16

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.2/26 dt. 29.07.2026.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi e vuri në votim shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.2/26 dt. 29.07.2026.

Rezultati i votimit: Të pranishëm janë 18 anëtarë, 18 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se miratohet Vendimi për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.2/26 dt. 29.07.2026.

Pika e 17

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.3/26 dt. 29.07.2026.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi e vuri në votim shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.3/26 dt. 29.07.2026.

Rezultati i votimit: Të pranishëm janë 18 anëtarë, 18 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se miratohet Vendimi për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.3/26 dt. 29.07.2026.

Pika e 18

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.4/26 dt. 29.07.2026.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi e vuri në votim shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.4/26 dt. 29.07.2026.

Rezultati i votimit: Të pranishëm janë 18 anëtarë, 18 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se miratohet Vendimi për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.4/26 dt. 29.07.2026.

Pika e 19

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.5/26 dt. 29.07.2026.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi e vuri në votim shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.5/26 dt. 29.07.2026.

Rezultati i votimit: Të pranishëm janë 18 anëtarë, 18 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se miratohet Vendimi për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.5/26 dt. 29.07.2026.

Pika e 20

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.6/26 dt. 29.07.2026.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi e vuri në votim shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.6/26 dt. 29.07.2026.

Rezultati i votimit: Të pranishëm janë 18 anëtarë, 18 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se miratohet Vendimi për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.6/26 dt. 29.07.2026.

Pika e 21

Kryesuesi i Kuvendit Safet Kamberi: Lidhur me Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0035074-15/26 dt. 29.06.2026 për zhvlerësimin dhe dhënien donacion të 35 laptopëve që janë në posedim të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në mandatin 2021-2025, Ministria ka konstatuar se Kuvendi nuk ka të drejtë, kjo çështje është në kompetencën e Kryetarit. Prandaj ne si Kuvend mund ta autorizojmë Kryetarin e Komunës të merret me këtë çështje.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi e vuri në votim Propozim-vendimin për plotësim-ndryshimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0035074-15/26 dt. 29.06.2026 për zhvlerësimin dhe dhënien donacion të 35 laptopëve që janë në posedim të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në mandatin 2021-2025.

Rezultati i votimit: Të pranishëm janë 18 anëtarë, 18 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se miratohet Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0035074-15/26 dt. 29.06.2026 për zhvlerësimin dhe dhënien donacion të 35 laptopëve që janë në posedim të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në mandatin 2021-2025.

Pika e 22

Kryesuesi edhe diçka, ju lutem, anëtarëve të Kuvendit. Para se ta përmbyllim: Është ndërhyrë te çështja e Rregullores Nr. 3/2026 Për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 08/2023 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve padrejtësisht te numri i pikëve dhe poenave. Ndërkohë, komisioni që e ka hartua Rregulloren ka konstatuar që Draft Rregullorja plotësisht ka qenë në harmoni dhe nuk ka pasur gabime. Prandaj, mua më duhet ta rikthej në rivotim. Ju lutem, duhet ta rivotojmë pa atë ndryshimin e numrit të poenëve. A është kështu, drejtor?

Atëherë, e kthej dhe e vë në votim pikën 3 të rendit të ditës, me këtë vërejtjen të cilën e dhamë.

Rezultati i votimit: Të pranishëm janë 18 anëtarë, 18 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Rregulloren Nr. 3/2026 Për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 08/2023 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

Nuk ka pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 19:45.

Mitrovicë
24.09.2026

Procesmbajtës:
Afërdita MAXHUNI

Kryesuesi i Kuvendit
Safet KAMBERI